

UNIVERSITETI I EVROPËS JUGLINDORE

FAKULTETI JURIDIK



УНИВЕРЗИТЕТ НА ЈУГОИСТОЧНА ЕВРОПА

ПРАВЕН ФАКУЛТЕТ

SOUTH EAST EUROPEAN UNIVERSITY

FACULTY OF LAW

STUDIMET PASDIPLOMIKE - CIKLI I DYTË

DREJTIMI: STUDIME TË SIGURISË

TEZA:

**Autorizimet dhe punët policore në legjislacionin dhe
praktikën e rmv-së-gjendja dhe perspektiva**

KANDIDATI:

Elmedin LUMA

MENTORI:

Prof.Dr.Jeton SHASIVARI

Tetovë, Prill 2019

PËRMBAJTJA

HYRJA	7
Qëllimi i punimit.....	8
KAPITULLI I PARË	9
1. NOCIONI DHE LLOJET E AUTORIZIMEVE POLICORE NË ASPEKTIN LEGJISLATIV NË REPUBLIKËN E MAQEDONISË.....	9
1.1 PERCAKTIMI DHE VERIFIKIMI I IDENTITETIT TE PERSONAVE	9
1.2 THIRRJA	11
1.3 MARJA DHE SHOQËRIMI	12
1.4 KËRKIMI I PERSONAVE DHE MJETEVE.....	14
1.5 KUFIZIMI I PËRKOHSHËM I LIRISË SË LËVIZJES	14
1.6 DHËNJË E VËRTETIMEVE DHE URDHËRESAVE	14
1.7 SEKUESTRIMI I PËRKOHSHËM I SENDEVE	15
1.8 PARANDALIMI DHE URDHËRIMI	16
1.9 KONTROLLI I PERSONIT, MJETEVE DHE AUTOMJETEVE.....	17
1.10 SIGURIMI DHE KONTROLLI I VENDIT TË NGJARJES	18
1.11 NDALIMI, KONTROLLI DHE BASTISJA	19
1.12 PUBLIKIMI I SHPËRBLIMIT	20
1.13 INÇIZIMI NË VENDET PUBLIKE.....	21
1.14 PRANIMI I DENONCIMEVE	21
1.15 GRUMBULLIMI, PËRPUNIMI, ANALIZA, SHFRYTËZIMI, VLERSIMI, BARTJA, RUAJTJA DHE SHLYERJA E TË DHËNAVE DHE PËRPUNIMI I TË DHËNAVE PERSONALE.....	21
KAPITULLI I DYTË	26
2. NOCIONI DHE LLOJET E PUNËVE POLICORE NË ASPEKTIN LEGJISLATIV NË REPUBLIKËN E MAQEDONISË.....	26
2.1 MBROJTJA E JETËS, SIGURISË PERSONALE DHE TË PRONËS SË QYTETARËVE	26

2.2 MBROJTJA E LIRIVE DHE TË DREJTAT E NJERIUT DHE TË QYTETARIT TË GARANTUARA ME KUSHTETUTËN E REPUBLIKËS SË MAQEDONISË ME LIGJ DHE ME MARRËVESHJE NDËRKOMBËTARE TË RATIFIKUAR.....	27
2.3 PENGIMI I KRYERJES SË VEPRËS PENALE DHE KUNDRVAJTJEVE TË TYRE DHE NDËRMARJA E MASAVE TJERA TË PËRCAKTUARA ME LIGJ PËR NDJEKJEN E KRYERSVE TË ATYRE VEPRAVE.....	30
2.4 MAJTJA E RENDIT DHE QETËSIË PUBLIKE.....	35
2.5 RREGULLIMI DHE KONTROLLI I KOMUNIKACIONIT RRUGORË.....	36
2.6 KONTROLLI I QARKULLIMIT DHE QËNDRIMIT TË TË HUAJVE.....	39
2.7 KONTROLLI I KALIMIT KUFITARË	44
2.8 MBIKËQYRJA DHE DREJTIMI I KOMUNIKACIONIT RRUGORË NË KUFIRIN SHETËTORË.	47
2.9 OFRIMI I NDIHMËS DHE I MBROJTJES SË QYTETARËVE NË RAST TË NEVOJËS SË DOMOSDOSHME	50
2.10 SIGURIMI I PERSONAVE DHE I OBJEKTEVE TË PËRCAKTUARA ME LIGJ	51
KAPITULLI I TRETË	54
3. AUTORIZIMET POLICORE DHE TË DREJTA E NJERIUT NË REPUBLIKËN E MAQEDONISË.....	58
3.1 AKTET NDËRKOMBËTARE PËR TË DREJTAT E NJERIUT.....	58
3.2 PËRDORIMI I FORCËS FIZIKE NGA POLICIA DHE TË DREJTAT E NJERIUT	59
3.3 HETIMET POLICORE DHE TË DREJTAT E NJERIUT	61
3.4 ARRESTIMI DHE TË DREJTAT E NJERIUT	63
3.5 E DREJTA PËR GJYKIM TË DREJTË	67
3.6 PARIMI I MOS DISKRIMINIMIT TË PUNËVE POLICORE	69
3.7 EFIKASITETI I MBROJTJES SË TË DREJTAVE TË NJERIUT ME RASTIN E TEJKALIMIT TË AUTORIZIMEVE POLICORE	72
3.8. KODI I ETIKËS POLICORE.....	77
3.9 SEKTORII KONTROLLIT TË BRENDSHËM DHE STANDARDET PROFESIONALE.....	79
3.10. REZULTATET DHE DISKUTIMET	81
3.10.1 INTERVISTA ME ZYRTARË POLICORË.....	84
3.10.2 INTERVISTA ME AVOKATIN E POPULLIT.....	86
SHTOJCA.....	Error! Bookmark not defined.

PËRFUNDIMET DHE REKOMANDIMET **Error! Bookmark not defined.**

BIBLIOGRAFIA..... 104

SHKURTESAT

AP –Avokati i popullit

BE –Bashkimi Evropian

BNDP –Bordi Nacional për Drejtësi Penale

GJEDNJ - Gjykata Evropiane për të Drejtat e Njeriut

KE - Këshilli i Evropës

KKBKOT- Konventa e Kombeve të Bashkuara kundër Krimit të Organizuar Transnacional

KB -Kombet e Bashkuara

KPP- Kodi i Procedurës Penale

KEPS- Këshilli Ekzekutiv për Paqe dhe Siguri

MPB - Ministria e Punëve të Brendshme

OPB- Organet për Pune të Brendshme

OJQ - Organizatë Joqeveritare

OSBE- Organizata për siguri dhe bashkëpunim në Evropë

ODIHR -Zyra për institucione demokratike dhe të drejta njerëzore

OSBE- Organizata për Siguri dhe Bashkëpunim në Evropë

RQP-Rendi dhe Qetësia Publike

RSDP -Reforma e Sistemit të Drejtësisë Penale

MMS -Misioni mbikëqyrës në Shkup

SIOFA -Sekretariati për zbatimin e marrëveshjes kornizë të Ohrit

SDP -Sistemi i Drejtësisë Penale

AZUP- Asociacioni i Zyrtarëve Udhëheqës Policorë

KPP- Kodi i Procedurës Penale

SKBSP- Sektori i kontrollit të brendshëm dhe i Standardeve profesionale

PPTH- Prokuroria publike themelore

KP- Koordinator i projektit

OP- Oficeri i projektit

KEDNJ- Konventa Evropiane për të Drejtat e Njeriut

ZPKD- Zyrtarët Përfaqësues Konsullatat Diplomatik

DS- Drejtorisë për Sigurim

BND- Bordi për ndalimin e torturës

SKBSP-Sektori për Kontroll të Brendshëm dhe Standardet Profesionale

SKB-sektori i kontrollit të brendshëm

KESHP – Kodi i Etikës së Shërbimit Policor

SC – Sektori Civil

PA-Personave të Autorizuar

ZA -zyrtarë të policisë

HYRJA

Në këtë temë të MA do të analizohen dhe elaborohen autorizimet dhe punët policore në RMV në aspektin legjislativ dhe praktik, në kuptimin e gjendjes dhe perspektivës së tyre. Gjithashtu, do të analizohet edhe raporti i ndërsjellë midis punëve dhe autorizimeve policore dhe të drejtat e Njeriut në RMV, përmes studimit empirik të raporteve policore, të organizatave për të drejtat e njeriut, në mënyrë që të jepen rekomandimet e duhura se çka duhet të reformohet në operativitetin e policisë së RMV-së.

Si pjesë e këtij punimi do të hulumtohen edhe aktet normative në lidhje me policinë e RMV-së, shpjegimi i formularëve të cilat përdoren, rregullat se si duhet ti zbatojë policia, rregulloren e policisë në pajtim me ligjin e policisë, raportet me institucionet e tjera, bashkëpunimi i tyre etj.

Poashtu, në këtë temë do të zbërthehet edhe mënyra praktike se si funksionon policia e RMV-së dhe sa zbatohet ligji i policisë. Gjithashtu do të analizohen edhe informacionet mbi pakënaqësitë e qytetarëve ose rastet në të cilat është shkelur ligji respektivisht janë tejkaluar autorizimet policore.

Qeveria e Republikës së Maqedonisë së Veriut ka policinë që do të mbrojë qytetarët dhe do të ndjekë penalisht krimin. Vetëm një polici e tillë mund të garantojë sigurinë dhe sundimin e ligjit. Policia do të jetë jashtë ndikimit të partive politike dhe politikës ditore dhe do të garantojë zbatimin e paanshëm të ligjeve për të gjithë. Ata prezantojnë mekanizma për të përmirësuar kontrollin e jashtëm dhe të brendshëm të punës së policisë dhe shërbimeve të sigurisë. Do të forcojnë kontrollin parlamentar dhe do të krijojnë një ombudsmen të policisë me fuqinë për të kryer një hetim të pavarur mbi tejkalimin e mundshëm të kompetencave të policisë dhe shkeljeve të të drejtave dhe lirive të njeriut.

Qëllimi i punimit

Përmes këtij punimi të MA do të analizohen problemet që janë të orientuara në drejtim të shpjegimeve dhe zbërthimeve të funksionimit të policisë së Republikës së Maqedonisë së Veriut, për të kontrolluar dhe zbatuar ligjin dhe për të zgjedhur problemet me të cilat ballafaqohet shoqëria të cilat janë probleme kyçe gjatë punës së policisë ku këto të fundit kanë për detyrë që ti mbrojnë qytetarët që të kenë një siguri në shtetin e tyre.

Gjithashtu në punim do të analizohet edhe bashkëpunimi i policisë me institucionet e tjera në lidhje me të drejtat e njeriut, se a respektohen ato apo thjeshtë janë të evidentuara në dokumentet zyrtare shtetërore.

Si qëllim tjetër do të jenë edhe mangësitë dhe dobësitë e respektimit të ligjit për policinë, kushtet, detyrat, aktivitetet, struktura dhe organizimi i një pjesë në tërësi që ato i shfrytëzojnë për parandalime dukurive kriminale apo cenimin e të drejtës së palës ose të qytetarit. Nëpërmjet këtij punimi do të hulumtohet edhe ndikimi i policisë se sa ka arritur që ta parandalojë dukurinë kriminale, e cila ka marrë hov të madh në vendin tonë duke filluar nga njerëz të thjeshtë e deri te funksionarë të cilët e shfrytëzojnë edhe pushtetin për të arritur të mira materiale të pa ligjshme.

KAPITULLI I PARË

1. NOCIONI DHE LLOJET E AUTORIZIMEVE POLICORE NË ASPEKTIN LEGJISLATIV NË REPUBLIKËN E MAQEDONISË SË VERIUT

1.1 PËRCAKTIMI DHE VERIFIKIMI I IDENTITETIT TE PERSONAVE

Me Ligjin për policinë rregullohen punët policore në përgjithësi, ku sipas dispozitave ligjore të Ligjit për Policinë, parashihet vërtetimi i identitetit i cili e dëshmon se i përket personit në fjalë ku dhe vërtetohet me dokumentacion si dhe në mënyrë më të detajuar edhe në bazë të shenjave trupore (marrja e shenjave të gishtërinjve, ADN-së, konstruksionit trupor etj).

Sipas kësaj dispozite ligjore¹, kontrolli i identitetit të personit do të zbatohet ndaj personit:

1. Që duhet të privohet nga liria, të arrestohet, të mbahet në arrest, të dërgohet ose të dorëzohet te organet kompetent shtetëror ose institucionet.
2. Prej të cilit kërcënohet rreziku për pengimin kuështë i domosdoshëm veprimi policor.
3. Ndaj të cilit bëhet kontrolli ose bastisja ose merren masa dhe aktivitete të tjera të përcaktuara me ligj.
4. I cili është hasur në shtëpi në objekte dhe lokale të tjera të huaja, ose në mjete transportuese mbi të cilat bëhet kontrolli i identitetit.
5. Që është hasur në hapësira ose në objekte në të cilat përkohësisht është e kufizuar liria e lëvizjes dhe e qëndrimit nëse kontrolli detyrimisht është i nevojshëm.
6. I cili denoncon vepër të kryer penale ose kundërvajtje, ose kryerësit e atyre veprave, respektivisht posedon informata me interes për punën e policisë, përveç nëse personi i cili e denoncon veprën penale ose kundërvajtjen nuk dëshiron të identifikohet.
7. I cili me sjelljen e vetë ngjall dyshime se është kryerësi i veprës penale ose kundërvajtjes ose ka qëllim të bëjë vepra të tilla ose i cili i përgjigjet përshkrimit të personit i cili është në kërkim

¹ Neni 38 I Ligjit për Policinë e RM-së. Gazeta Zyrtare nr.114-03.11.2006-faqe 23

8. I cili gjendet në vendin e veprës së kryer penale ose të kundërvajtjes.
9. I cili gjendet në vendin në të cilin për arsye të shkaqeve të sigurisë është e nevojshme të përcaktohet identiteti i të gjithë personave ose të një numri më të madh të njerëzve.
10. Me kërkesën e arsyeshme të personit zyrtarë të organit shtetërorë, personi juridik ose fizik.

Në raste të tjera të përcaktuara me ligj kërkesa e arsyeshme nga paragrafi 1 pika 10 e këtij neni është kërkesa prej së cilës shihet qartë se personit zyrtarë, të dhënat i janë të domosdoshme për veprim ligjor ose kur personi fizik i është cenuar ndonjë e drejtë. Nëpunësi policor është i detyruar ta njoftojë personin për shkaqet për kontrollin e identitetit të tij.² Kontrolli i identitetit të personit bëhet me shikim në letërnjoftimin e tij ose të ndonjë dokumenti tjetër identifikues personal me fotografinë e tij. Me përjashtim nga paragrafi 1 i këtij neni identiteti mund të vërtetohet në bazë të deklaratës të personit, identiteti i të cilit është vërtetuar ose është i njohur për nëpunësi zyrtarë. Nëpunësi policor mundë ti mbajë dokumentet për verifikimin e identitetit të personit vetëm gjatë kohës së nevojshme për vërtetimin e identitetit, e më pas menjëherëja kthen personit.

Nëse personi refuzon ose nuk ka mundësi të jep të dhënat për vete ose të dëshmojë identitetin, mund të mbahet në arrest për një kohë aq sa nevojitet për vërtetimin e identitetit të tij, por jo ma gjatë se tri orë përveç kur janë plotësuar kushtet nga neni 50 i këtij ligji.

Personi i cili është mbajtur në arrest në kuptim të paragrafit 4 të këtij neni, i mundësohet identitetin ta dëshmojë në çfarëdo mënyre.³ Identiteti i personit përcaktohet kur personi i posedon dokumentet nga neni 39 paragrafi 1 i këtij ligji ose kur ekziston dyshimi në autenticitetin e këtyre dokumenteve, si dhe kur identiteti nuk është përcaktuar në pajtim me nenin 39 paragrafi 1 i këtij ligji.

Identiteti i personit nga paragrafi 1 i këtij neni përcaktohet me shfrytëzimin e metodave dhe mjeteve të taktikës dhe teknikës kriminalistike, ekspertizave mjekësore dhe ekspertizave të tjera adekuate.

Nëse identifikimi i identitetit të personit nuk mund të bëhet në pajtim me paragrafin 1 dhe 2 të këtij neni, Ministria është e autorizuar që publikisht të shpallë përshkrimin e personit, inçizimet, vizatimet ose fotografi të personit.

²Neni 39 I Ligjit për Policinë e RM-së.Gazeta Zyrtare nr.114-03.11.2006-faqe 23

³Neni 40 I Ligjit për Policinë e RM-së.Gazeta Zyrtare nr.114-03.11.2006-faqe 23

Kur identiteti nuk mund të verifikohet në mënyrë tjetër, Ministria është e detyruar të shpallë fotografinë e personit i cili për vete nuk mundë të japë të dhëna personale ose të trupit të panjohur.⁴ Përcaktimi i identitetit të sendit bëhet për shkak të verifikimit të ngjashmërisë, të shenjave dhe cilësive të sendit ose marrëdhënies midis personave ose ngjarjeve dhe sendeve. Ministria është e autorizuar që publikisht të shpallë fotografi, vizatim, inçizim ose përshkrim të sendit nëse kjo është e rëndësishme për përcaktimin e identitetit të sendeve. Ligji i policisë së Republikës së Maqedonisë.

1.2 THIRRJA

Thirrja si autorizim policor rregullohet me Ligjin për policinë konkretisht nenin 43. Në këtë pjesë bëhet fjalë për thirrjen e personave të dyshuar nga ana e policisë ku i bëjnë thirrje personit në fjalë që të paraqitet tek organet kompetente për konsultim ose intervistim për të marrë informacionet e nevojshme nga i thërrituri. Policia është e autorizuar që me shkrim, me fletë thirrje të thërras qytetarët për shkak të grumbullimit të informative të nevojshme të domosdoshme për kryerjen e punëve policore.

Fletë thirrja(nga Neni 43.Paragrafi 1)⁵ përmban: Emrin Mbiemrin e personit i cili thirret, vendin dhe adresën e vendbanimit ku jeton, shkaqet e thirrjes, vendi dhe koha e thirrjes, këshilli për të drejtën e mbrojtjes në procedure policore, si dhe pasojat nëse nuk i përgjigjet thirrjes.

Personi i thirrur mund të sillet me detyrim vetëm me urdhër të gjykatës dhe vetëm atëherë kur qartë shihet se i shmanget që të paraqitet në thirrjen e dërguar në mënyrë të rregullt në të cilën është paralajmëruar për mundësinë e marrjes me detyrim edhe atëherë kur nuk do të arsyetojë mosardhjen e vetë.

Personi i cili do ti përgjigjet thirrjes, ose është sjellë me detyrim, kurse ka refuzuar të japë informata nuk guxon për herë të dytë të thirret për të njëjtin shkak.

Personi që është thirrur ose që është sjellur me detyrim këshillohet për të drejtat nga Neni 34⁶ i këtij ligji si dhe për rrethanat se i njëjti nuk është privuar nga liria dhe se pasi që të jep ose të refuzojë të japë informata, mundë që të shkojë.

⁴Neni 41 i Ligjit për Policinë e RM-së.Gazeta Zyrtare nr.114-03.11.2006-faqe 23

⁵Neni 43 i Ligjit për Policinë e RM-së.Gazeta Zyrtare nr.114-03.11.2006-faqe 23

⁶Neni 34 I Ligjit për Policinë e Republikës së Maqedonisë.

Për thirrjen dhe bisedën e kryer me personin e thirrur, nëpunësi policorë përgatit shënimin zyrtarë. Personi mund të thirret në kohën prej orës 06:00 deri në orën 22:00. Nëse ekziston rrezik nga prolongimi, nëpunësi policorë është i autorizuar ta thërras personin edhe jashtë kohës së caktuar. Nëpunësi policorë është i autorizuar ta thërras personin edhe gojarisht me ç'rast është i detyruar që ta informojë me shkaqet për thirrjen, ndërsa me pëlqimin e personit mundë ta çojë deri te vendet zyrtare.⁷

Personi mund që të thirret edhe nëpërmjet mjeteve të informimit publik, kur kjo është e domosdoshme dhe e nevojshme për shkak të rrezikut të shtyrjes, sigurisë së veprimit ose kur fletë thirrja u dërgohet një numri më të madh të personave.

Thirrja e personit të mitur bëhet me dorëzimin e fletë thirrjes me shkrim te prindërit ose te kujdestari.⁸

1.3 MARJA DHE SHOQËRIMI

Me marrjen dhe shoqërimin nënkuptojmë kur personat zyrtarë të autorizuar arrestojnë një person dhe e dërgojnë në paraburgim ose burgim ose e dërgojnë (shoqërojnë) në gjykatë, spital, burg etj. Personi mund të arrestohet në bazë të urdhërit me shkrim të lëshuar nga gjykata kompetente, personi mundë të arrestohet për shkak të dërgimit në stacionet e policisë, në organet tjera kompetente ose deri në vendin e caktuar në urdhëresë, nëpunësi policorë është i obliguar që personin të cilin duhet ta arrestojë t'i japë urdhëresën.⁹

Nëpunësi policorë nuk do ti dorëzojë urdhëresën personit i cili në mënyrë të bazuar dyshohet se do të bëjë rezistencë. Personi mund të arrestohet në kohën prej orës 06:00 deri në orën 22:00. Në rast kur arrestimi është i detyrueshëm për shkak të marrjes së punëve policore të cilat nuk mund të shtyhen atëherë personi mund të arrestohet edhe jashtë kohës së përcaktuar në nenin 46 paragrafi 5.¹⁰

Arrestimi pa urdhëresë me shkrim mund të bëhet ndaj personit:

- Identiteti i të cilit duhet të përcaktohet
- Për të cilin është lëshuar fletë arrest
- Të hasur në kryerjen e veprës penale për të cilën ndiqet me detyrë zyrtare

⁷Neni 45 I Ligjit për Policinë e RM-së.Gazeta Zyrtare nr.114-03.11.2006-faqe 23

⁸Neni 45 I Ligjit për Policinë e RM-së.Gazeta Zyrtare nr.114-03.11.2006-faqe 23

⁹Neni 46.Paragrafi 5 I Ligjit për Policinë e RM-së.Gazeta Zyrtare nr.114-03.11.2006-faqe 23

¹⁰Neni 47.45.Paragrafi 5 I Ligjit për Policinë e RM-së.Gazeta Zyrtare nr.114-03.11.2006-faqe 23

- Tëhasur në kryerjen e kundërvajtjes me elemente dhune.

Dispozitat për arrestimin nuk zbatohen ndaj personit për të cilin me arsye supozohet se arrestimi i tij në mënyrë të konsiderueshme do ta dëmtojë shëndetin e tij.

Në qoftë se arrestimi bëhet me urdhër të gjykatës për shkaqe nga neni 48, paragrafi 1¹¹ lajmërohet gjykata që e ka lëshuar urdhrin për arrestim.

Dispozitat për arrestim nuk zbatohen edhe ndaj personit i cili kryen punë të cilat nuk guxojnë që të ndërpriten deri sat ë sigurohet zëvendësimi përkatës. Nëpunësi policor është i obliguar që personi i cili arrestohet, para arrestimit ta njoftojë me të drejtat nga neni 34 i këtij ligji.

Mbajtja dhe shoqërimi

Me mbajtjen nënkuptojmë si për shembull paraburgimi deri sa personit t'i rregullohen procedurat për daljen para drejtësisë ai do të mbahet nga policia dhe pastaj do të shoqërohet, dërgohet për në gjykatë dhe me vendim të gjykatës dorëzohet në burgim. Nëpunësi policor mund ta mbajë në arrest personin për të cilin ekzistojnë baza për dyshimin se ka bërë veprë penale për të cilën ndiqet me detyrë zyrtare nën kushte dhe në mënyrë të përcaktuar me ligj të veçantë me ç'rast mbajtja në arrest mund të zgjas më së shumti 24 orë.

Nëpunësi policor mundë ta mbajë në arrest personin e hasur gjatë kryerjes së kundërvajtjes nën kushte dhe në mënyrë të përcaktuar me ligj të veçantë, si dhe personin i cili e prish ose e rrezikon rendin dhe qetësinë publike ose evitimi i rrezikut nuk mund të arrihet në mënyrë tjetër.

Mbajtja në arrest mund të zgjas më së shumti 12 orë.¹²

Nëpunësi policorë mund ta mbajë në arrest personin nën ndikimin e alkoolit ose të materieve të tjera psikotropike nën kushte dhe në mënyrë të përcaktuar me ligj të veçantë, me çrast mbajtja në arrestmund të zgjas më së shumti 8 orë.

Personi të cilin e ka dorëzuar organi i jashtëm i sigurimit për shkak të përcjelljes të organit shtetëror kompetent mund të mbahet në arrest më së shumti 24 orë.

Mbajtja në arrest ndërpritet menjëherë pas pushimit të shkaqeve për mbajtje në arrest.

¹¹Neni 48.Paragrafi 1 I Ligjit për Policinë e RM-së.Gazeta Zyrtare nr.114-03.11.2006-faqe 23

¹²Neni 50.Paragrafi 2 I Ligjit për Policinë e RM-së.Gazeta Zyrtare nr.114-03.11.2006-faqe 23

1.4 KËRKIMI I PERSONAVE DHE MJETEVE

Kur policia ka dyshime ose ka informacione për personin i cili e ka shkelur ligjin dhe kërkohet që të sillet para drejtësisë dhe të dëshmojë për kryerjen e veprës njëkohësisht policia duhet që ti sigurojë edhe mjetet me të cilat ka vepruar personi ose mjetet që janë të jashtë ligjshme.

Policia është kompetente të zbatoj masa kërkimi pas personave dhe sendeve.

Masat për kërkim nga neni 51, paragrafi 1¹³ fletarrestimi, Qarkorja dhe shpallja.

Fletarrestimi shpallet për personat për të cilët është dhënë urdhër në pajtim me ligjin.

Qarkorja shpallet për:

- Personin për të cilin ekzistojnë baza dyshimi se është kryerësi i veprës penale ose i kundërvajtje, ose për personin i cili mund të jap njoftim për vepra penale, kundërvajtje të kryera ose për kryerësin e veprave të tilla
- Për persona të zhdukur
- Shpallja jepet për vërtetimin e vendbanimit ose vendqëndrimit të personit

1.5 KUFIZIMI I PËRKOHSHËM I LIRISË SË LËVIZJES

Ky autorizim policor nënkupton se personi është në paraburgim ose në burgim për një kohë të caktuar deri sa të vërtetohet pafajësia e tij ose deri sa të mbarojë dënimi i marrë për veprën penale d.m.th. deri sa ta mbarojë burgun neni 50¹⁴

1.6 DHËNJA E VËRTETIMEVE DHE URDHËRESAVE

Nëpunësi policor ka autorizim që të tërheq vëmendjen ose të urdhëroj personin që me sjelljen, veprimin e tij mund të vë në rrezik sigurinë e tij, sigurinë e një personi tjetër ose sigurinë e pasurisë ose mundë që ta rrezikojë sigurinë në komunikacion, të rrezikojë rendin publik dhe qetësinë ose të provokojë ndonjë person tjetër që të kryej vepër penale apo kundërvajtje.

Urdhërat jepen me qëllim që:

- Të evitohet rreziku për jetë dhe sigurinë personale të qytetarëve
- Të evitohet rreziku për sigurinë e pronës

¹³Neni 50.Paragrafi 1 I Ligjit për Policinë e RM-së.Gazeta Zyrtare nr.114-03.11.2006

¹⁴Po aty

- Të parandalojë kryerjen e veprës penale, shkeljeve dhe kundërvajtjeve, të kapë kryerësit e tyre dhe të gjejë dhe të sigurojë gjurmët e veprave të cilat mund të shërbejnë si dëshmi
- Të ruhet rendi dhe qetësia publike dhe të rivendoset rendi dhe qetësia publike e prishur
- Të krijojë siguri në komunikacion
- Të ndalojë qasjen ose qëndrimin në hapësirat ose objektet ku kjo nuk është e lejuar
- Të parandalojë dhe të evitojë pasojat në raste rreziku të përgjithshëm, të shkaktuara nga fatkeqësitë, epidemitë dhe format tjera të rrezikshme të sigurisë së përgjithshme.¹⁵

1.7 SEKUESTRIMI I PËRKOHSHËM I SENDEVE

Ky autorizim nënkupton që, mjetet, gjërat apo sendet që i përkasin personit ku dyshohet se kanë të bëjnë me veprën penale, policia i merr për një kohë që t'i shikojë, analizojë ose t'i kontrollojë dhe në qoftë se nuk janë të përfshira gjërat e marra nga personi atëherë ato i kthehen po të njëjtit.¹⁶

Nëpunësi policor përkohësisht do të sekuestrojë sendet:

- Kur rrethanat tregojnë se me sendin e caktuar është e kryer vepra penale ose kundërvajtja, si dhe sendet që janë rezultatet nga vepra penale ose kundërvajtje e kryer ose sendi është i dedikuar për kryerjen e veprës penale ose kundërvajtjeve.
- Kur për shkak të ruajtjes të sigurisë së përgjithshme sekuestrimi i sendit është doemos i nevojshëm.
- Personit të cilit i është kufizuar përkohësisht liria e lëvizjes, ndërsa posedon ose mund të përdor sendin për vetëplagosje, sulm ose ikje.
- I cili mund të shërbejë si dëshmi në procedurë. Për sendet përkohësisht të sekuestruara, nëpunësi policor është i obliguar të japë vërtetim. Në vërtetim theksohen shënimet e sendit të sekuestruara përkohësisht sipas të cilave ai dallohet nga sendet e tjera, si dhe të dhënat për personin prej të cilit është marrë sendi, koha kur është marrësendi dhe vendi ku është marrë sendi.¹⁷ Kur për shkak të veçorive të sendit përkohësisht të sekuestruar, ruajtja në vendet e policisë nuk është e mundur ose është e lidhur me vështirësi të shumta, sendi i

¹⁵ Neni 200 dhe 201 i Ligjit për policinë i bazuar në sigurinë e komunikacionit rrugor (Lista zyrtare nr.50/88,80/89,29/90,11/91) dhe (Gazeta Zyrtare e RM-së nr.12/93,8/95);(Neni 195.Paragrafi 1 dhe 2 i Rregullores për kryerjen e punëve të mbrendshme)

¹⁶ Neni 57 i Ligjit për policinë e RM-së,Gazeta Zyrtare e RM-së,nr.114

¹⁷ Neni 58 i Ligjit për policinë e RM-së,Gazeta Zyrtare e RM-së,nr.114

sequestruar përkohësisht mund të vendoset, të ruhet ose të sigurohet në mënyrë përkatëse dhe në vend përkatës deri në marrjen e vendimit të organit kompetent shtetëror.

Kur do të pushojnë shkaqet për të cilat sendi është sequestruar përkohësisht, ndërsa kur me ligj tjetër ose vendim të organit kompetent shtetërorë nuk është përcaktuar ndryshe, sendi i sequestruar përkohësisht do ti kthehet personit të cilit i është marrë.¹⁸ Nëse personi i thirrur nuk merr sendet përkohësisht të sequestruara në afatin e caktuar kohor në pajtim me këtë ligj, që nuk mund të jetë më i shkurtër se 1 muaj.

Ministria mund të organizojë shitjen e tyre kur për procedurën e mëtejshme nuk është kompetent gjykata ose organi i administratës shtetërore, nëse:

- Kërcënohet rreziku nga shkatërrimi ose humbja e konsiderueshme e vlerës së sendit,
- Rruajtja dhe mirëmbajtja e sendit është e lidhur me shpenzimet joproporcionale ose vështirësi të tjera.

Mjetet nga shitja e sendit përkohësisht të sequestruara nga neni 59, paragrafi 1 janë të hyra të buxhetit të Republikës së Maqedonisë.

1.8 PARANDALIMI DHE URDHËRIMI

Policia e urdhëron personin që të ndaloj ku edhe e urdhëron dhe në qoftë se nuk ndalon atëherë merren masa për ndalimin e tij.¹⁹ Nëpunësi policor do ta paralajmërojë personin i cili me sjelljen e vetë me veprimin ose moszbatimin e veprimeve të caktuara mund të sjellë në rrezik sigurinë e vete, sigurinë e personave të tjerë ose sigurinë e pronës, ta prishë rendin dhe qetësinë publike, ta rrezikojë sigurinë e komunikacionit rrugorë ose kur pritet me arsye se ai person mund të kryej ose të nxis personat e tjerë të bëjnë veprë penale ose kundërvajtje.²⁰

Nëpunësi policor në kryerjen e punëve policore mund të jap urdhër gojarisht në rast kur kjo është e nevojshme:

- Që të mbrohet jeta dhe siguria personale e personave dhe e pronës.
- Që të parandalohet kryerja e veprës penale ose kundërvajtjes për të cilën ndiqet që të sigurohen gjurmë të veprës penale ose sendeve që mund të shërbejnë si dëshmi në procedurën penale ose për kundërvajtje.

¹⁸Neni 59.Paragrafi 1 i Ligjit për policinë e RM-së,Gazeta Zyrtare e RM-së,nr.114

¹⁹Neni 54 i Ligjit për policinë e RM-së,Gazeta Zyrtare e RM-së,nr.114

²⁰Neni 55 i Ligjit për policinë e RM-së,Gazeta Zyrtare e RM-së,nr.114

- Të mbahet rendi ose të pengohet prishja e rendit dhe qetësisë publike, si dhe për rivendosjen e rendit dhe qetësisë publike të prishur.
- Për mbrojtjen e sigurisë së objekteve dhe personave të cilët sigurohen.
- Për kontroll, rregullimin dhe sigurimin në komunikacionin rrugor
- Për sigurimin e kufirit shtetëror.
- Për shpëtimin e njerëzve dhe mënjanimin e pasojave nga fatkeqësitë natyrore dhe fatkeqësitë të tjera.

Paralajmërimi dhe urdhërimi bëhen në mënyrë të qartë, të padyshimtë dhe të kuptueshëm sipas nenit 56.²¹

1.9 KONTROLLI I PERSONIT, MJETEVE DHE AUTOMJETEVE

Nëpunësi policor është i autorizuar të bëjë kontrollin e personit, mjetit që gjendet te personi dhe mjetin e bashkangjitur në qoftë se ka, në rast se kjo është e nevojshme për të gjetur diçka të pa përshtatshme për sulm apo për vetë lëndim. Zakonisht kontrolli i personit konsiderohet shikimi i përmbajtjes së veshjes dhe mbathjes, ndërsa kontrolli i mjetit të komunikacionit konsiderohet shikimi të gjitha hapësirave të hapura dhe të mbyllura të mjetit të komunikacionit dhe të mjeteve dhe gjërave që transportohen me të.

Kontrolli i mjetit që e ka me vete personi përfshinë kontrollin e mjetit që e ka me vete personi ose mjetin që është në afërsi të personit, por edhe mjetet me autorizim apo në shoqërim të të cilit transportohet.

Kontrollin e personit duhet ta bëjë personi i të njëjtës gjini, përveç në raste kur është i domosdoshëm kontrolli i shpejtë i personit, me qëllim të konfiskimit të armës ose mjetit të përshtatshëm për sulm apo për vetëlëndim.

Me rastin e kontrollit nëpunësi policor është i autorizuar që ti shfrytëzojë mjetet teknike dhe qenin zyrtarë.

Gjatë ndërmarrjes së këtyre masave nëpunësi policor është i autorizuar të hapë në mënyrë të dhunshme mjetin e mbyllur të komunikacionit ose mjetin të cilin personi e ka me vete.

Në qoftë se ekziston dyshimi bazuar në mjetin e komunikacionit që e ka me vete, personi që kontrollohet ka mjete që mundë të shërbejnë si dëshmi në procedurën penale ose në procedurën para gjykatëspër kundërvajtje, nëpunësi policor është i autorizuar ta ndalojë

²¹Neni 56 i Ligjit për policinë e RM-së, Gazeta Zyrtare e RM-së, nr.114

personin derisa të sigurojë urdhëresën për kontroll, por më së shumti 6 orë. Nëpunësi policorë mund të bëjë kontrollin me vështirësi, me prekje, me shikim në përmbajtje, me shfrytëzimin e mjeteve teknike (pasqyrave, detektorëve, qenve zyrtarë etj). Si rregull nëpunësi policor e veçon nga personat e tjerë, personin që do të kontrollojë dhe para fillimit të kontrollit, e njofton për arsyet e kontrollit.

Nëpunësi policorë nuk vepron në këtë mënyrë vetëm me rastin e kryerjes së kontrollit në qoftë se kështu e vë në pikëpyetje kryerjen e kontrollit ose në qoftë se me këtë veprim vë në pikëpyetje kryerjen e detyrës zyrtare. Para kryerjes së kontrollit të mjetit të komunikacionit, nëpunësi policorë i kërkon personit të mundësojë të shohë përmbajtjen e mjetit gjegjësisht të mjetit të komunikacionit të cilin do ta kontrollojë.

Në qoftë se personi refuzon të mundësohet kontrolli nga nëpunësi policorë atëherë ky i fundit e verifikon vetë përmbajtjen e mjetit apo mjetit të komunikacionit që e kontrollojnë.

Nëpunësi policorë me rastin e hapjes së dhunshme të mjetit apo mjetit të komunikacionit të mbyllur duhet të kujdeset që të shkaktojë dëme sa më të vogla, kurse pas hapjes në rast të dëmtimit është i obliguar të ndërmarrë masa që dëmi i shkaktuar të fiksohet në fotografi apo në ndonjë mënyrë tjetër të përshtatshme.

Kur nëpunësi policorë gjatë kontrollit konstaton se ekzistojnë rrethana që e bëjnë të nevojshme kryerjen e kontrollit, kërkon urdhëresë nga gjykata kompetente për zbatimin e këtij veprimi.

Nëpunësi policorë ndërpretë mbajtjen e personit që duhet ta kontrollojë në qoftë se në afat prej 6 orësh nuk e siguron urdhëresën për kryerjen e kontrollit.

Kjo është praktika në shumicën e vendeve të Bashkimit Evropian. Përfshirë nga këto rregulla zyrtarët e anti-diversionit të cilët bëjnë kontroll kundër eksplozivëve, në të gjitha paketat dhe dërgesat postare dhe të tjera që i dërgohen policisë apo në ndërtesat të personave të mbrojtur, në adresë të objekteve dhe lokaleve të cilat gjenden nën masat e sigurisë.

1.10 SIGURIMI DHE KONTROLI I VENDIT TË NGJARJES

Është obligative që policia ta sigurojë vendin e ngjarjes me qëllim që të mos humbin ose zhduken informacionet e rëndësishme të cilat mund ta dëshmojnë ngjarjen e ndodhur.²² Kur nëpunësi policorë kupton për veprën penale, kundërvajtje ose ngjarje për çka duhet të bëjë

²²Neni 22 i Ligjit për policinë e RM-së, Gazeta Zyrtare e RM-së, nr.114

shënim të drejtpërdrejt, verifikim ose sqarimin e fakteve. Nëpunësi policorë është i autorizuar që të sigurojë vendin e ngjarjes deri sa të arrijnë personat zyrtarë kompetent të organeve shtetërore, të njëjtin ta kontrollojnë për shkak të zbulimit dhe sigurimit të gjurmëve të veprës penale dhe sendeve që mund të shërbejnë si dëshmi, gjetjen e kryerësit si dhe grumbullimin e informative penale, kundërvajtjeve ose ngjarjeve.

Nëpunësi policorë është i obliguar të ndërmarrë masa dhe aktivitetet përkatëse për ofrimin e ndihmës prolongim të personave të pësuar dhe mënjanimin e pasojave të pësuar dhe mënjanimin e pasojave nga vepra penale, kundërvajtjeve ose ngjarjeve.

Nëpunësi policorë ka të drejtë që personat e hasur në vendin e kryerjes së veprës penale t'i dërgojë te gjykatësi hetues ose ti mbajë në arrest deri në ardhjen e tij, më së shumti 6 orë, nëse ata mundin të japin të dhëna të rëndësishme për procedurën penale dhe nëse është e besueshme se më vonë nuk do të mundë të bëhej dëgjimi i tyre, kjo do të mund të lidhet me prolongimin e konsiderueshëm ose me vështirësi të tjera.

Për shkak të mbrojtjes së viktimave të veprës penale ose kundërvajtjes ose për shkak të mbrojtjes së interesave të procedurës, nëpunësi policorë është i autorizuar të ndalojë inçizimin e vendit të ngjarjes.

1.11 NDALIMI, KONTROLLI DHE BASTISJA

Në këtë autorizim ligjor policia bën ndalimin e automjeteve i kontrollon ato dhe pasagjerët në të dhe nëse ka dyshim ose informacion ka të drejtën e kontrollit të detajuar siç e parashikon neni 61.²³

Nëpunësi policor është i autorizuar të bëjë ndalimin, legjitimin, kontrollin ose bastisjen e personit, të mjetit transportues dhe bagazhit, të cilin personi e mbanë me vete kur kjo është e domosdoshme për shkak të gjetjes së sendeve të përshtatshme për sulm ose vetëlëndim, ose kur ekzistojnë baza dyshimi se te ata do të gjenden gjurmë të veprës penale ose sende që mund të shfrytëzohen si dëshmi.

Me kontrollin e personit në kuptim të Nenit 61 Paragrafi 1 konsiderohet inspektimi dhe kontrolli i veshmbathjes.

Me kontrollin e mjeteve transportuese në kuptim të Paragrafit 1 të këtij Neni konsiderohet kontrolli i gjithë lokaleve të mbyllura dhe të hapura dhe vendeve në mjetin transportues dhe

²³Neni 61 i Ligjit për policinë e RM-së, Gazeta Zyrtare e RM-së, nr.114

bagazhin i cili transportohet. Kontrollin e personave mund ta bëjë vetëm personi i së njëjtës gjini, përveç në rastet e veçanta kur është i domosdoshëm kontrolli urgjent i personit për shkak të marrjes së armës ose sendit të përshtatshëm për sulm ose vetëlëndim.

Gjatë kontrollit nëpunësit policorë janë të autorizuar të përdorin mjetet teknike ose qentë zyrtarë (K9).

Nëse ekzistojnë baza dyshimi se personi i cili kontrollohet në mjetin transportues ose në bagazhin të cilin e mban me vete posedon armë ose sende të cilat mund ti shfrytëzojë si dëshmi në procedurën penale ose për kundërvajtje, nëpunësi policor është i autorizuar të mbajë në arrest personin në vendin ku bohet kontrolli nderi në sigurimin e urdhrit gjyqësorë për bastisje, por jo më gjatë se 6 orë.

Pas sigurimit të urdhrit për bastisje nga neni 61, paragrafi 6²⁴ nëpunësi policor është i autorizuar të përdorë forcë të arsyeshme si mjetin e fundit nëse kjo është e detyrueshme që të bëhet bastisja e personit ose me forcë të hap mjetin transportues të mbyllur ose bagazhin të cilin personi e mbanë me vete, ndërsa refuzon të hap vullnetarisht.

1.12 PUBLIKIMI I SHPËRBLIMIT

Kur policia nuk ka shumë informacion për personin në fjalë ose vendndodhjen e tij atëherë publikon të dhënat që i posedon dhe jep shpërblim për informacionin që do e merë.²⁵ Policia është e autorizuar të shpallë publikisht shpërblime për informatën e dhënë për shkak të:

- Zbulimit dhe kapjes së kryerësit të veprës penale.
- Gjetjen e personave të zhdukur.
- Rastet të tjera të arsyeshme, kur informatat nga qytetarët janë të nevojshme për shkak të kryerjes së punëve policore.

Shpallja e shpërblimit botohet në mjetet e informimit publik ose në mënyrë tjetër të volitshme.

Të drejtën e shpërblimit nuk mund ta realizojë personi i cili ka dhënë informatë për shpërblimin e shpallur, në qoftë se policia tashmë ka poseduar informatë të tillë ose të dhëna të tilla.

²⁴Neni 61.Paragrafi 6 i Ligjit për policinë e RM-së,Gazeta Zyrtare e RM-së,03.11.2006.nr.114.Faqe 25

²⁵Neni 62 i Ligjit për policinë e RM-së,Gazeta Zyrtare e RM-së,03.11.2006.nr.114.Faqe26

1.13 INÇIZIMI NË VENDET PUBLIKE

Inçizimi bëhet që të kenë fakte për ngjarjen e ndodhur dhe që të mund të bëhen analiza të mëtejshme të rastit, me inçizim të vendeve publike në kuptim të këtij ligji, nënkuptohet mbikëqyrja e përhershme audio dhe vizuale mbi vendet publike ku shpesh bëhen vepra penale ose kundërvajtjeje me qëllim të parandalimit të tyre.

Kur ekziston rreziku që në tubimet publike të rrezikohet jeta, shëndeti i njerëzve dhe pasuria, nëpunësi policorë është i autorizuar të bëjë inçizimin vizual ose fotografimin e tubimit publik. Qëllimin e zbatimit të inçizimit të vendeve dhe tubimeve publike para fillimit të aktivitetit, policia mund të komunikojë publikisht.²⁶

Materiali i inçizuar i paragrafëve 1 dhe 2 të këtij neni rruhen 6 muaj në polici, pastaj materiali shkatërrohet, përveç materialit që paraqet argument në procedurën penale ose për kundërvajtje, me të cilën veprohet në pajtim me ligjin.

1.14 PRANIMI I DENONCIMEVE

MPB-ja është e obliguar që nga qytetarët të marrë denoncime për shqetësimet e tyre dhe duhet që të veprojë për rastet që paraqiten dhe ti zgjedh ato.²⁷ Nëpunësi policor pranon fletëdenoncimet penale për vepra penale për të cilat bëhet ndjekja me detyrë zyrtare dhe të fletëdenoncimeve për kundërvajtje.

Kur gjatë parashtrimit të fletëdenoncimit penal (nga neni 63, paragrafi 1 ose) gjatë kryerjes së inspektimit vërtetohet se bëhet fjalë për vepër penale për të cilën ndiqet sipas padisë private ose përcaktohet se veprat nuk ka karakterin e veprës ndëshkuese, nëpunësi policor është i obliguar të njoftojë të dëmtuarit në afat prej 15 ditësh.

1.15 GRUMBULLIMI, PËRPUNIMI, ANALIZA, SHFRYTËZIMI, VLERSIMI, BARTJA, RUAJTJA DHE SHLYERJA E TË DHËNAVE DHE PËRPUNIMI I TË DHËNAVE PERSONALE

Policia është e autorizuar që sa më shumë të grumbullojë informacione fakte dhe ti shfrytëzojë ato të gjitha ti analizojë se për çfarë do tu shërbejnë qytetarëve dhe vetë organeve, të mos

²⁶Neni 63.Paragrafi 1 i Ligjit për policinë e RM-së,Gazeta Zyrtare e RM-së,03.11.2006.nr.114

²⁷Neni 63.Paragrafi 1 i Ligjit për policinë e RM-së,Gazeta Zyrtare e RM-së,03.11.2006.nr.114.Faqe 26

keqpërdoren të dhënat personale ato i shlyejnë pjesën të cilat me nuk vlejnë për shërbim ose nëse janë të vlefshme ato i bartin transferojnë tek organet tjera përkatëse për këtë drejtim,²⁸ policia grumbullon, përpunon, analizon, shfrytëzon, vlerëson, bartë, ruan dhe shlyen të dhënat, përpunon të dhënat personale në kushte dhe në mënyrë të përcaktuar me këtë ligj dhe ligje të veçanta dhe mbanë evidencë për të dhënat personale dhe te dhënat të tjera për grumbullimin e të cilave është e autorizuar me këtë ligj, për shkak të pengimit dhe zbulimit të veprave penale dhe kundërvajtjeve, si dhe gjetjen dhe kapjen e kryerësve të tyre.

Policia përpunon të dhënat personale kur ekzistojnë baza dyshimi se personi ka kryer vepër penale, është i përfshirë ose ka qenë i ndikuar në planifikimin, organizimin, financimin, ose në kryerjen e veprës penale.

Të dhënat për personin juridik grumbullohen kur ekzistojnë baza dyshimi se personi juridik është i indikuar ose ka qenë i indikuar në kryerjen apo tentimin për kryerjen e veprës penale, si dhe kur personi juridik shfrytëzohet për planifikimin, organizimin, udhëheqjen dhe financimin e aktiviteteve kriminale ose shfrytëzimin për mbulimin e të dhënave kriminale,²⁹ të dhënat personale sipas këtij ligji janë:

- Emri personal
- Të dhënat për lindje (dita, muaj, viti, vendi)
- Vendbanimi ose vendqëndrimi si dhe
- Shtetësia, ose të dhënat të tjera përmes të cilave personi i caktuar mund të identifikohet drejtpërdrejt ose tërthorazi.

Të dhënat personale që kanë të bëjnë prerazi me prejardhjen racore, bindjen fetare, sjelljen seksuale ose mendimin politik, përkatësisë së lëvizjes, ose organizatës së caktuar të formuar në pajtim me ligjin, si dhe kategoritë tjera të posaçme të të dhënave personale të caktuara me ligj të veçantë, nuk mund të grumbullohen nga ana e policisë.

Me përjashtim, policia mund të grumbullojë të dhënat personale nga Neni 67 Paragrafi 2, në kushte dhe në mënyrë të përcaktuar me këtë ligj dhe me ligj të veçantë, kur kjo ekskluzivisht është e domosdoshme për nevojat e hetimit të caktuar,³⁰ policia grumbullon të dhëna personale dhe të dhënat tjera të nevojshme drejtpërdrejt nga personi me të cilin ato të dhëna kanë të

²⁸Neni 66 i Ligjit për policinë e RM-së, Gazeta Zyrtare e RM-së, 03.11.2006.nr.114.Faqe 26

²⁹Neni 67.Paragrafi 2 i Ligjit për policinë e RM-së, Gazeta Zyrtare e RM-së, 03.11.2006.nr.114.Faqe 26

³⁰Neni 68.Paragrafi 2 i Ligjit për policinë e RM-së, Gazeta Zyrtare e RM-së, 03.11.2006.nr.114 Faqe 27

bëjnë, nga persona të tjera ose nga përmbledhjet ekzistuese të të dhënave, të cilat në pajtim me ligjin i mbajnë organet kompetente shtetërore, institucionet publike, entet dhe personat e tjerë juridik.

Gjatë grumbullimit të të dhënave personale dhe të dhënave tjera të nevojshme të dedikuara për argumentimin e veprave penale ose për kundërvajtje për identifikimin e kryerësve, nëpunësit policorë mund të përdorin mjete teknike për fotografimin dhe inçizim audio-vizuale në mënyrë dhe kushte të përcaktuara me ligj.

Gjatë grumbullimit të të dhënave personale dhe të dhënave tjera të nevojshme ose nga përmbledhjet ekzistuese të të dhënave tjera të nevojshme ose nga përmbledhjet ekzistuese të të dhënave dhe në mënyrën nga neni 68, paragrafi 2, nëpunësi policor për këtë nuk janë të detyruar të informojnë personin të cilit i dedikohen të dhënat, nëse kjo e pengon ose e rëndon kryerjen e punëve policore.

Për të dhënat e grumbulluara nëpunësi policor përgatit raport operativ, që i dërgohet punëtorit udhëheqës të drejtpërdrejt dhe seksionit për kriminalitetin e organizuar.³¹ Policia mbanë evidencë për:

- Personat të cilët në çfarë do baze u është kufizuar liria e lëvizjes (të thirrur, të arrestuar, të mbajtur në arrest)
- Personat për të cilët ekziston baza për dyshimin se janë kryerës të veprave penale ose për kundërvajtje.
- Vepra penale për të cilat ndiqet me detyrë zyrtare ose për kundërvajtje si dhe për persona të dëmtuar me ato vepra.
- Persona dhe sende të cilat kërkohen, si dhe për personat të cilëve u është e ndaluar hyrja në Republikën e Maqedonisë.
- Persona të cilëve u është bërë kontrolli i identitetit.
- Persona të daktiloskopuar, të fotografuar dhe persona për të cilët është bërë analiza e ADN-së
- Aksioni operativ, raporte operative, përpunime operative, njoftime, burime të njohurive dhe personave nën mbrojtje të posaçme policore.
- Ngjarjet ditore në lidhje me kryerjen e punëve policore.
- Përdorimet e mjeteve të detyrimit

³¹Neni 69 Paragrafi 1 i Ligjit për policinë e RM-së, Gazeta Zyrtare e RM-së, 03.11.2006.nr.114.Faqe 27

- Parashtrësia të paraqitura prej qytetarëve kundër nëpunësit policorë dhe masa të ndërmarra
- Vepra të kryera prej kryerësit të panjohur
- Sendet përkohësisht të sekuestruara
- Para të falsifikuara të zbuluara, njësi monetare të falsifikuara, euro dhe valuta të huaja të falsifikuara.

Përveç evidencave nga Paragrafi 1 i këtij neni, policia mund të mbajë edhe evidenca të tjera në kushte dhe në mënyra të përcaktuara me këtë ligj dhe me ligje tjera të posaçëm.³²Evidenca nga neni 69 i këtij ligji, policia i mban ndaras, varësisht prej asaj nëse të njëjtat bazohen në faktet ose njohuritë.³³Të dhënat për numrin e veprave të kryera penale ose të kundërvajtjeve dhe numrin e kryerësve të denoncuar dhe personat e dëmtuar, si dhe të dhënat e tjera numerike, mund të shfrytëzohen për qëllime statistikore dhe analitike në Ministri.

Të dhënat nga paragrafi 1 i këtij neni mund tu jepen në shfrytëzim institucioneve tjera profesionale kompetente dhe shkencore për shkak të qëllimeve statistikore dhe për punë hulumtuese shkencore.

Të dhënat personale mund të dërgohen te shërbimet e huaja policore dhe organizatave ndërkombëtare me kërkesën e tyre, në pajtim me ligjin dhe marrëveshjet Ndërkombëtare të ratifikuara.³⁴Të dhënat personale mund të shfrytëzohen në pajtim me qëllimet e përcaktuara me këtë ligj dhe në pajtim me dispozitat me të cilat rregullohet mbrojtja e të dhënave personale.³⁵Të dhënat personale të futura në evidencë nga neni 69 i këtij ligji, menjëherë shlyhen në rastet kur do të vërtetohet se nuk janë të sakta ose kanë pushuar shkaqet, gjegjësisht kushtet për të cilat e dhëna personale është futur në evidencë.³⁶Të dhënat e përmbajtura në evidencat nga Neni 69 i këtij ligji, prej futjes së tyre deri në shlyerjen e tyre, guxojnë të jepen në kushte dhe në mënyrë të parapara me këtë ligj dhe me ligj të posaçëm.Nevoja për ruajtjen e mëtutjeshme e të dhënave të përmbajtura në evidencat e nenit 69 të këtij ligji, vlerësohet çdo 3 vjet.³⁷

³²Neni 70 i Ligjit për policinë e RM-së,Gazeta Zyrtare e RM-së,03.11.2006.nr.114.Faqe 27

³³Neni 71 i Ligjit për policinë e RM-së,Gazeta Zyrtare e RM-së,03.11.2006.nr.114.Faqe 27

³⁴Neni 72 i Ligjit për policinë e RM-së,Gazeta Zyrtare e RM-së,03.11.2006.nr.114.Faqe 27

³⁵Neni 73 i Ligjit për policinë e RM-së,Gazeta Zyrtare e RM-së,03.11.2006.nr.114.Faqe 27

³⁶Neni 74 i Ligjit për policinë e RM-së,Gazeta Zyrtare e RM-së,03.11.2006.nr.114.Faqe 27

³⁷Neni 75.Paragrafi 1 dhe 2 i Ligjit për policinë e RM-së,Gazeta Zyrtare e RM-së,03.11.2006.nr.114.Faqe 27

Vlerësimi nga paragrafi 1 i këtij neni, përbëhet prej 5 anëtarësh dhe zëvendësve të tyre, prej të cilëve 4 përfaqësues të Ministrisë dhe 1 përfaqësues të Drejtorisë për Mbrojtjen e të dhënave personale. E drejta e subjektit të të dhënave personale për qasje dhe përmirësim të të dhënave personale me të cilat disponon policia, si dhe obligimi për mbrojtjen e të dhënave personale, sigurohen në kushte të dhënat në mënyrë të përcaktuar me ligj të posaçëm.³⁸

Me përjashtim nga paragrafi 1 i këtij neni, e drejta për qasje tek të dhënat personale nuk do të sigurohet nëse kufizimi është i domosdoshëm për shkak të kryerjes së kompetencave ligjore të policisë për preventivë, zbulimin dhe ndjekjen e kryerësve të veprave penale dhe të kundërvajtjeve, realizimin e sistemit të sigurisë publike, ose kur kjo është e nevojshme për mbrojtjen e subjektit të të dhënave personale ose të drejtave dhe lirive të personave të tjerë.³⁹ Drejtoria për mbrojtjen e të dhënave personale bënë mbikëqyrjen e të dhënave personale dhe mbrojtjen e tyre të përcaktuara me këtë ligj dhe ligje tjera.

³⁸Neni 76.Paragrafi 1 i Ligjit për policinë e RM-së,Gazeta Zyrtare e RM-së,03.11.2006.nr.114.Faqe 27

³⁹Neni 77 i Ligjit për policinë e RM-së,Gazeta Zyrtare e RM-së,03.11.2006.nr.114.Faqe 27

KAPITULLI I DYTË

2. NOCIONI DHE LLOJET E PUNËVE POLICORE NË ASPEKTIN LEGJISLATIV NË REPUBLIKËN E MAQEDONISË SË VERIUT

Punë policore sipas Ligjit për policinë janë veprimet e nëpunësve policorë që kanë të bëjnë me:

- Mbrojtjen e jetesës, sigurinë e personale dhe pronën e qytetarëve.
- Mbrojtjen e lirive dhe të drejtave të njeriut dhe të qytetarit të garantuara me Kushtetutën e Republikës së Maqedonisë me ligjet dhe marrëveshjet të ratifikuara ndërkombëtare.
- Parandalimin e kryerjes së veprave penale dhe kundërvajtjeve, zbulimin dhe kapjen e autorëve të tyre dhe marrjen e masave të tjera të parashikuara me ligj për ndjekjen penale të kryerësve të këtyre akteve.
- Mbajtjen e rendit dhe qetësisë publike.
- Rregullimin dhe kontrollin e komunikacionit rrugorë.
- Kontrollin e lëvizjes dhe qëndrimin e të huajve.
- Sigurinë e kufirit shtetëror, kontrollin dhe kalimin e kufirit shtetëror.
- Sigurimin dhe mbrojtjen e qytetarëve në raste të nevojshme.
- Duke siguruar individit dhe objekte të caktuara.
- Si dhe punë të tjera të përcaktuara me Ligj.

2.1 MBROJTJA E JETËS, SIGURISË PERSONALE DHE TË PRONËS SË QYTETARËVE

Në mars të vitit 2014, Qeveria e RMV-së, miratoi një dekret për personat dhe objektet që do të sigurohen llojet e masave, aktivitete dhe nivelet e sigurisë. Sigurimi i personaliteteve dhe objekteve nënkupton planifikimin, organizimin, koordinimin dhe marrjen e masave dhe

aktiviteteve operative-parandaluese, teknike, fizike, shëndetësore, masa dhe aktivitete tjera në lidhje me sigurimin.⁴⁰

Përfaqësuesit më të lartë të autoriteteve shtetërore të RMV-së edhe kur janë në RMV-së por edhe kur janë jashtë sajë në vizita zyrtare dhe në punë në vend të huaj në bashkëpunim me shërbimet e huaja të ngarkuara me detyrën për sigurim.

Shtetas të huaj si: (Kryetarë shtetesh, Qeveritarë, Parlamentarë, Sundimtarë, Sovran dhe Bartës të funksioneve zyrtare shtetërore) që janë për vizitë zyrtare dhe punë në RMV si dhe delegacione të huaja me gradë më të ulët në vizitat e punës me rëndësi të veçantë dhe interes për RMV-në, dhe përfaqësuesit më të lartë të Organizatave Ndërkombëtare që janë në vizitë dhe punë në RMV.

Vendet e autoriteteve shtetërore dhe hapësirat rreth tyre, si dhe ndërtesat rezidenciale, përfaqësues dhe zonat përreth që u përkasin autoriteteve shtetërore të RM-së, përfaqësuesit diplomatik dhe konsullorë dhe rezidencat e RM-së jashtë vendit në bashkëpunim me autoritetet e huaja të sigurisë në bazë të reciprocitetit ose marrëveshjes.

Misionet diplomatike dhe konsullore të huaja në RMV dhe rezidencat e tyre të bazuara në reciprocitetet ose marrëveshjet e përfunduara dhe misionet Ndërkombëtare me seli në RMV-së në bazë të një marrëveshje Ndërkombëtare të ratifikuar nga RMV-së

Objektet dhe hapësirat që janë me rëndësi të veçantë dhe interes për sigurinë dhe mbrojtjen e RM-së. Janë marrë masat dhe aktivitetet të jashtëzakonshme dhe të veçanta të sigurisë për sigurimin e personave dhe objekteve me rëndësi. Pas vlerësimit të kërcënimit në varësi të situatës aktuale politike të sigurisë, prishja e rendit dhe qetësisë publike në shkallë më të gjerë ushtarake ose emergjente, gjatë fatkeqësive natyrore, epidemive ata ndërmarrin masa dhe aktivitete shtesë për të siguruar sipas ligjit.

2.2 MBROJTJA E LIRIVE DHE TË DREJTAT E NJERIUT DHE TË QYTETARIT TË GARANTUARA ME KUSHTETUTËN E RMV, ME LIGJ DHE ME MARRËVESHJE NDËRKOMBËTARE

Deklarata e përgjithshme mbi të Drejtat e Njeriut.

⁴⁰Neni 127 i Ligjit për policinë e RM-së, Gazeta Zyrtare e RM-së

Me 10 Dhjetorë të vitit 1948 Asambleja e Përgjithshme e Kombeve të Bashkuara(KB) nxorri dhe shpalli Deklaratën e Përgjithshme mbi të Drejtat e Njeriut (DNJ). Pas këtij akti historik Asambleja ftoi të gjithë shtetet anëtare që ta shpallin tekstin e Deklaratës dhe të përpiqen që të përhapet, lexohet dhe të shpjegohet sidomos në shkolla dhe institucionet tjera edukuese, në të gjithë vendet dhe shtetet pa marrë parasysh statusin e tyre politik.

Teksti zyrtarë i Deklaratës mund të gjendet në 6 gjuhë zyrtare: Angleze, Franceze, Kineze, Ruse, Spanjolle dhe Arabe.

Njohja e dinjitetit të lindur të të drejtave të barabarta dhe të patjetërsueshme të të gjithë anëtarëve të familjes njerëzore është themelimi i lirisë, drejtësisë dhe paqes në Botë. Mosrespektimi dhe përbuzja e të DNJ ka sjellë drejt akteve barbare të cilat kanë ofenduar ndërgjegjen e njerëzimit, krijimi i botës në të cilën njerëzit do të gëzojnë lirinë e fjalës të besimit dhe lirinë nga frika e skamjes është proklamuar si dëshira më e lartë e çdo njeriu.

Është e nevojshme që të DNJ të mbrohen me dispozita juridike, kështu që njeriu të mos jetë i shtrënguar që në pikën e fundit ti përvishet kryengritjes kundër tiranisë dhe shtypjes.

Është e nevojshme që të nxitet zhvillimi i marrëdhënieve miqësore midis kombeve, popujt e KB-së vërtetuan përsëri në Kartë besimin e tyre në të DNJnë dinjitetin dhe vlerën e Njeriut dhe barazinë në mes të burrave dhe grave dhe nxitjen e përparimit shoqërorë dhe përmirësimin e nivelit të jetesës në Liri të plotë.

Shtetet anëtare u detyruan që në bashkëpunim me KB të sigurojnë respektin e përgjithshëm dhe zbatimin e të DNJ dhe të lirive themelore.

Kuptimi i përbashkët i këtyre të drejtave dhe lirive është më i rëndësishëm për realizimin e plotë të këtij detyrimi.

Asambleja e përgjithshme mbi të DNJ shpallë këtë Deklaratë të Përgjithshme mbi të DNJ si ideal të përgjithshëm të cilin duhet ta arrin të gjithë popujt dhe të gjithë kombet në mënyrë që çdo Njeri dhe çdo organizëm shoqërorë duke pasur parasysh gjithmonë këtë Deklaratë të përpiqet që me anë të mësimin dhe edukimit të ndihmonte në respektimin e këtyre të drejtave dhe lirive dhe me anë të masave progresive Kombëtare dhe Ndërkombëtare të sigurojë njohja dhe zbatimin e tyre të përgjithshëm dhe të vërtetë si në mesë popujve të vetë shteteve anëtare gjithashtu edhe në mes popujve të tyre, territoreve që janë nën administratën e tyre.⁴¹

⁴¹Tekstin e plotë mund ta gjeni në faqen e internetit të Komisionit të lartë për të drejtat e Njeriut të Zyrës së K.B-së Për të Drejtat e Njeriut www.ohchr.org

Pas Luftës së Dytë Botërore të gjithë vendet anëtare të KB ranë dakord për Deklaratën për të Drejtat dhe Liritë e Njeriut. Ata raportuan se të drejtat e njeriut duhet të jenë:

- Universale
- Të barabartë
- Të detyrueshme

RMV i ka pranuar të gjitha parimet për të DNJ në kuadër të Kushtetutës së saj dhe legjislacionit të brendshëm. Prandaj, është me rëndësi, të shqyrtohen, aspektet praktike të të drejtave të njeriut dhe punës së policisë në RMV.

Puna e policisë në demokracinë moderne është që t'i mbrojë të drejtat themelore të qytetarëve, ti mbrojë të DNJ dhe të mbajë rendin dhe qetësinë publike dhe sigurinë personale dhe publike.

Kjo duhet të bëhet përmes rregullave dhe praktikave që janë ligjërish humane dhe të disiplinuar. Që do të thotë, është e domosdoshme që policia të zbatojë dhe tu bindet ligjeve sidomos atyre që i mbrojnë dhe i ruajnë të drejtat e njeriut. *Instrumentet Ndërkombëtare që policia e RMV duhet tju përmbahet,*⁴² janë si vijon:

- Instrumentet Globale
- Instrumentet Rajonale
- Dokumentet jo detyruese.

Instrumentet Ndërkombëtare të të Drejtave të Njeriut:

Në Kushtetutën e RMV-së, neni 8, ku përcaktohen vlerat themelore të rendit kushtetues, thuhet: "Një nga vlerat themelore të rendit Kushtetues të RM-së janë edhe të *drejtat dhe liritë themelore të personit dhe qytetarëve, siç janë të pranuar nga ligjet ndërkombëtare dhe të përcaktuara me Kushtetutë*". Kjo vlerë, poashtu theksohet edhe në disa ligje të tjera që ndërlidhen me veprimtarinë e policisë.

Përveç ligjeve të brendshme, vëmendje duhet ti kushtohet gjithashtu edhe instrumenteve ndërkombëtare për të drejtat e njeriut gjatë ushtrimit të punëve dhe autorizimeve policore. Këto standarde pranohen në mënyrë universale në punët e policisë, ku përfshihen edhe: Kodi i sjelljes së OKB-së për anëtarët e autoriteteve qeveritare, personat e autorizuar për zbatimin e ligjit (rezoluta e OKB-së 34/169-1979), Parimi themelor i OKB-së mbi përdorimin e forcës dhe

⁴²OSCE Spillover Mission Skopje 1.5 Të Drejtat e Njeriut 25.03.2004

armëve të zjarrit nga ana e personave zyrtarë për zbatimin e ligjit dhe organi për mbrojtjen e të gjithë personave për çfarëdo lloj burgimi ose paraburgimi të paligjshëm.⁴³

Këtu në këtë pkesë, vlen të përqendrohemi në lidhje me parandalimin e kriminalitetit, ku siç dihet tani më, në të gjithë botën ka kriminalitet dhe poashtu një pjesë e madhe e njerëzve mundohen që ta luftojnë atë. Që të luftohet krimi, duhet që të krijohet një sistem i organizuar me masa parandaluese dhe me aktivitete të shumta, qëllimi është që sa më aktiv të jenë organet kompetente, aq më pak do të jetë niveli i krimit ku dhe kuptohet që asnjëherë nuk do të mund ta zhduket në tërësi nocioni ose aktiviteti kriminal në përgjithësi, sepse siç thuhet zakonisht, kriminaliteti është gjithnjë një hap përpara organeve kompetente.

2.3 PENGIMI I KRYERJES SË VEPRËS PENALE DHE KUNDËRVAJTJEVE TË TYRE DHE NDËRMARJA E MASAVE TJERA TË PËRCAKTUARA ME LIGJ PËR NDJEKJEN E KRYERËSVE TË TYRE

Policia merr masat e nevojshme si në një plan parandalues dhe në një planë represiv, nga synimi i eliminimit të të gjitha dukurive të rrezikshme shoqërore që lindin si rezultat i përgatitjes ose kryerjes së veprave penale ose aktiviteteve të tjera përgjithësisht të rrezikshme.

Parandalimi në luftën kundër kriminalitetit duhet të jetë një parandalim social i kuptuar gjerësisht, që përfshinë ndërmarrjen e veprimeve të ndryshme sociale dhe aktiviteteve të autoriteteve kompetente për të eliminuar shkaqet objektive dhe subjektet të kriminalitetit. Në këtë kuptim ndërmerren masat ekonomike, sociale, edukative, kulturore, shëndetësore dhe masa të tjera që ndikojnë në faktorët e paraqitjes së kriminalitetit në fenomene të tjera shoqërore negative. Në këtë gamë të gjerë masash dhe autorizimesh që ndërmerren masa dhe aktivitete në parandalimin e kriminalitetit, policia ka një rol të rëndësishëm.

Çfarë është një parandalim kriminalistik:

Parandalimi kriminalistik përfshinë një sistem të masave dhe veprimeve të shpejta, energjike të menjëhershme dhe të përcaktuara saktësisht për të parandaluar ndodhjen dhe zhvillimin e dukurive shoqërore negative si dhe llojet e tjera të kërcënimeve ndaj rrezikimit të rendit publik dhe rendin e shtetit.

Parandalimi i përgjithshëm preventiv:

⁴³ Rezoluta e OKB-së 34/169-1979. Parimi themelor i OKB-së mbi përdorimin e forcës dhe armëve të zjarrit

Personi zyrtar i autorizuar, me qëllim të parandalimit të kryerjes së veprave penale dhe sjelljeve të tjera shoqërore të dëmshme ndërmerren masat e planifikuara të organizuara për të kuptuar arsyet që sjellin sjellje kriminale.⁴⁴

Që të drejtojnë në mënyrë adekuate veprimtarinë parandaluese, perceptimi i formave fenomenologjike dhe manifestuese të sjelljes kriminale kryhet përmes monitorimit dhe analizës së tyre të vazhdueshme.⁴⁵

Aktiviteti i përgjithshëm parandalues realizohet nëpërmjet:

Dokumentacionet, materialet cilësore në lidhje me sjelljet e tjera shoqërore të dëmshme.

Përfshirjen ose inçizimin për qëllime të ndërmarrjes së aktiviteteve të përbashkëta parandaluese me institucionet apo subjektet të tjera që janë përgjegjëse për realizimin e qëllimeve edukative, sociale, humanitare, kujdestarie dhe të tjera të ngjashme. Paraqitja e duhur publike të përvojave praktike në lidhje me organizimin parandalues dhe aktivitetet e implementuara me sukses.

Parandalimi i menjëhershëm:

Përveç ndërmarrjes së masave dhe aktiviteteve për arritjen e parandalimit të përgjithshëm, zyrtarët e autorizuar gjithashtu ndërmarrin masa për angazhim të menjëhershëm parandalues. Parandalimi i menjëhershëm është një grup masash dhe aktiviteteve që kanë të bëjnë me fazën para kryerjes së veprimit, si dhe fazat e tjera ekzekutive.

Ky angazhim parandalues është ndërmarrë në mënyrë të pavarur dhe është drejtuar drejtë.

Mbledhja e të dhënave dhe informacioneve mbi situatat, ngjarjet dhe sjellje të caktuara që mundësojnë ose kontribuojnë në kryerjen e krimeve të caktuara.

Përforcimi dhe vazhdimësia fizike e pikave, vendeve, burgjeve dhe mjediseve të caktuara ku shpesh herë kryen krimet të caktuara ose ekzekutimi i tyre mund të pritët. Detyrat janë kryer përmes shërbimit ofanziv dhe duke përcaktuar patrullat e lëvizshme parandaluese nga policia dhe policia kriminale të përgatitur për nevoja të caktuara.

Realizimin e një depërtimi në lëvizjen e autorëve, nëpërmjet shërbimit të përforcuar, patrullës dhe policisë kriminalistike me qëllim të ndërmarrjes dhe njohjes së përpjekjeve për të rikryer krimin.

⁴⁴Neni 150 i Rregullores për kryerjen e punëve të Ministrisë për Punë të Brendshme

⁴⁵Neni 152 i Rregullores për kryerjen e punëve të Ministrisë për Punë të Brendshme

Vëzhgimi i pikave, vendeve, lokaleve dhe ndërtesave publike ku kryhen delikuentet me elemente të dhunshme ose shkelja e rendit dhe qetësisë publike, pritet kryerja e veprave tjera penale dhe kundërvajtje për të penguar dhe i identifikuar autorët. Detyrat janë kryer me masat dhe aktivitetet të ndërmarra nga policia dhe policia kriminale, nëse është e nevojshme edhe duke përdorur mjete të përshtatshme teknike si (aparartet fotokopjike, kamerat, etj).

Mbylljen e qasjeve në një hapësirë apo objekte të caktuara dhe kontrollin e kufizimit dhe lëvizje, inspektimin e mjeteve të transportit, personave dhe bagazheve.

Ndërmarrjen e aktiviteteve të organizuara që do ta nxisin ngritjen e kulturës së sigurisë të qytetarëve dhe marrjen e masave të duhura për mbrojtjen e tyre teknike dhe të lejueshme. Për këtë qëllim organizohen dhe zhvillohen leksione të përshtatshme me qëllim rritjen e kulturës së trafikut, duke informuar qytetarët se janë viktimë të mundshme sidomos në rastet e pasurive të patundshme, duke këshilluar përdorimin e pajisjeve mbrojtëse, si dhe njohja me masat për mbrojtjen nga sulmet ndaj integritetit fizik të qytetarëve.

Duke inicuar nëpërmjet institucioneve dhe autoriteteve përkatëse të specializuara për të ndërmarrë masa për tejkalimin e faktorëve dhe kushteve kryesore që lejojnë kryerjen e veprave penale ose reduktimin e tyre.⁴⁶

Sipas objektit të mbrojtjes ekzistojnë lloje të veçanta të parandalimit që policia bënë për parandalimin e kryerjes së krimeve të caktuara.

Parandalimin e delikteve të njollosura me gjak dhe akteve të sjelljeve të dhunshme:

Me veprimtarinë parandaluese të krimeve të gjakut dhe akteve të sjelljes së dhunshme ndërmerren masa dhe aktivitete për të mbrojtur integritetin fizik, jetën e qytetarëve dhe sigurinë e tyre personale dhe njëkohësisht të identifikojnë rreziqet që mundë ti rrezikojnë.⁴⁷

Aktivitetet parandaluese në këto krime mbulojnë:

- Studimi i drejtpërdrejtë i etimologjisë së sjelljes së dhunshme domethënë, cilat arsye të çojnë në shfaqjen e këtyre krimeve.
- Inçizimi dhe mobilizimi i të gjithë subjekteve dhe institucioneve shoqërore me qëllim të zgjedhjes së të gjitha çështjeve që lidhen me mbrojtjen e jetës dhe integritetit truporë.

⁴⁶Neni 153 i Rregullores për kryerjen e punëve të Ministrisë për Punë të Brendshme

⁴⁷Neni 154 i Rregullores për kryerjen e punëve të Ministrisë për Punë të Brendshme

- Angazhimi i drejtpërdrejtë parandalues i zyrtarëve të autorizuar duke marrë masat e duhura për të çaktivizuar fizikisht sulmin ndaj jetës së qytetarëve dhe për të fituar njohuri për rrethanat e shpejta që prekin ata.
- Informimi i qytetarëve për zonat, vendet dhe lokalet ku veprimet e caktuara kriminale kryhen me sjellje të dhunshme. Në këtë mënyrë do të inicohen veprimet parandaluese të qytetarëve.

Inicimi i shërbimeve dhe institucioneve të tjera kompetente për ndërmarrjen e masave të duhura për zgjedhjen e disa problemeve shoqërore dhe patologjike që çojnë në sjelljen e dhunshme (Neni 154 I Rregullores për kryerjen e punëve të Ministrisë për Punë të Brendshme). ***Parandalimi i krimit të pronës:***

Masat parandaluese të krimeve të policisë përfshirë këshilla të dërguara përmes mjeteve të komunikimit publik, përmes bisedave të organizuara dhe kështu me radhë. Në mënyrë që ti informojmë qytetarët për lëshimet që bëjmë kur ndërmarrin ***masa për mbrojtjen e pronës***. Gjithashtu policia kontrollon sigurimin e jashtëm të objekteve me qëllim që të shmangin aq sa munden vjedhësit e tyre. Policia sëbashku me policinë kriminale mundë të formojnë grup të policisë civile të cilët në mënyrë që me automjetet ose në këmbë të kryejnë patrullim me qëllim që mos të vidhet ose nëse kanë informacion se do të vidhet në atë objekt, atëherë policia merë masat dhe sigurinë që mos të ndodhin këto vepra penale.⁴⁸

Parandalimi i kriminalitetit Ekonomik: Aktivitetet parandaluese të policisë për të parandaluar krimin ekonomik janë:

- Hulumtimi mbi format e reja dhe përcaktimin e masave parandaluese që duhen zbatuar.
- Analizat dhe rezultateve të masave të ndërmarra dhe inicimin e autoriteteve të tjera kompetente për marrjen e masave të menjëhershme parandaluese.
- Inicimi i ndryshimit dhe inicimit të akteve normative që rregullojnë këtë çështje.⁴⁹

Parandalimi i Delikuencës së të Miturve: Para se të merren aktivitetet parandaluese në parandalimin e delikuencës së të miturve është e nevojshme të përgatitet një plan me vlerësimin e formave dhe shtrirjes së prirjes për sjelljen e delikuede dhe karakteristikat personale të të miturit ose grupit të të miturve.

⁴⁸Neni 155 i Rregullores për kryerjen e punëve të Ministrisë për Punë të Brendshme

⁴⁹Neni 156 i Rregullores për kryerjen e punëve të Ministrisë për Punë të Brendshme

Aktivitetet parandaluese në këtë lloj kriminaliteti janë:

- Raportimi dhe inicimi i organeve të kujdestarisë me qëllim të marrjes së masave brenda juridiksionit të tyre, por edhe në bashkëpunim me policinë.
- Duke formuar një grup përfaqësuesish të organeve të kujdestarisë dhe ekspertëve nga policia, me qëllim të shkëmbimit të të dhënave dhe informacioneve mbi masat dhe aktivitetet në parandalimin e delikuencës së të miturve.
- Përcaktimin e udhëheqësve të grupeve kriminale të të miturve, ndarjen e tyre nga grupi dhe edukimin e tyre.(Neni 156 I Rregullores për kryerjen e punëve të Ministrisë për Punë të Brendshme).

Parandalimi i Kriminalitetit të Organizuar: Aktiviteti i parandalimit për pengimin e kriminalitetit të organizuar përmban:

- Ndërgjegjësimin e formave të krimit të organizuar dhe mjediseve ku përfaqësohen.
- Përcaktimin e treguesve që identifikojnë veprat penale dhe autorët.
- Mbledhjen e të dhënave dhe informacionit për këtë lloj kriminaliteti dhe përpunimin e tyre.
- Hulumtimi mbi format e reja, transportuesit dhe bazat për shoqërimin e tyre.
- Përcaktimin e llojeve të veprimtarive në të cilat krimi i organizuar manifestohet më shpesh.
- Ndërgjegjësimin operativ për përgatitjen e krimit, mënyrën e ekzekutimit dhe kështu me radhë.
- Realizimi i komunikimit të rregullt me autoritetet për parandalimin e këtij lloji të kriminalitetit.⁵⁰

Në parandalimin e kriminalitetit, policia ka një rol të rëndësishëm. Përveç represionit, rol i rëndësishëm i luajtur nga policia në parandalimin e veprimtarisë kriminale është veçanërisht i rëndësishëm secili zyrtarë i policisë, duhet të dijë se çfarë masash po ndërmerren në parandalimin e menjëhershëm. Gjithashtu çdo polic duhet të dijë se cilat aktivitete parandaluese ai ndërmerr për krimet të caktuara, sipas objektivitetit të mbrojtjes.

⁵⁰Neni 159 i Rregullores për kryerjen e punëve të Ministrisë për Punë të Brendshme

2.4 MBAJTJA E RENDIT DHE QETËSISË PUBLIKE

Duke filluar nga integriteti dhe garancia e Kushtetutës për Liritë dhe të Drejtat e njeriut, mbajtja e rendit dhe qetësisë publike (MRQP) në fakt përfaqëson mbrojtjen e sigurisë personale dhe sigurinë e qytetarëve duke bërë të mundur normalitetin e vazhdueshëm të gjërave të përditshme, të gjithë qytetarët në përgjithësi duhet që të ndjehen të qetë dhe me gjakftohtësi në shtëpitë e tyre, vendet e punës, në mjedisin që i rrethon.

Qetësia dhe rendi publik dhe mirëmbajtja e saj është një kusht për ndjenjën e sigurtë të qytetarëve, në mënyrë që të jenë në gjendje të ushtrojnë të drejtat e tyre në të gjithë segmentet e jetës shoqërore.

Vetëm me mirëmbajtjen e mirë të rendit dhe qetësisë publike qytetarët do të mundë që ti shfrytëzojnë vlerat dhe Liritë e paqes të cilat janë të garantuara me Kushtetutën për Liritë dhe të Drejtat e Njeriut (LDNJ).

Ne mund të kuptojmë se nën nocionin e mbrojtjes së rendit dhe qetësisë publike është e kuptueshme gjendja ku të gjithë njerëzit në një shoqëri duhet të ndihen të qetë dhe të sigurtë në kryerjen e detyrave të tyre të përditshme, në shtëpi dhe në mjediset që ata i rrethon.

Punët e mbrojtjes së rendit dhe qetësisë publike:

Veprimet preventive për parandalimin e prishjes së rendit dhe qetësisë publike, veçanërisht në vendet ku shpesh herë vinë deri te prishja e rendit dhe sigurisë ku dhe e pengon lëvizjen e lirë të qytetarëve në sjelljen normale të jetës publike.

Marrja e masave për mbrojtjen e jetës dhe sigurisë së qytetarëve, parandalimin e sjelljeve të dhunshme, dhe kërcënimin personal të njerëzve si dhe parandalimin e kryerjes së veprës penale me elemente të dhunshme. Kryerja e kontrolleve dhe mbikëqyrjen e kryerësve të veprave penale më të rënda kundër RQP-së, zbulimin dhe kontrollin e vendeve, objekteve ku më së shumti vinë deri te prishja e RQP-së.

Bashkëpunimi me organizatorët e tubimit publik si dhe shpjegimi i asistencës së sigurimit profesional për marrjen e masave kundërprishjes së RQP-së në tubime publike.⁵¹

⁵¹Neni 46,47 i Ligjit për Shkeljen e Rendit dhe Qetësisë Publike

Sigurimi i njohurive dhe kontrolli mbi tubimet spontane, ngjarjet me rastin e festave fetare, ose ngjarjet ku në pjesëmarrje bëjnë shtetas të huaj, si dhe marrjen e masave të duhura për mbajtjen e tubimeve që të mos shfrytëzohet interesikundër RM-së ose sigurisë së saj.

Mbajtja e RQP-së është detyrë kryesore e të gjithë policëve të uniformuar.

Në pajtim me ligjet e autorizuar për mbrojtjen e RQP-së, MPB-ja vepron në mënyrë parandaluese, ndërsa në raste kur RQP-ja është prishur, detyra e policisë në pajtim me ligjin mundë të përdorë masa represive, në raste të veçanta mundë të përdorë dhe forcë kundër autorëve të prishjes së RQP-së.⁵²

Detyra e policisë është që ta kthejnë në normalitetin e mëparshëm situatën e RQP-së.

Mbrojtja e Rendit dhe Qetësisë Publike në thelb ka dy qëllime:

- Krijimin e gjendjes së sigurisë të përgjithshme e cila reflekton në stabilitetin e RQP-së dhe respektimin e lirive dhe të drejtave të qytetarëve.
- Angazhimin për sigurimin e formave dhe vlerave morale të cilat përfaqësojnë trashëgimi kulturore ose të krijuar si pasojë e marrëdhënieve shoqërore.

Në detyrat e përditshme personi zyrtarë përmes njohjes personale, në kontakt shoqërorë apo lidhje të tjera informimi nga qytetarët etj., prej marrjes së informimit për tubim të qytetarëve MPB-ja menjëherë organizohet dhe marrin masa për mbikëqyrjen e situatës, vlerësimin e sigurimit të situatës, informimi i shërbimit përmes linjës.

Për të marrë masat e duhur për mbrojtjen e RQP-së duhet:

- Forcimi i aktivitetit operativ dhe preventiv.
- Udhëheqësi përgjegjës i policisë menjëherë i informon ekipet operative me situatën e ndodhur dhe hynë në analizimin e planit operativ.

2.5 RREGULLIMI DHE KONTROLLI KOMUNIKACIONIT RRUGOR

Çdo polic i komunikacionit duhet të dijë të rregullojë komunikacionin me shenjat që i jep nga pjesët dhe pozicionet e trupit dhe të jenë në gjendje që ti zbatojnë ato.

⁵² Neni 34 i Ligjit për Punë të Brendshme të RM-së

Kjo detyrë është thelbësore për policinë e komunikacionit, pasi çdo ditë do të ketë një situatë në të cilën do të kërkohet nga ai që ta rregullojë atë. Problemi i rregullimit të komunikacionit është shumë i madh. Përfshinë pastrimin e bllokimit të komunikacionit, drejtimin e tij për shkak të distancës së sajë nga skena e aksidentit të komunikacionit ose incidenteve të tjera në rrugën e izolimit dhe sigurimin e një zone të caktuar, ose rregullimin e trafikut për shkak të mosfunksionimit të sinjaleve të lehta.

Rregullimi i komunikacionit: Në rrugë konsiston në zbatimin e shenjave të përcaktuara ose urdhrave nga punonjësit e policisë të destinuar për pjesëmarrësit në komunikacion.

Rregulli i komunikacionit:

- Gjithmonë të jenë të zgjuar dhe të kujdesshëm
- Të kryejnë detyrat për të rregulluar komunikacionin, vetëm në uniformë që është e dukshme, përveç në situata urgjente.
- Menaxhimi i shenjave ligjore me dorë edhe me shenjat e policisë (si bilbili fishkëllyes, mbathja e krahëve me fosfor, si dhe shenja e policisë stop, përdorim të fenerit ndriçues)
- Lëvizni krahët dhe duart vetëm kur keni nevojë për një zhbllokim të komunikacionit
- Të jeni objektiv, të qëndroni të drejtë dhe të ruani dukshmërinë maksimale.
- Qëndroni në qendër të kryqëzimit, në rrugë para syve të vozitësve.
- Të jetë e rregullshme dhe të ndalojë komunikacionin me ndërprerje normale, për trafik të qetë
- Përdor shenja zanore, sirena për vozitësit që të kushtojnë vëmendje dhe që ti kuptojnë shenjat e urdhëruara me dorë nga ana e policit
- Lëshojeni vendin (kryqëzimin) vetëm atëherë kur problemi është zgjedhur ose kur jeni zëvendësuar nga një koleg tjetër (polic) ose kur merrni urdhër nga ana e personave zyrtarë të atij organi.⁵³

Me shfrytëzimin e bilbilit nga ana e policisë u jepet njohuri vozitësve të automjeteve që ti ndjekin shenjat e urdhëruara me dorë nga ana e policit që të mos bllokohet komunikacioni. Shenjat e paqëndrueshme jo universale ose kontradiktore me duart e shpërfillin vëmendjen dhe shkaktojnë tollovi që mund të jetë arsyeja për ndodhjen e aksidenteve në komunikacion, prandaj polici ka përgjegjësi se si vepron që mos të ndodhë ndonjë aksident nga mënyra e

⁵³Neni 174,175,176,177 i Ligjit për rregullimin e komunikacionit rrugorë

urdhëruar e shenjave me dorë, por gjithashtu bartin përgjegjësi edhe vozitësit sepse duhet që ti njohin shenjat standarde që jepen me dorë dhe me anë të trupit nga rregullat dhe procedurat e policisë.

Punonjësit e policisë nuk duhet tu lejojnë atyre që të shqetësohen deri në atë shkallë aq të madhe sa të humbasin përqendrimin dhe përdorimin e ndonjë shenje tjetër që nuk përputhet me shenjat e njohura standarde.⁵⁴

Këtu mund të përmendim disa nga shenjat e duarve dhe lëvizjes së trupit nga ana e punonjësve të policisë për rregullimin dhe kontrollin e komunikacionit rrugorë.⁵⁵

- Krahun e ngritur vertikalisht me pëllëmbë të hapur që do të thotë: Ndalimi i të gjithë komunikacionit nga të gjitha drejtimet.
- I kthyer nga automjetet që duhet të ndalojnë, në lartësinë e shpatullës me pëllëmbë vertikale prej sipërfaqes së tokës drejt makinës së parë duke i treguar që të ndalojë dhe të tërheqë vëmendjen e vozitësit, menjëherë pas asaj duhet që të rrotullohet dhe tu jep përparësi pjesës tjetër të komunikacionit që duhet të lëviz d.m.th. kjo është ndalimi i komunikacionit nga njëri drejtim.
- Mbajtja e komunikacionit të ndaluar, nga përpara dhe mbrapa trupit në të njëjtën kohë. Trupi në një pozicion normal në këmbë me dy krahët e hapur dhe të ngritur në nivelin e shpatullave dhe të shtrirë horizontalisht, në këtë pozitë përparësi për qarkullim kanë automjetet nga ana e majtë dhe e djathtë e policit.

Qarkullimi i lejuar i komunikacionit është kur polici me lëvizjen e dorës drejt pjesës së parme dhe të shtrirë horizontalisht duke e lëvizur në mënyrë rrethore. Qëllimi kryesorë i rregullimit fizik të komunikacionit rrugorë është duke monitoruar komunikacionin dhe me masat dhe aktivitetet e zyrtarëve të autorizuar për të zbuluar, penguar dhe hequr çdo pengesë dhe kushte të tjera të pafavorshme për rrjedhjen e pandërprerë dhe të sigurt të komunikacionit.

Gjatë rregullimit fizikë të komunikacionit punonjësi i policisë nuk guxon:

- Që të rijë jashtë rregullimit të përcaktuar të komunikacionit, në mënyrë që mos të krijohet tollovi në komunikacion
- Që të jep shenja jostandarde për pjesëmarrësit në komunikacion

⁵⁴Neni 139,140 i Ligjit për rregullimin e komunikacionit

⁵⁵ Neni 131,132,133,134,135,136,137,138 i Ligjit për rregullimin dhe kontrollin e komunikacionit rrugorë

- Që të ndalojnë automjetet në udhëkryq, ku pengohet qarkullimi i lirë i komunikacionit.
- Që ti kthejë automjetet të cilat gabimisht vetëm kanë hyrë në udhëkryq edhe pse me atë veprim pengohet qarkullimi i lirshëm i komunikacionit.
- Që të japin informacione të zgjeruara që nuk lejohen ose të inkuadrohen në biseda të panevojshme me pjesëmarrësit në komunikacion.
- Që të kërcënohen pjesëmarrësve në komunikacion të cilat i kanë shkelur rregullat ose të fyen dhe të ofendojnë dinjitetin e tyre.

2.6 KONTROLLI I QARKULLIMIT DHE I QËNDRIMIT TË TË HUAJVE

Shtetet moderne e rregullojnë regjimin e lëvizjes dhe qëndrimit të të huajve me rregullore (të brendshme) kombëtare, ato janë të detyruar ti respektojnë detyrimet e ndërmarra të përcaktuara me marrëveshjet ndërkombëtare.

Një akt juridik qendror në RMV që rregullon këtë çështje është Ligji mbi lëvizjen dhe qëndrimin e të huajve, i cili plotësohet me disa akte tjera nënligjore (rregullore, udhëzime) me të cilat ky ligj funksionon.⁵⁶

Ligji mbi lëvizjen dhe qëndrimin e të huajve përbëhet prej 10 pikave kryesore si:

- Dispozitat e përgjithshme
- Të drejtën e hyrjes në RM-së dhe dhënien e vizës
- Vendbanimi i të huajve
- Pasaporta dhe dokumentet të tjera për të huajt
- Shpërndarja dhe bartja e armëve, lëvizjen e të huajve në uniformë dhe emër personal
- Regjistrimi dhe çregjistrimin e vendbanimit
- Duke dëshmuar identitetin e të huajt
- Evidentimin
- Dispozitat penale
- Dispozitat e përkohshme dhe të kryera

⁵⁶Neni 46 i Ligjit për qarkullim dhe qëndrim të të huajve në RM-së(Gazeta Zyrtare e RM-së.Nr-35.25.03.2006.Faqe 31)

Rëndësia e këtij ligji po rritet veçanërisht në vitet e fundit të pavarësisë së RMV-së nga Ish Republika Federative Jugosllave të cilët mbeten për të jetuar ose qëndruar në RMV, fitojnë statusin e të huajve me status diplomatik ose konsullor. Brenda kornizave të MPB-së për shkak të mbulimit të lëvizjes dhe qëndrimit të të huajve ka një sektorë për të huaj dhe çështjet e emigracionit në të cilën ndodhen dy reparte si:

- Reparti për azil dhe emigracion
- Reparti për çështjen e kufirit, të huajt dhe udhëtimet jashtë vendit.

Në përbërje të këtyre sektorëve funksionon edhe Qendra për Transit për të huaj.

Në ligjin mbi lëvizjen dhe qëndrimin e të huajve⁵⁷ sipas së cilës i huaj është çdo person që nuk është shtetas i RMV-së ashtu siç mund të vërtetohet termi “I Huaj”. Që të trajtohet një person si i huaj nuk ka rëndësi nëse personi ka një ose më shumë nënshtetësi të shteteve tjera (BIPATRID) ose personi i takon kategorisë (APATRID) person pa nënshtetësi, refugjat, azil ose diçka të ngjashme. Me rëndësi është që personi nuk ka nënshtetësi të RM-së.

Në kohën e qëndrimit në RMV-së të huajt i gëzojnë të gjitha të drejtat që i njeh Kushtetuta e RMV-së dhe Ligji i vendbanimit, Deklarata Universale për të Drejtat e Njeriut, Konventa Ndërkombëtare për të Drejtat Civile dhe Politike dhe dokumentet të tjera politiko-ligjore. Është me rëndësi të veçantë të theksohet se të huajt në ushtrimin e të drejtave të tyre janë të bazuara plotësisht me shtetasit e RM-së në fushën e kallëzimeve penale dhe kundërvajtjeve.

Detyrimi kryesorë i të huajve gjatë qëndrimit të tyre në RM-së është që ta respektojnë Kushtetutën e RM-së, Ligjet, rregulloret dhe vendimet tjera të organeve shtetërore. I huaj mund të hyjë në RM-së në vendkalimet kufitare dhe të qëndrojë në territorin e RM-së nëse ka një dokument për të huaj të udhëtimit të vlefshëm ose një dokument tjetër i përcaktuar me një marrëveshje Ndërkombëtare ose dokument udhëtimi i lëshuar nga MPB-ja, ose Përfaqësimi Diplomatik Konsullorë (P.D.K). Dokumenti për udhëtim duhet të ketë vizë, përveç nëse përcaktohet ndryshe me marrëveshje Ndërkombëtare ose me dispozitat e Ligjit.⁵⁸

Qeveria e RM-së mundë të vendosë për shtetasit e shteteve të caktuara për të hyrë në RMV-së vetëm me letërnjoftim ose me dokumente tjera udhëtimi të cilat tregojnë identitetin e personit dhe të jenë të vlefshme.

⁵⁷Neni 2.Paragrafi 1 i Ligjit mbi lëvizjen dhe qëndrimin e të huajve

⁵⁸Neni 30 i Ligjit mbi lëvizjen dhe qëndrimin e të huajve.Përkufizimi i llojeve të vizave.(Gazeta Zyrtare e RM-së.nr35.Faqe 28)

Të huajt mund që ti ndalohet hyrja në RMV në rast se janë të parapara me ligj, me marrëveshje Ndërkombëtare ose në bazë të reciprocitetit.⁵⁹

Hyrja dhe dalja nga territori i RMV-së ose vetëm kalimi nëpërmjet saj, të huajt i jepet vizë.

Organet përgjegjëse për dhënien e vizave për të huaj në RMV-së janë:

- Ministria e Punëve të Brendshme.
- Ministria për Punë të Jashtme
- Përfaqësuesit Diplomatik dhe Konsullorët në RMV-së
- Stacionet policore ose raporti për Kontrollin e Vendkalimit Kufitarë (K.V.K)⁶⁰

Leja e qëndrimit jepet si:

- Leje për qëndrim të përkohshëm
- Leje për qëndrim të përhershëm

Leje për qëndrim të përkohshëm: Në RM-së përcaktohet me kërkesë me shkrim të të huajve, kërkesa për qëndrim të përkohshëm paraqitet me afat prej 3 ditësh nga dita e hyrjes e të huajve në RM-së, nëse ai/ajo vinë për çështje shkollimi, studimi ose për ndonjë qëllim të ngjashëm. Nëse një i huaj vjen me një kompani ose të ndonjë person tjetër juridik, kërkesën për qëndrim të përkohshëm të të huajt e bënë personi juridik teki cili do të qëndrojë i huaji për kryerjen e detyrave profesionale në afat prej 7 ditëve nga hyrja në territorin e RMV-së. Për kërkesën e lëshimit të miratimit kontrollohet që i huaj të ketë pasaportë ose dokument udhëtimi të vlefshëm dhe në gjendje të rregullt, duhet të jep dëshmi se për çfarë shkak, qëllimi do të qëndrojë dhe dëshmia e sigurimit të mjeteve materiale për kohën që do të qëndrojë në RM-së. Organi përgjegjës për dhënien e lejes për qëndrim të përkohshëm është MPB-ja, ajo para se të japë lejen kontrollon nëse i huaj ka paraqitur qëndrimin e tij në RM-së dhe nëse ka ndonjë mospërputhje me ligjin. Leja jepet me afat prej 1 viti ose deri në afatin e kalimit të kohës së dokumentacionit për udhëtimin ose nëse jo periudhë është më e shkurtër se 1 vit. Leja e qëndrimit të përkohshëm për të huaj në kërkesën për të huaj mund që të vazhdohet. Kjo leje jepet duke vlerësuar me vulën e përshkuarnë ndonjë dokument udhëtimi i të huajt.

⁵⁹ Neni 81,82,83,84,85,86,87 i Ligjit mbi lëvizjen dhe qëndrimin e të huajve

⁶⁰ Neni 24,39 i Ligjit mbi lëvizjen dhe qëndrimin e të huajve. Kompetencat për marrjen e vendimit për refuzimin e hyrjes. Organet kompetente për vendosjen dhe për dhënien e vizave. (Gazeta Zyrtare e RM-së. nr-35. Faqe-28.30)

Leja e qëndrimit të përhershëm:

Të huajt që më së paku 3 vite pa ndërprerë, legalisht ka qëndruar në territorin e RMV-së mundet që ti jepet leja e qëndrimit të përhershme. Qëndrimi i përhershëm i të huajt miratohet për të njëjtat arsye për shkak të secilës është miratuar edhe qëndrimi i përkohshëm por edhe në rastin kur:

- Disa nga anëtarët e familjes më të ngushtë të të huajt (bashkëshortja, fëmijët, prindërit) janë shtetas të RMV-së
- I huaj është me origjinë nga RMV-së
- I huaj ka marrë vizë biznesi

Leja për qëndrim të përhershëm në RMV-së do të aprovohet me kërkesë me shkrim për të huajin e cila është dorëzuar në një formë të përkshkruar. Në kërkesën për dhënien e miratimit për qëndrim të përhershëm në RM-së i huaj është i detyruar që ti ketë këto:

- Çertifikatë nga libri amë i të lindurve.
- Çertifikatë nga libri i kurorëzimeve (për njerëz të martuar).
- Vërtetim për gjendjen shëndetësore.
- Çertifikatë për trajnimin profesional.
- Dokumente që vërtetojnë se posedon mjete për jetesë gjatë qëndrimit të tij në RM.

Kërkesa bëhet në MPB në territorin e së cilës i huaj ka një vendbanim ose përmes P.D.K-së. Për lëshimin e lejes së qëndrimit të përkohshëm vendoset vulë në dokumentin e udhëtimit (pasaporta) të të huajt në të cilën shkruhet data dhe numri i miratimit.

Qeveria e RM-së me akt të posaçëm mund që ta ndalojë ose ta kufizojë lëvizjen e të huajve në disa zona ose edhe në të gjithë territorin e RM-së nëse rrezikohet vendi dhe siguria Kombëtare e RM-së.

Në rastin e një të huaj të mitur:

Të huajt të mitur të cilët vinë në RMV-së pa dokumente udhëtimi ose pa dijeninë e personave përgjegjës për të (prindërit, kujdestarët etj), pa mbrojtje sigurimi dhe mjete të nevojshme për mbijetesë ose nuk vepron sipas rregullave të RM-së, atëherë personi zyrtarë i RM-së është i obliguar që menjëherë të njoftojë P.D.K-në e shtetit nga i cili vjen dhe njëkohësisht i huaj kthehet në shtetin e tij prej të cilit ai vjen. Nëse i huaj për çështje objektive nuk mundet që menjëherë të dorëzohet te organet e shtetit të tij nga i cili vjen, atëherë ai do të vendoset në

strehimoren për të huaj. Shpenzimet të cilat shkaktohen me forcë për një të huaj të gjitha do ti paguaj vet ai. Nëse ai nuk ka mjete të gjitha shpenzimet bien në buxhetin republikan.⁶¹

Pasaporta për të huajt: I jepet të huajt i cili:

- I ka plotësuar 18 vite
- Ka miratimin e qëndrimit të përhershëm në RM-së ose ka vizë biznesi
- Do të deponojë 100 mijë dollarë ose valuta të tjera të konvertimit në të njëjtën bankë të autorizuar në RM-së.
- Do të japë deklaratë në të cilën do të deklarohet që nuk do të kryej vepër penale.⁶²

Dokumentet e udhëtimit për Refugjatët:

Jepen sipas marrëveshjes Ndërkombëtare të cilat RMV-ja i ka të nënshkruara dhe të ratifikuara në aspektin e veçantë në kategorinë e personave që në të drejtën publike Ndërkombëtare është i njohur “Statusi i Refugjatëve si dhe personave pa nënshtetësi ” Edhe pse këto dokumente janë të parapara me ligj si dhe pasaporta e të huajve ata deri tash nuk janë dhënë nga MPB-ja.^{63,64}

Viza Turistike:

Përveç dokumentet të udhëtimit për të huaj të deklaruar, ligji parasheh edhe një të drejtë e cila mundëson hyrjen dhe qëndrimin e të huajve në RMV-së. I huaj i cili nuk i ka dokumentet e udhëtimit të vlefshme ndërsa vinë për vizitë turistike ose për udhëtim zyrtarë, MPB-ja para kryerjes së kontrollit në vendkalimin kufitarë në mënyrë të jashtëzakonshme mund që ti jep vizë turistike në bazë të letërnjoftimit ose pasaportës (dokumente me fotografën dhe të dhëna të tij)

I huaj është i obliguar që të paraqesë vendbanimin ose qëndrimin e tij në RM-së në MPB. Afati kohorë për paraqitjen e vendbanimit ose ndërrimin e adresës për të huaj është 8 ditë nga dita e ardhjes në vendin që do të qëndrojë, ndërsa për ta anuluar në afat prej 24 orëve para se të largohet.⁶⁵

⁶¹Neni 16.1.2.3.4.150 i Ligjit për lëvizje dhe qëndrim të të huajve, hyrja e të huajt të mitur Neni 50.149 i Ligjit për lëvizje dhe qëndrim të të huajve. Kushtet për dhënen e vizave për qëndrim të përkohshëm, ndima e të huajve gjatë qëndrimit të paligjshëm, Kundërvajtjet.

⁶²Neni 119.120.121 i Ligjit për lëvizje dhe qëndrim të të huajve, pasaporta për të huaj.

⁶³Neni 142 i Ligjit për lëvizje dhe qëndrim të të huajve, ndima juridike.

⁶⁴Neni 124 i Ligjit për lëvizje dhe qëndrim të të huajve, dokumenti i udhëtimit për refugjatët e pranuar.

⁶⁵Neni 136 i Ligjit për lëvizje dhe qëndrim të të huajve, obligimi i të huajt është ta paraqes vendbanimin ose vendqëndrimin.

2.7 KONTROLLI I KALIMIT KUFITAR

Lëvizja e njerëzve dhe transferimi i mallrave prej njërit në tjetrin shtet prej një periudhe të gjatë veçanërisht pas luftës së dytë Botërore zhvillohet masovikisht në ekonomi, tregti dhe në mënyra të tjera.

Në të Drejtën Ndërkombëtare nocioni kufiri shtetërorë lidhet me përcaktimin e shtetit. Me kufirin shtetërorë nënkuptojmë dallimin e territorit nga njëri shtet në tjetrin. RM-ja ka hapësirë ajrore mbi territorin e vetë dhe brenda kufijve të sajë. Kufiri shtetërorë është përcaktuar dhe shënuar vetëm në sipërfaqen e tokës së sajë, ku etiketohet si vijë në mes të një shteti dhe një shteti tjetër në kufi me atë vend.

Kufiri shtetërorë mund të kalohet vetëm në pikat kufitare, mundet të kalohet me dokumentacione të vlefshme si (pasaportë, letërnjoftim ose dokumente të posaçme të përcaktuara me ligj të lëshuara nga organet përkatëse).

Ligji parasheh tri lloje të pikës kufitare:

- Pika kufitare për qarkullim Ndërkombëtarë, sipas llojeve të trafikut e cila kalon në pikën kufitare mund të jetë: Hekurudhore, ajrore, rrugore, ujore.
- Pika kufitare për qarkullim Ndërkombëtarë është kalimi nëpër të cilën shtetasit e RM-së lëvizin nëpërmjet pikës kufitare në shtetin fqinjë.
- Pika kufitare për lëvizjen kufitare kalimin përmes së cilës shtetasit e RM-së e kalojnë kufirin për qëndrim në zona të caktuara të fqinjëve ose përmes të cilit shtetasit fqinjë e kalojnë kufirin për qëndrim në zona të caktuara në RM-së të përcaktuara me marrëveshjet Ndërkombëtare.⁶⁶

Pikat kufitare i përcakton Qeveria e RMV-së në përputhje me marrëveshjet Ndërkombëtare, Ministria për Punë të Brendshme në përputhje me Ministrin e Transportit dhe Lidhjes përcaktojnë zonat dhe objektet që i përfshinë vendkalimi kufitarë. Në zonën e vendkalimit kufitarë janë disa mjete, hapësirat për kryerjen e kontrolleve gjatë kalimit në vendkalimin kufitarë.

⁶⁶Nenet 20.21.22.23.24.25.26.27.28.29. të Ligjit për kontrollin kufitar të RM-së(Gazeta Zyrtare e RM-së.Nr-171.30.12.2010.Faqe-10-13)

Zona e pikës kufitare qarkullimi hekurudhorë përfshinë hapësirën e kufirit të stacionit hekurudhorë, në të cilin gjenden perone dhe vende pritje në kohën derisa në atë hapësirë mbahet treni për udhëtim Ndërkombëtarë ose pritjet që të kalojë kufirin shtetërorë të RM-së.⁶⁷

Zona e vendkalimit kufitarë Ndërkombëtarë qarkullimit të Liqenit, përfshirë pjesën prej portit ujorë si (Breg, lidhjet, spirancat) me qëllim të arritjes dhe mbajtjes të anijeve në qarkullimin Ndërkombëtarë të Liqenit.

Nuk guxohet që të vendosen tabela reklamim dhe mënyra të ngjashme të shënuara që e pengojnë leximin e shenjave për të kaluar vendkalimin kufitarë. Në pikën kufitare përgjegjësia i takon Ministrisë për Punë të Brendshme ndërsa siguria e vijës kufitare i takon Ministrisë së Mbrojtjes.⁶⁸

Për kalimin kufitarë të shtetit në aspektin e ligjit është e paraparë përcaktimi i rregullt i dokumentacioneve të udhëtimit dhe identiteti i personit që kalon kufirin si dhe kontrolli i automjeteve, mjeteve nga ana e personit të autorizuar të policisë. Kjo është një detyrë kryesore e personave të autorizuar të Ministrisë për Punë të Brendshme.

Personat e autorizuar kryejnë punë administrative si dhe punë të tjera si:

- Dhënien e vizave, leje për turist që duan të hynë në RM-së
- Zbulimin dhe ndalimin e veprave penale, për shkeljen e ligjit si dhe zbulimin e kryerësve të tyre
- Zbulimin e armëve dhe municioneve, tregtinë me njerëz dhe me emigrant ilegal si dhe gjëra të tjera që nuk kanë leje ose në mënyrë ilegale tentojnë që ti shtinë në RM-së
- Mbrojtjen e jetës, shëndetit, pasurive të qytetarëve.
- Rregullimin e trafikut në vendkalimin kufitarë.
- Ruajnë rendin dhe qetësinë publike në zonën e vendkalimit kufitarë, parandalimin e rreziqeve tjera në rendin publik, rendin ligjor, sigurinë nacionale dhe marrëdhëniet Ndërkombëtare dhe punë të tjera të përcaktuara me ligj.⁶⁹

Personi që kalon pikën kufitare është i obliguar që dokumentacionin për udhëtim ta ketë me afat kohorë të rregullt dhe ti dorëzojë te personi zyrtarë për verifikim.

⁶⁷Neni 24.Paragrafi 1 dhe 2 i Ligjit për kontrollin e kufirit shtetërorë të hekurudhave

⁶⁸Neni 29 i Ligjit të kontrollit kufitarë në liqen.

⁶⁹Neni 1.2.5 i Ligjit për kontrollin e kufirit shtetërorë, të dispozitave të përgjishme.Qëllimi i kontrollit kufitar.Organi i cili kryen kontrollet kufitare.

Personi zyrtarë e kontrollon se a është me afat dhe në gjendje të rregullt dokumentacioni dhe pastaj verifikon identitetin e personit. Nëse nuk ka dyshime në dokumentacioni dhe identitetin e personit kalimin e kufirit shtetërorë e shënon në dokumentin e udhëtimit (pasaportë) me vulë. Vula përmban emrin e pikës kufitare dhe datën e kalimit (hyrjes ose daljes në shtet).⁷⁰

Përveç kontrollit të dokumentacionit dhe të identitetit personat zyrtarë kryejnë edhe kontrolle rutinë, kontrolle të subjekteve (bagazheve, sendeve të tjera që posedon personi me vete). Kontrolli dhe kontrolli rutinë (bastisja) kryhen në vende të posaçmesi depo, dhoma të posaçme etj.⁷¹

Në vendkalimet kufitare të shtetit të RM-së mundë të hynë armë dhe municione të blera, të poseduara, të mbajtura në mënyrë legale që posedojnë dokumentacion përkatës për armatim dhe municion por duhej pasur parasysh ligjin dhe lejen për mbajtje të armatimit dhe municionit dhe janë të obliguar që në pikën kufitare ta paraqesin, dhe në afat prej 15 ditëve nga dita e kalimit të kufirit ta paraqesin në MPB-në e atij shteti ku do të qëndrojnë dhe të kërkojnë leje për armët.⁷²

Leja e lëvizjes në vijën kufitare për qarkullimin e trafikut Ndërkombëtarë dhe Ndërshtetëror sipas ligjit për kalimin kufitarë dhe lëvizjen në vijën kufitare mund të jenë: I përhershëm dhe i përkohshëm.

Këto leje i jep Stacioni Policor ose Kontrolli i kalimit të kufirit shtetëror.

Lejet e përhershme për qarkullim në vijën kufitare mund tu jepen shtetasve të RM-së dhe të huajve që janë të punësuar në kufirin shtetërorë me afat kohorë të përhershëm, afati kohorë i lejes është 2 vite me mundësi për vazhdimin e saj. Personave të ekuipazhit të objekteve lundruese u jepet lëvizja e përhershme me afat kohorë 5 vjet. Personave zyrtarë të doganës, sigurimit lundrues, veterinerëve, inspeksionit fitosanitarëve, inspektorëve të tregut, inspektorët e qarkullimit rrugorë që kryejnë shërbime në kufirin shtetërorë u jepet leje e vazhdueshme për lëvizje dhe ndalesë në kufirin shtetërorë. Leja u jepet nga dokumenti zyrtarë i legjitimitetit (bexhi). Verifikimin e bënë stacioni policorë ose kontrolli i kalimit të kontrollit shtetërorë.

⁷⁰Neni 8.12 i Ligjit të kontrollit kufitarë

⁷¹ Neni 6.11.21 i Ligjit të kontrollit kufitarë. Paisjet e personelit dhe objektet e kontrollit kufitar. Vendi për kryerjen e kontrolleve kufitare. Mënyra e kryerjes së kontrollit kufitarë në trafikun rrugor.

⁷²Neni 56.56-a.57 i Ligjit për armë dhe municion. Transporti i armëve dhe municioni www.moi.gov.mk

Lejet e përkohshme të lëvizjes në vijën kufitare të shtetit të RMV-së u jepen personave që vinë në kufirin shtetërorë për afat kohorë të shkurtër më të zakonshëm janë ata të cilët kanë tokën e tyre afër vijës kufitare.

Lejet e përkohshme për lëvizje dhe ndalesë në vijën kufitare janë:

- Individuale
- Kolektive.
- Këto leje i jep Ministria për Punë të Brendshme.⁷³

2.8 MBIKËQYRJA DHE DREJTIMI I KOMUNIKACIONIT RRUGORË NË KUFIRIN SHTETORË

Si çdo shtet edhe Republika e Maqedonisë së Veriut mbron kufijtë dhe territorin e saj në përputhje me Kushtetutën dhe me ligjet e veta.

Me ligjin për kontrollin kufitar rregullohet kontrolli kufitarë, kompetencat e policisë, bashkëpunimin ndërmjet organeve shtetërore që kanë kompetenca në komunikacion shtetërorë, në menaxhimin dhe bashkëpunimin Ndërkombëtarë të policisë. Në ato kalime kufitare ku do të vlerësohet si e nevojshme dhe ku është e nevojshme dhe në përputhje me kushtet që lejojnë përcaktimin e linjave të veçanta të komunikacionit të destinuar për qytetarët e RMV-së, për qytetarët e Bashkimit Evropian si dhe për shtetasit e vendeve tjera. Qytetarët e RMV-së mund të përdorin ndonjë korsi tjetër të komunikacionit dhe jo vetëm një që është përcaktuar për ta.⁷⁴

Mënyra e kryerjes së kontrollit në komunikacionin rrugorë kufitarë:

Gjatë kryerjes së kontrollit kufitarë në komunikacionin rrugorë, personat që kalojnë kufirin shtetërorë me një automjet, si rregull duhet të qëndrojnë në automjet gjatë kohës që kryhet kontrolli. Me përjashtim nga neni 21, paragrafi 1,⁷⁵ nëse rrethanat kërkojnë atëherë personave ju kërkohet që të dalin nga automjeti dhe të tregojnë për objektet që kanë me veti ose brenda automjetit që posedojnë në atë moment, dh kryerjen e inspektimit të tyre. Personat zyrtarë janë të autorizuar që ti inspektojnë të gjithë llojet e automjeteve, duke përfshirë edhe

⁷³Neni 41.47.50.51.52 i Ligjit të kontrollit kufitar.Detyrimin e personave që kryejnë veprimtarinë në territorin e pikes kufitare.Vija kufitare.

⁷⁴Neni 20 i Ligjit të kontrollit kufitar.Përcaaktimi i linjave të veçanta të trafikut.(Gazeta Zyrtare e RM-së.Nr 171.30.12.2010.Faqe 10) www.pravdiko.com

⁷⁵Neni 21.Paragrafi 1 i Ligjit të kontrollit kufitarë.Mënyra e kryerjes së kontrolleve kufitare në trafikun rrugor

shpërbërjen e disa pjesëve të saj pa ndonjë urdhër të gjykatës, kuptohet që nëse ka dyshime që personi që drejton automjetin dhe mjete tjera të transportit, transporton gjëra të paligjshme, si dhe gjërat dhe dokumentet që do ta vërtetojnë identitetin e tij si dhe të personave që gjenden në automjet, si dhe për parandalimin e kalimit të paligjshëm të kufirit shtetërorë të RM-së.⁷⁶

Kontrollet kufitare dhe terrenet kufitare:

- *Kontrollet kufitare në komunikacionin rrugor:* Nëpunësi policorë në detyrë në vendkalimin kufitarë do të kryej kontrollin efektiv tek personat dhe automjetet dhe duhet të sigurojë siguri dhe rrjedhje të pandërprerë të trafikut rrugorë, kontrollet kufitare nëse është e mundur kryhen nga dy nëpunës policie jashtë kabinave të inspektimeve kufitare.⁷⁷

Inspektimi dhe kontrolli i automjeteve bëhet kur:

- Ka arsye për dyshim, se brenda automjetit mund që të ketë të fshehur, drogë, materiale shpërthyes, armë, materiale radioaktive dhe të tjera mjete të paligjshmedhe gjëra të ndaluara.
- Ka arsye për dyshim se shoferi ose pasagjerët e automjetit kanë kryer vepër penale ose kundërvajtje.
- Dokumentet e paraqitura për automjetin dhe pasagjerët janë jo të plota, të falsifikuara ose të pavërteta.⁷⁸

Kontrollet kufitare për automjetet e pasagjerëve privat: Kontrollet kufitare të personave që udhëtojnë me automjete private të pasagjerëve janë kryer si të tillë se një nëpunës i policisë kontrollon dokumentacionin e personave që e kalojnë kufirin dhe nëpunësi tjetër i policisë në të njëjtën kohë i mbikëqyr ata. Personat në mjetin e pasagjerëve duhet të sigurohen nga nëpunësi kontrollues. Kur ka dyshime se dokumenti i udhëtimit, patentë shoferi, sigurimi ose dokumenti i regjistrimit të automjetit është i falsifikuar, atëherë të gjithë pasagjerët zbresin dhe automjeti shkon për inspektim të detajuar. Aktivitetet do të kryhen me kontroll të linjës së dytë.⁷⁹

⁷⁶Neni 21 i Ligjit të kontrollit kufitarë.Mënyra e kryerjes së kontrolleve kufitare në trafikun rrugor

⁷⁷ Neni 9 i Ligjit për kalimin kufitar,kalimi i kufirit shtetror.(Gazeta Zyrtare e RMV-së.Nr-171.30.12.2010.

⁷⁸Neni 10 i Ligjit për kalimin kufitar.Kufiri i brendshëm

⁷⁹Neni 11.Paragrafi 2 i Ligjit për kalimin kufitar.Vendi për kryerjen e kontrolleve kufitare.

Kontrolli kufitarë i autobusëve: Kontrolli kufitarë të personave që kalojnë kufirin shtetërorë me autobus pasi si rregull ata kryhen brenda autobusit dhe duhet të merren masat e mëposhtme si:

- Kontrolli i dokumenteve dhe bagazheve të tyre nëse është e nevojshme, duke filluar nga shoferi dhe udhëzuesi nëse është një udhëtim i organizuar d.m.th. i gjithë autobusi duhet që të verifikohet dhe të kontrollohet.

- Në rast dyshimilidhur me vlefshmërinë e dokumentit të udhëtimit, atij personi i kërkohet që të largohet nga autobusi dhe ti nënshtrohet kontrollit të hollësishëm.⁸⁰

Në rastin e komunikacionit të ngarkuar, përparësi në kontrollin kufitarë të dokumenteve kanë pasagjerët e autobusëve që janë në linjë të rregullt në rrethanat lejojnë atë. Gjatë kontrollit të udhëtimit të personave brenda autobusit nëpunësit e policisë, nëse është e mundur përdorin pajisje elektronike në veçanti për kërkim në bazë të të dhënave elektronike.⁸¹

Kontrolli kufitarë mbi mjetet e transportit: Kontrolli kufitarë të automjeteve të mallrave kryhet në bashkëpunim me zyrtarët e doganës.

Ai kryet në një korsi të veçantë për kamionë, ku mundë të përdoren pajisje teknike, të tilla si pajisjet me rezet X, detektorë për dioksid të karbonit, fibrave, endoskopëve etj.

Gjate kontrollit të kamionëvevëmendje të veçantë u kushtohet mjeteve të transportit me kontejnerë ku mund të fshehin vetura të vjedhura, njerëz ose mallra të rrezikshme. Të gjithë dokumentet për mbajtjen e kontejnerit duhet të shikohen shumë me kujdes.⁸²

Kontrollet e hollësishëm kufitare të mjeteve të transportit duhet të kryhen në rastet kur:

- Vulat doganore janë të prishura
- Lidhja është e dëmtuar, e copëtuar etj.
- Ekziston dyshimi se ka substanca shpërthyes, njerëz të fshehur, drogë, armë, substanca radioaktive dhe mjete ose gjëra të paligjshme dhe të ndaluara.⁸³

Kontrollet shitesë kufitare në automjetet e mallrave kryhen në mënyrë për të gjetur:

- Aftësitë e shoferit për të operuar automjetin, orarin e punës së vozitësit, dhe sigurimin.
- Dimensionet dhe ngarkesat maksimale të lejuara të automjeteve.

⁸⁰Neni 12 i Ligjit për kalimin kufitar.Detyrim për të mundësuar kontrolle kufitare.

⁸¹Neni13 i Ligjit për kalimin kufitar.Kontrolli kufitarë për persona.

⁸²Neni 14 i Ligjit për kalim të kufirit.Llojet e kontrolleve kufitare.

⁸³Neni 15 i Ligjit për kalim të kufirit.Kontrollet minimale kufitare.

- Kontrollet e pranisë së kimikateve biologjike ose radioaktive, si dhe substanca të tjera të dëmshme.^{84,85}

2.9 OFRIMI I NDIHMËS DHE I MBROJTJES SË QYTETARËVE NË RAST TË NEVOJËS SË DOMOSDOSHME

Si në rastet e fatkeqësive natyrore tërmetet, vërshimet, zjarret etj. ose kur shteti është në gjendje lufte, fatkeqësitë në komunikacion, mbështetje në zgjedhjet shtetërore, p.sh. përkrahje ndaj Ministrisë Financave për zbatimin e ligjit ndaj qytetarëve si dhe në shumë raste të tjera, policia siguron asistencë: - për zbatimin e një vendimi ekzekutiv, nëse gjatë ekzekutimit të përmbarrimit mund të justifikohet organi kompetent shtetëror, përkatësisht personat e autorizuar për të zbatuar përmbarrimin me një ligj të veçantë, përballë rezistencës fizike ose një rezistencë të tillë pritet; - sipas kërkesave për asistencë të parashikuara nga një ligj i veçantë (për sigurimin e transportit të materialeve shpërthyes, transportit të jashtëzakonshëm dhe përcjelljen e mallrave të caktuara etj. Dhe sipas kërkesave të organeve shtetërore, institucioneve që kryejnë autorizime publike dhe personave juridikë në lidhje me sigurimin e transportin e parave dhe sendeve të tjera të vlefshme ose sendeve me vlerë, dhe pas një marrëveshjeje të lidhur më parë me aplikantin. Kërkesa për ndihmë duhet të dorëzohet nga autoriteti kompetent në polici me shkrim jo më vonë se pesë ditë para ekzekutimit të përmbarrimit, pra pesë ditë para ditës për të cilën është dhënë nevoja për ndihmë. Kreu i njësisë organizative kompetente vendos për mënyrën e dhënies së ndimës dhe njofton aplikantin në përputhje me rrethanat në kohën e duhur. Kreu i njësisë organizative kompetente për siguri dhe arsye të tjera të justifikuara mund të shtyjë dhënien e asistencës nga paragrafi 1 i këtij neni.⁸⁶ Shpenzimet për ndihmën e kryer i paguajnë kërkuesit e ndimës. Ministri i Brendshëm merr vendim për rimarrjen e shpenzimeve për ofrimin e asistencës (ndima), vlera e së cilës

⁸⁴ Neni 16 i Ligjit për kalim të kufirit. Kontrollet e detajuara kufitare.

⁸⁵ Kjo rregull zbatohet në harmonizimin me rregulloren e Këshillit Evropian Nr.562/2006 të Parlamentit Evropian dhe Këshillit mbi rregullat që rregullojnë lëvizjen e personave përtej kufive (Kufiri shengen CODEX) i datës 15.03.2016 CELEX Nr32006R0562.

Kontrollet kufitare mbi kufitë tokësore Nenet 9.10.11.12.13.14.15.16.(Gazeta Zyrtare e RM-së.Nr-75.15.06.2012.Rregullore për shfrytëzimin kufitarë faqe 3-40.

⁸⁶ Neni 7 i Ligjit për Punë të Brendshme.

përcaktohet pas orarit të punës, numri i punëtorëve të angazhuar si dhe mjetet dhe auto mjetet që do ti duhen për kryerjen e detyrave.⁸⁷

2.10 SIGURIMI I PERSONAVE DHE I OBJEKTEVE TË PËRCAKTUARA ME LIGJ

Sigurimi si term ka shumë kuptime, si sigurimi i shtëpisë, fabrikave, institucioneve publike, kufirit shtetëror, sigurimi i ushtrisë, objekteve policore, institucioneve shtetërore, sigurimi i personaliteteve publike, sigurimi i tubimeve publike, manifestimet etj.⁸⁸

Sipas kësaj mund të vijmë në përfundim se sigurimi shërben për mbrojtjen e personave, objekteve mallrave, materialeve etj. Ndërsa rëndësinë e këtij sigurimi e ka MPB-ja por mund të kyçen edhe subjekte të tjera.

Si persona që sigurohen janë:

- Njerëz të rëndësishëm publik.
- Kryetari i RM-së, Kryetari i Qeverisë, Kryetari i Kuvendit e deri te ministrat.
- Personat publik si këngëtarë, aktorë etj.
- Anëtarët e familjes mbretërore, kryetarët e shteteve të huaj, Shefat e Qeverisë kur janë në vizitë në RM-së etj.⁸⁹

MPB-ja organizon dhe kryen mbrojtje të:

- Objektet që ekzistojnë ose përkohësisht i shfrytëzojnë personat të cilët i sigurojnë gjatë kryerjes së punëve.
- Objektet për përfaqësime.
- Objektet për qëndrim dhe pushime të personave të siguruar.
- Si dhe shtëpitë e tyre.

Njëkohësisht MPB-ja i mbron edhe MB-në, MPJ-në, Ministrinë e Financave, Ministrinë e Drejtësisë etj, deri sa i kryejnë punët e tyre zyrtare.

Në gjendje të jashtëzakonshme apo në gjendje lufte me pëlqimin paraprak të kryetarit të Qeverisë MPB-ja mund të përcaktojë edhe personalitete të tjera për tu mbrojtur. Gjithashtu

⁸⁷Neni 7-a i Ligjit për Punë të Brendshme.

⁸⁸Neni 1 i Ligjit për Punë të Brendshme. Kryen edhe punë për të siguruar persona dhe objekte.

⁸⁹Neni 4 i ligjit për personat dhe objektet që do të ofrojnë , llojet e masave dhe aktiviteteve dhe nivelet e sigurisë.(Gazeta Zyrtare e RM-së.Nr.56.27.03.2014)

kryen edhe mbrojtjen e personaliteteve të tjera sitë ftuarit musafirët të huaj, që janë për vizitë në RM-së.⁹⁰

MPB-ja kryen edhe mbrojtjen fizike në objektet ku ato do të qëndrojnë:

- Kuvendi i RMV-së.
- Qeveria e RMV-së.
- Objektet në të cilat janë vendosur vendet e Ministrive.⁹¹

Ministria e Mbrojtjes organizon edhe kryen mbrojtje fizike në objektin ku qëndron Kryetari i RM-së dhe rezidenca e tij, shtëpia e cila i përket Komandantit Suprem të Forcave të Armatosura të RM-së.

Gjithashtu MPB-ja organizon mbrojtjen fizike të objektit në të cilin vazhdimisht jetojnë Kryetari i Qeverisë dhe Kryetari i Kuvendit të RM-së.

Pavarësisht nga objektet e lartpërmendura, me veprime dhe aktivitete të veçanta i mbron edhe:

- Objektet në të cilat janë të vendosura organet shtetërore, organizatat, ndërmarrjet dhe personat që janë me kuptim të veçantë për mbrojtjen e RM-së.
- Objektet ku ruhen dokumentet e rëndësishëm dhe materialet që përfaqësojnë shtetin, ushtrinë, sekretet zyrtare etj.
- Zonat specifike që janë në interes të veçantë për mbrojtjen e RM-së.
- Objektet ku janë të vendosur Zyrtarët Përfaqësues të Konsullatave Diplomatie (ZPKD).

Masat dhe aktivitetet që i ndërmerr Ministria e Punëve të Brendshme për mbrojtjen e personave dhe objekteve në kuptimin e udhëzimit janë:

- Aktivitetet parandaluese operative.
- Masat dhe aktivitetet fizike.
- Masat dhe aktivitetet teknike parandaluese.⁹²

Për punët e kryerjes së sigurimit për disa persona dhe delegacione drejtpërdrejt pran MPB-së marrin pjesë edhe shërbimet e ekspertëve të inspektimit me të cilët MPB-ja bashkëpunon.

⁹⁰Neni 9.10.11.12.13.14.15 i Ligjit për personat dhe objektet që do të ofrohen, llojet e masave dhe aktivitetet dhe nivelet e sigurisë.

⁹¹Neni 4.5.6 i Ligjit për personat dhe objektet që do të ofrohen, llojet e masave dhe aktivitetet dhe nivelet e sigurisë.

⁹²Neni 16.17.18 i Ligjit për personat dhe objektet që do të ofrohen, llojet e masave dhe aktivitetet dhe nivelet e sigurisë.

MPB-ja në kryerjen e punëve për sigurimin gjithashtu i merë masat dhe aktivitetet e më poshtme:

- Të dhënat dhe informacionet me rëndësi për sigurimin dhe i merë masat e duhura për sigurimin e personave dhe delegacioneve që duhet të sigurohen.
- Kryen vlerësimin dhe përcakton masat e sigurisë sipas tij.
- Përgatit planin për sigurim nga grupi i punës për të punuar, angazhohet për zbatimin praktik dhe realizimin e saj.
- Kryen vëzhgimin operacional të sigurisë në persona, objekte, plane urbanistike dhe në zona.
- Kryen kontrollin e të dhënave për personat që angazhohen në detyrat për sigurim, personave që jetojnë në afërsi të objektit që sigurohen.
- Kryejnë trajnime të sigurisë për personat që angazhohen në detyrat e sigurimit si (kurse, seminare për sigurim).
- Aplikohen masat dhe mjetet e nevojshme të mbrojtjes operative dhe teknike (Ndalimi i lëvizjes së personave në një hapësirë të caktuar).
- Nëpërmjet Drejtorisë për Sigurim (DS) i informojnë shërbimet kompetente dhe organet për qëndrim dhe udhëtim të disa personave për shkak të kohës duke marrë masat e nevojshme të sigurisë
- Kontakton dhe i rregullon masat e sigurisë me shërbimet e huaja për siguri.
- Bënë veprim parandalues dhe ushtron mbikëqyrjen mbi një kategori të caktuar të personave (Persona të rrezikshëm, të prirë për kërcënim dhe sjellje të dhunshme) dhe merë masa për parandalimin e tyre.
- Kryen vëzhgimin operacional të sigurisë dhe sigurinë fizike të objekteve të cilat i shfrytëzojnë hapësirat e tyre, planin urbanistik të lëvizjes, mjetet e qarkullimit me të cilat lëvizin personat që sigurohen.
- Kryen kontrole të avancuara në operacionet e transportit të personave dhe bagazheve, në të gjitha llojet e trafikut.
- Kryen kontrollet e prodhimtarisë, ruajtjen e eksplozivëve, lëngjeve të ndezshme dhe gazrave.
- Kryen kontroll në vendet ku tubohen kriminelët.

- Kryen kontroll të avancuar në vendkalimin kufitarë të shtetit të RM-së.⁹³

Këtu në këtë pjesë, janë me rëndësi të theksohen edhe parimet themelore të ushtrimit të punëve të policisë, të cilat sipas Prof. Dr Jeton Shasivari ndahen në parime të përgjithshme dhe në parime të veçanta⁹⁴.

Sipas prof. Shasivari, **parimet e përgjithshme** janë: parimi i ligjshmërisë, parimi i publicitetit (puna e hapur), parimi i mëvetësisë, parimi i efikasitetit dhe parimi i bashkëpunimit me subjektet e tjera juridike dhe me qytetarët. **Parimet e veçanta** janë: parimi i mbrojtjes së njerëzve dhe i dinjitetit të tyre, parimi i gradualitetit (shkallshmërisë) dhe parimi i proporcionalitetit. **Parimi i ligjshmërisë** paraqet njërin nga parimet kryesore i cili përcaktohet me Kushtetutën e RM-së, ku në nenin 51 thuhet: “Në Republikën e Maqedonisë ligjet duhet të jenë në pajtim me Kushtetutën, ndërsa të gjitha dispozitat e tjera në pajtim me Kushtetutën dhe me ligjin. Secili është i detyruar që të respektojë Kushtetutën dhe ligjet”. Policia si shërbim publik i MPB-së kryen punë të caktuara të përcaktuara me ligj. Policia u ofron qytetarëve mbrojtjen e të drejtave të tyre themelore si dhe të vlerave të caktuara me kushtetutë dhe ligj. Pra, ky parim paraqet parimin themelor, i cili shprehet në detyrimin e përgjithshëm të gjithkujt dhe secilit që me rastin e nxjerrjes së akteve juridike dhe me rastin e ndërmarrjes së veprimeve materiale t’u përmbahen ligjeve, marrëveshjeve ndërkombëtare dhe dispozitave të tjera juridike në bazë të ligjit⁹⁵. **Parimi i publicitetit** është i përcaktuar me nenin 10 të Ligjit për policinë ku përcaktohet se, policia e njofton opinionin për çështjet nga kompetenca e saj. Me kërkesën e qytetarëve, të organeve shtetërore, të ndërmarrjeve publike, dhe personave të tjerë juridikë, policia u jep informata, të dhëna dhe njoftime për çështjet nga fushëveprimi i vet për të cilat ato janë të interesuar drejtpërdrejtë. Nuk do të jepen informata, të dhëna dhe njoftime vetëm nëse ato me ligj janë përcaktuar me shkallë përkatëse klasifikimi, përveç kur janë plotësuar kushtet me ligj të veçantë. **Parimi i mëvetësisë** në kuptim të përgjithshëm është i përcaktuar me Kushtetutën e RM-së (nenet 95, 96 dhe 97) ku përcaktohet se, administratën shtetërore e përbëjnë ministritë dhe organet e tjera të administratës dhe organizatat e caktuara me ligj. Ndalohet organizimi dhe veprimi politik në organet e administratës shtetërore. Organizimi dhe puna e organeve të administratës shtetërore rregullohen me ligj i cili miratohet

⁹³ Neni 1.2.3 i Ligjit për personat dhe objektet që do të ofrohen, llojet e masave dhe aktivitetet dhe nivelet e sigurisë.

⁹⁴ Prof. Dr Jeton Shasivari, E drejta policore-Dispensë, Fakulteti juridik-UEJL, Tetovë 2016, fq. 111-114.

⁹⁵ Po aty.

me shumicë prej dy të tretave të votave nga numri i përgjithshëm i deputetëve. Organet e administratës shtetërore punët nga kompetenca e tyre i ushtrojnë në mënyrë të pavarur në bazë të Kushtetutës dhe të ligjeve dhe për punën e tyre i përgjigjen Qeverisë. Organet e administratës shtetërore në lëmenjtë e mbrojtjes dhe policisë i udhëheqin personat civil, të cilët drejtpërdrejtë para zgjedhjes në ato funksione kanë qenë civil së paku tre vite⁹⁶. **Parimi i efikasitetit** ka për qëllim që me rastin e veprimit të organeve të administratës shtetërore me sa më pak shpenzime të kohës dhe të mjeteve të arrihet rezultati sa më i mirë, përkatësisht që qytetarët sa më lehtë dhe sa më shpejtë të realizojnë të drejtat dhe interesat e tyre para organeve të administratës shtetërore. Ky parim nënkupton se organet janë të detyruar që të sigurojnë realizimin efikas të të drejtave dhe interesave të palëve. Pra, parimi në fjalë shënon një vendosje të shpejtë, të suksesshme dhe kualitative. Në funksion të këtij parimi në RM janë bërë *disa ndryshime dhe plotësime* ligjore që kanë për qëllim realizimin sa më konsekuent të parimit të efikasitetit *si për shembull*: detyrimi i organit të lutur për të dhënë ndihmë juridike në afat prej 30 ditëve; ose mundësia e lëshimit të drejtpërdrejtë të disa dokumenteve personale për shtetasit tanë jashtë shtetit, e jo përmes përfaqësive diplomatike dhe konzullore; ose përpilimi i disa vendimeve në procedurë të shkurtuar me shfrytëzimin e kompjuterëve gjë që zbatohet nga drejtoria e të ardhurave publike si dhe nga njësitë e vetadministrimit lokal me rastin e përpilimit të vendimeve për përcaktimin e detyrimit tatimor në pronë; ose detyrimi ligjor sipas të cilit certifikatat dhe dokumentet e tjera për faktet për të cilët mbahet evidenca zyrtare i lëshohen palës sipas kërkesës orale sipas rregullit në të njëjtën ditë kur pala ka kërkuar lëshimin e certifikatës, ose më së voni në afat prej 15 ditëve, nëse nuk është përcaktuar ndryshe me dispozitat mbi evidencën zyrtare⁹⁷. **Parimi i bashkëpunimit** është i përcaktuar me nenet 11 dhe 12 të Ligjit për policinë, ku përcaktohet se, policia bashkëpunon me qytetarët, me organet shtetërore, me shoqatat e qytetarëve dhe me personat e tjerë juridikë për shkak të pengimit ose zbulimit të veprave penale ose të kundërvajtjeve. Policia bashkëpunon edhe me organet e komunave dhe të Qytetit të Shkupit për punët që kanë të bëjnë me sigurinë publike dhe sigurinë në trafikun rrugor, me çrast mund të formohen edhe trupa këshillëdhënëse (komisione dhe këshilla) me qëllim të ndërtimit të rekomandimeve të përbashkëta për përmirësimin e gjendjes së sigurisë publike. Poashtu policia bashkëpunon edhe me shërbimet e

⁹⁶ Prof. Dr Jeton Shasivari, E drejta policore-Dispensë, Fakulteti juridik-UEJL, Tetovë 2016, fq. 111-114

⁹⁷ Po aty.

huaja policore dhe organizatat ndërkombëtare policore në pajtim me traktatet ndërkombëtare që i ratifikon shteti i RM-së⁹⁸. **Parimi i mbrojtjes** së njerëzve dhe të dinjitetit të tyre përcaktohet me nenin 32 të Ligjit për policinë, ku përcaktohet se, në ushtrimin e autorizimeve dhe detyrave policore, nëpunësi policor është i detyruar të veprojë në mënyrë humane dhe të respektojë dinjitetin dhe nderin e personave si dhe liritë dhe të drejtat themelore të njeriut dhe të qytetarit. Policia mund ti kufizojë liritë dhe të drejtat themelore të njeriut dhe të qytetarit vetëm në kushte dhe në procedurë të përcaktuar me Kushtetutë dhe me ligj. **Parimi i gradualitetit** i obligon pjesëtarët e policisë që mjetet e detyrimit (forca fizike, shkopi i gomës, qeni zyrtar, arma e zjarrit, mjetet kimike, etj.) t'i përdorin gradualisht përkatësisht, së pari mjetet më të buta të forcës me të cilët arrihet deri te realizimi i detyrës zyrtare policore, dhe më pas nëse është e nevojshme edhe mjetet më të rënda. Pra, ky parim ka për qëllim që t'i mbrojë qytetarët nga zbatimi dhe përdorimi i atyre mjeteve të detyrimit që tejkalojnë masën e nevojshme (të domosdoshme). Nëpunësi policor është i detyruar që para se të përdorë mjetin e detyrimit ta paralajmërojë personin ndaj të cilit ka për qëllim të përdorë mjetin e detyrimit, përveç nëse me të do të vihet në pikëpyetje realizimi i detyrës zyrtare policore. Kështu, sipas nenit 89 të Ligjit për policinë, para përdorimit të armës së zjarrit, nëpunësi policor do të japë urdhër me gojë dhe paralajmërim "Ndal policia!", dhe pastaj edhe urdhërin e dytë dhe paralajmërimin "Ndal, do të gjuaj!"⁹⁹. **Parimi i proporcionalitetit** kërkon nga nëpunësi policor që me rastin e përdorimit të mjeteve të detyrimit që i ka në dispozicion, mjete që do të përdoret të jetë në përpjestim (proporcion) me rrezikun që i kanoset gjatë kryerjes së detyrës zyrtare policore. Pra, midis rezistencës (sulmit) dhe mjetit të përdorur të detyrimit doemos duhet të ekzistojë përpjestimi (proporcioni) që d.m.th. se nga intesiteti i forcës fizike me të cilën shërbehet personi varet edhe përdorimi i forcës fizike me të cilën shërbehet nëpunësi policor, gjë që varet nga kushtet e rastit konkret. Pra, ky parim paraqet kriterin dhe kufirin (limitin) të çdo cenimi (shkelje) të policisë në liritë dhe të drejtat e qytetarëve. Ky parim përcaktohet me nenin 35 të Ligjit për policinë ku përcaktohet se, zbatimi i autorizimeve policore doemos duhet të jetë në përpjestim me nevojën për të cilën ndërmerren. Nga autorizimet policore zbatohen

⁹⁸ Po aty.

⁹⁹ Prof. Dr Jeton Shasivari, E drejta policore-Dispensë, Fakulteti juridik-UEJL, Tetovë 2016, fq. 111-114

vetëm ato, me të cilat me më pak pasoja të dëmshme dhe në afat sa më të shkurtër kohor do të arrihet qëllimi¹⁰⁰.

¹⁰⁰ Po aty.

KAPITULLI I TRETË

3. AUTORIZIMET POLICORE DHE TË DREJTA E NJERIUT NË REPUBLIKËN E MAQEDONISË SË VERIUT

3.1 AKTET NDËRKOMBËTARE PËR TË DREJTAT E NJERIUT

Si rezultat i evolucionit të qëllimit njerëzor për krijimin e një shoqërie njerëzore dhe të drejtë, në të cilën një person si një qenie e lirë e kupton të drejtat e tij individuale dhe kolektive të natyrshme në natyrën e tij njerëzore, ideja dhe koncepti i të drejtave dhe lirive të njeriut shfaqet dhe zhvillohet. Qëllimet e zhvillimit të idesë së të drejtave të njeriut rrjedhin nga të drejtat dhe detyrimet morale midis njerëzve që jetojnë në një rend shoqëror, ose midis njerëzve dhe autoriteteve politike, domethënë institucioneve të atij rendi shoqëror. Zhvillohet në masën që është konceptuar si sistemi më i përgjithshëm i vlerave, i pranuar nga numri më i madh i botimeve dhe kulturave shtetërore, si përfitim qytetëruar nga zhvillimi i mësimave dhe teorive fetare, filozofike dhe ligjore, dhe në përgjithësi nga zhvillimi i mendimit njerëzor. Sot Aktet Ndërkombëtare për të drejtat e njeriut kanë bazën dhe konceptin e tyre ligjor në të drejtën ndërkombëtare, në formën e normave dhe standardeve ligjore të shkruara, si dhe institucionet relevante që garantojnë dhe kontrollojnë zbatimin dhe respektin e tyre.

Ato janë përfshirë në sistemet ligjore Kombëtare të shteteve moderne që duhet të garantojnë dhe të sigurojnë respektin e tyre për jetën e përditshme të qytetarëve.

Koncepti i Akteve Ndërkombëtare për të drejtat dhe Liritë e Njeriut, si koncepti themelor dhe parimi themelor i shoqërisë moderne demokratike, shfaqet menjëherë pas përfundimit të Luftës së Dytë Botërore me themelimin e Kombeve të Bashkuara në vitin 1945 dhe miratimin e Deklaratës Universale të të Drejtave të Njeriut në vitin 1948.

"Të gjitha qeniet Njerëzore lindin të lirë dhe të barabartë me dinjitet dhe të drejta. Ata janë të pajisur me arsye dhe vetëdije dhe kanë nevojë për një fund të tjerët të veprojnë në frymën e vëllazërisë ".¹⁰¹

Thelbi i konceptit i Akteve Ndërkombëtare për të Drejtat e Njeriut që gjendet në Deklaratën Universale të të Drejtave të Njeriut, në të cilën përveç artikullit të lartpërmendur në të cilin shprehet e drejta për barazi ka 29 anëtarë të tjerë të cilat, së bashku me preambullën

¹⁰¹Neni 1 Deklarata Universale e të Drejtave të Njeriut, Paris, 1948

përfaqësojnë burimin themelor të ligjit, i cili përmirësohet më tej me dokumente të tjera ligjore Ndërkombëtare dhe në bazë të të cilave bazohet legjislacioni kombëtar të cilët i shprehin të drejtat dhe liritë e tjera përmes normave ligjore që rregullojnë dhe garantojnë këto të drejta si përfitimet më të larta të qytetërimit.¹⁰²

"Të gjitha të Drejtat dhe Liritë e parashtruara në këtë Deklaratë u përkasin të gjithë Njerëzve, pavarësisht nga dallimet e tyre siç janë: Raca, ngjyra, gjinia, gjuha, feja, besimi politik ose tjetër, origjina kombëtare, sociale, pasuria, lindja ose statuset e tjera. Për më tepër nuk do të merret parasysh statusi politik, ligjor apo Ndërkombëtar i vendit ose territorit të cilit i përket ai/ajo person, pavarësisht nëse vendi është i pavarur, pa vetëqeverisje ose në ndonjë formë tjetër të kufizimit të sovranitetit të sajë".¹⁰³

Karakteri universal i standardeve të formuluar në të Drejtën dhe praktikën Ndërkombëtare, të pranuar nga të gjitha shtetet nënshkruese të traktateve ndërkombëtare në lidhje me respektimin e të Drejtave dhe Lirive të njeriut e tejkalojnë sovranitetin kombëtar. Kjo do të thotë se është një interes Ndërkombëtar legjitim ligjor që lejon vëzhgimin, paralajmërimin, kritikën dhe ndërhyrjen kundër çdo forme shtetërore që shkel dhe nuk respekton Liritë dhe të Drejtat themelore të Njeriut.

Në përpjekjen për të dhënë një përkufizim për Aktet Ndërkombëtare për të Drejtave të Njeriut, një nga autorët tanë që merren me të Drejtën Ndërkombëtare përcakton të Drejtat e Njeriut si: "Një sërë parimesh dhe normash të krijuara mbi bazën e njohjes së dinjitetit Njerëzor si një karakteristikë universale, themelore të natyrës Njerëzore, me qëllim të sigurimit të respektimit të marrëdhënieve midis Njerëzve në shoqëri dhe midis Njerëzve dhe institucioneve politike në shtet, me qëllim mbrojtjen dhe zhvillimin e dinjitetit Njerëzor, lirinë dhe barazinë".¹⁰⁴

3.2 PËRDORIMI I FORCËS FIZIKE NGA POLICIA DHE TË DREJTAT E NJERIUT

Prioriteti më i lartë i policisë duhet të jetë respektimi dhe mbrojtja e jetës.¹⁰⁵ Ky parim zbatohet në mënyrë specifike në përdorimin e forcës nga policia. Përveç faktit se përdorimi i forcës

¹⁰² Në Kushtetutën e Republikës së Maqedonisë, këto të Drejta dhe Liri përfshihen në seksionin II Liritë dhe të Drejtat themelore të individit dhe të qytetarit, të cilat përfshijnë:

1. Liritë dhe të drejtat civile dhe politike.
2. Të drejtat ekonomike, sociale dhe kulturore dhe
3. Garancitë e lirive dhe të drejtave themelore.

¹⁰³ Neni 2. Deklarata Universale e të Drejtave të Njeriut, Paris, 1948.

¹⁰⁴ Frckovski, E drejta Ndërkombëtare për të Drejtat e Njeriut, fq. 14-15, 2005 Shkup.

¹⁰⁵ Neni 3 Deklarata Universale e të Drejtave të Njeriut. Neni 10 i Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut.

shpesh është i nevojshëm për punën epolicisë, në parandalimin e krimit, qoftë gjatë ekzekutimit ose në ndihmën e arrestimit të autorëve të dyshuar, nëpunësit policorë duhet që ta respektojnë parimin e përdorimit të forcës, sepse përdorimi i forcës konsiderohet të jetë i jashtëzakonshëm, një masë që nuk duhet të përdoret në mënyrë të tepruar por duhet të jetë në përputhje me kërcënimin.¹⁰⁶ dhe të përdoret vetëm në atë masë që të arrihet qëllimi legjitim dhe të shkaktohen dëmtime minimale.¹⁰⁷

Në raste më ekstreme, kur vetëm me forcë fizike nuk mund të kapërcejë rezistencën dhe ka arsye për përdorimin e forcës, punonjësi i policisë është i autorizuar të përdorë një shkop si një mjet detyrimi.

Ekzistojnë tri raste kur përdorimi i mjeteve të lidhjes së personave lejohet për shkak të:

- 1) parandalimi i rezistencës ndaj personave ose refuzimi i sulmeve në shënjestër punonjësi i policisë;
- 2) parandalimin e arratisjes së personave dhe
- 3) paaftësimin e vetë-lëndimit ose lëndimit të të tjerëve.¹⁰⁸

Personat zyrtarë të autorizuar nuk duhet të përdorin armë zjarri ose forcë vdekjeprurëse kundër një personi përveç në këto raste:

- Për vetëmbrojtje.
- Mbrojtjen e të tjerëve nga kërcënim i menjëhershëm i vdekjes ose lëndimit të rëndë.
- Në parandalimin e kryerjes së një krimi të rëndë që përfshin një kërcënim serioz për jetë.
- Kur arreston një person që përbën një rrezik dhe i kundërvihet i arrestuari, ose në parandalimin e arratisjes së tij/sajë.
- Me dashje përdorimi vdekjeprurës i armëve të zjarrit mund të përdoret vetëm kur është e pashmangshme për të mbrojtur jetën.¹⁰⁹

Nëse detyrohet të përdorë armët e zjarrit personi zyrtarë i autorizuar duhet që të paraqitet dhe të paralajmërojë rastin dhe qëllimin e tyre për përdorimin e armës së zjarrit, përveç nëse jeta e

¹⁰⁶ Neni 1.2.3 i Kombeve të Bashkuara.Kodi i sjelljes për zyrtarët e autorizuar.

¹⁰⁷ Neni 5-a dhe b i Kombeve të Bashkuara.Parimet themelore për përdorimin e forcës dhe armëve të zjarrit nga ana e policisë.

¹⁰⁸ Neni 86 i Ligjit për Policinë

¹⁰⁹ Neni 9 i Kombeve të Bashkuara.Parimet themelore për përdorimin e forcës dhe armëve të zjarrit nga ana e policisë.

tyre ose jeta e qytetarëve është në rrezik dhe nuk mjafton koha për paralajmërim.¹¹⁰ Personat zyrtarë të autorizuar duhet që të sigurohen që ndihma mjekësore dhe të tjerët do të vinë për ndihmë si dhe do ti ndihmojnë edhe personat e tjerë të lënduar edhe atë sa më shpejtë që është e mundur,¹¹¹ dhe që të afërmit ose miqtë e ngushtë të të lënduarve të informohen menjëherë.¹¹²

Nëpunësit policorë duhet të trajnohen për zbatimin e duhur të standardeve profesionale në përdorimin e forcës, duke përfshirë alternativën:

- Zgjidhjet e përdorimit të forcës dhe armëve.
- Zgjidhja paqësore e konfliktit.
- Mirëkuptimin, sjelljen e turmës.
- Metodat e bindjes.
- Negocimin dhe ndërmjetësimin.
- Përdorimin e mjeteve teknike për përdorimin e kufizuar të forcës dhe armëve të zjarrit.¹¹³

3.3 HETIMET POLICORE DHE TË DREJTAT E NJERIUT

Hetimet policore duhet të bazohen në një dyshim të justifikuar të asaj që është kryer ose mund të jetë një çështje penale. Informacionet publike që përdoren për të filluar një hetim policorë duhet të vlerësohen dhe pastaj të veprojnë pa paragjykime dhe në mënyrë efektive. Në punën e tyre (hetuesit) oficerët policorë duhet ti përmbahen sundimit të prezumimit të pafajësisë deri sa të shpallet i dyshuari fajtorë nga gjykata,¹¹⁴ si dhe tu përmbahen rregullave të duhura të procesit të hetimit. Intervista (biseda me dëshmitarët, viktimat dhe të dyshuarit) nga policia duhet të kryhen në një gjuhë që kuptohet nga të intervistuarit. Para bisedës policët duhet të identifikohen dhe ti kenë të paraqitur personat e mbetur, të pranishëm në intervistë dhe gjatë

¹¹⁰Neni 10 i Kombeve të Bashkuara.Parimet themelore për përdorimin e forcës dhe armëve të zjarrit nga ana e policisë.

¹¹¹Neni 5b i Kombeve të Bashkuara.Parimet themelore për përdorimin e forcës dhe armëve të zjarrit nga ana e policisë.

¹¹²Neni 5g i Kombeve të Bashkuara.Parimet themelore për përdorimin e forcës dhe armëve të zjarrit nga ana e policisë.

¹¹³Neni 19.20 i Kombeve të Bashkuara.Parimet themelore për përdorimin e forcës dhe armëve të zjarrit nga ana e policisë.

¹¹⁴Neni 11.1 Deklarata Univerzale për të Drejtat e Njeriut.Neni 14.2 Kombet e Bashkuara.Konventa Ndërkombëtare për të Drejtat Civile dhe Politike.Neni 48 i Këshillit Evropian.Kodi Evropian i etikës policore.Amnesty International.10 standartet themelore për të Drejtat e Njeriut Haris.Roli i potencialit të ndërtimit në reformën e policisë,faqe 50

asaj. Policia duhet patjetër ta informojë të intervistuarin për arsyen e tij në intervistë, për të drejtat e tij dhe procedurat që do të zbatohen për hetimin. Personat e intervistuar duhet të informohen për të drejtat e tyre për të kontaktuar me avokat si dhe të drejtën e avokatit për të marrë pjesë në intervistë, nëse është e paraparë me ligj. Përveç kësaj të dyshuarit duhet që të informohen për çdo pagesë kundër tyre.¹¹⁵

Të dyshuarit nuk duhen të detyrohen që të mbrohen, tu përgjigjen pyetjeve, të fajësojnë veten ose të afërmit e tyre ose të pranojnë fajin. Marrja e pranimit ose të ndonjë deklarate tjetër të marrë me forcë, torturë ose duke kërcënuar ose me ndihmën e drogës duhet që patjetër të ndalohet dhe të sanksionohet,¹¹⁶ prandaj duhet të vendosen rregulla dhe udhëzime të qarta për personat nën ndikimin e drogës dhe alkoolit.

Sistematikisht duhet të mbahen evidenca për kohën se kur fillon dhe kur mbaron intervista, për çdo kërkesë të intervistuarit ose nga personat e pranishëm gjatë intervistës.

Hetimet e policisë duhet të jenë “të kujdesshmedhe të përshtatura për nevojat e veçanta të personave si :

- Fëmijët.
- Të miturit.
- Gratë.
- Minoritetet , duke përfshirë pakicën etnike.¹¹⁷

Gjatë hetimeve një oficer policie mund të shkel të drejtën e privatësisë duke përfshirë:

- Jetën private.
- Jetën familjare.
- Shtëpinë dhe hapësirat e tjera.
- Kur është në mënyrë strikte ligjore dhe vetëm për të arritur një qëllim të caktuar legjitim. Informacionet dhe dokumentet e siguruar nga ana e policisë patjetër të trajtohen në mënyrë të veçantë dhe detyrimisht informacioni të jetë i siguruar mirë.¹¹⁸

¹¹⁵Neni 23.Shënimi 61 dokumenti I Moskës.Neni 12.Shënimi 32.Komiteti i Helsingut.i Hungarisë, rekomandimet nga Budapesti.Komiteti Ndërkombëtarë i Kryqit tkuq (KNKK) të Drejtat e Njeriut dhe të Drejtat humanitare koncepti profesionalpolicor (Gjenevë 2002).

¹¹⁶Misioni i OSBE-së Për të Drejtat e Njeriut dhe zbatimin e ligjit.Broshurë për të Drejtat e Njeriut për policinë.

¹¹⁷Shënimi 5 i Këshilli i Evropës,Kodi Etik i policisë

¹¹⁸Neni 4.Shënimi 5 i Kombeve të Bashkuara.Kodi i sjelljes për zyrtarët e zbatimit të ligjit.Pjesa A.15 Këshilli i Evropës.Deklarata për policin (1979).Neni 11.12.Shënimi 9 i Këshillit Evropian.i Kodit të etikës policore .

Mjetet e reja teknologjike lejojnë një shkëlqje të madhe të privatësisë të qytetarëve (si dhe përdorimi i mashtrimit) dhe mund të dëmtojnë jo vetëm privatësinë dhe lirinë e shprehjes por edhe besimin e publikut tek autoritetet kompetente.¹¹⁹ Në mënyrë që të mbajnë një ekuilibër të drejtë në mes të ruajtjes së sigurisë publike përmes marrjes së masave të autorizuara dhe mbajtjen e të drejtave personale, duhet të zhvillojnë një kornizë ligjore për kryerjen e hetimeve sekrete.¹²⁰

3.4 ARRESTIMI DHE TË DREJTAT E NJERIUT

Maltretimi i personave është një çështje që shqetëson çdo shoqëri. Bordi për ndalimin e torturës (BND) e ka vizituar Maqedoninë në vitin 1998. Dëgjoi një numër të konsiderueshëm të akuzave për sjellje të pahijëshme fizike nga ana e policisë gjatë arrestimit, paraburgimit, burgimit dhe në raste të tjera.¹²¹

Privimi i Lirisë (arrestim) dhe veprat më me rëndësi të madhe ku shkelen të Drejtat e Njeriut:

Arrestimi i një personi është një nga veprat e policisë, në rastet ku mund të ketë abuzim dhe shkëlqje të të Drejtave të Njeriut sepse ka hapësirë ku përfshihet një nëpunës policor ku e drejton një person i cili dyshohet se ka kryer një Vepër Penale. Të arrestohet do të thotë që një person ta privosh ose ta kufizosh nga liria (kjo do të thotë se është një punë shumë serioze) mund të justifikohet vetëm atëherë kur është e ligjshme dhe e drejtë.

Arrestimi veçanërisht peshon drejt:

- Përdorimin e forcës në mënyrë proporcionale gjatë arrestimit ndaj personit të dyshuar, nëse është e nevojshme. Jo çdo herë është e nevojshme përdorimi i forcës fizike gjatë arrestimit. Personi i arrestuar nuk kërkohet të jetë i nënshtruar, ti vendosen prangat ose të shtrihet përtokë. Përdorimi i forcës fizike mundë të hyjë në punë atëherë kur personi që duhet të arrestohet kërcënon me të njëjtën mënyrë, rrezikon me kërcënime atëherë mund të përdoret forca fizike por në mënyrë proporcionale ndaj personit që duhet të

¹¹⁹Rekomandime nr.R(87)15.Këshilli Evropian për rregullimin dhe përdorimin e të dhënave personale në sektorin e policies (1987).

¹²⁰Rekomandimi nr.Rec (2005)10 i Këshillit Evropian.Mbi teknikat e veçanta investigative, në lidhje më të rëndë me krimet dhe terrorizmin.

¹²¹ Neni 3.4.9.14.16.41.69 i Ligjit për mbrojtjen shëndetsore (Gazeta Zyrtare e RM-së.Nr-43/2012.145/2012.87/2013.164/2013.39/2014.43/2014.132/2014.188/2014.10/2015.61/2015.154/2015.192/2015.17/2016.37/2016

arrestohet ose nëse është e nevojshme edhe ndaj personave të tjerë që pengojnë arrestimin.

- Veprimet diskriminuese zbatimi i ligjit, siguria publike dhe mbrojtja e të Drejtave të Njeriut duhet të kryhen në mënyrë të drejtë dhe të barabartë për të gjithë personat. Duke injoruar sjelljen e paligjshme nga një komunitet i caktuar, arrestimi i personit për të njëjtën sjellje nga një komunitet tjetër është diskriminim. Policia patjetër duhet që të veprojë dhe të shihet duke vepruar me paanësi në të gjitha grupet.¹²²
- Privimi i lirisë (arrestimi) me dyshime të pabaza dhe jo të arsyeshme. Arrestimi mund të bëhet vetëm atëherë kur ekzistojnë baza të arsyeshme, dyshimi në lidhje me kryerjen e ndonjë Vepre Penale. D.m.th. që patjetër të ekzistojnë fakte ose informacione që personi mund të ketë kryer ndonjë shkelje të ligjit për të justifikuar arrestimin e tij/saj dhe këto fakte ose informacione patjetër duhet ta përmbushin vëzhgimin objektiv që ti plotësojnë kushtet për arrestimin e tyre.

Autorizimet për privim nga liria (arrestimet):

Privimi nga liria me urdhër të gjykatës (Neni 177. Paragrafi 1). Oficerët policorë duhet që të kenë urdhër nga gjykata para se ta kryejnë arrestimin. Kushtetuta e RM-së siguron një përparësi të madhe në urdhrin e gjykatës për arrestim.¹²³ Është e qartë se disa vite më parë ajo u krye nga ana e policisë, po shumë vende të Botës e kanë parë këtë transformim të pikëpamjeve si shumë të rëndësishëm për zbatimin e ligjit aktual. Askujt nuk mund ti kufizohet liria, përveçse me anë të një vendimi gjyqësorë në raste dhe në një procedurë të përcaktuar me ligj dhe urdhri i gjykatës konsiderohet si një nga masat më të rëndësishme mbrojtëse. Sot është puna kryesore e gjykatës të kryejë një vlerësim të paanshëm të fakteve që tregojnë se dikush ka shkelur ligjin. Arrestimet bëhen me qëllim që ta sjellin personin para pushtetit gjyqësorë, është në fakt arrestimi me urdhër të gjykatës.¹²⁴ Arrestimi pa urdhër të gjykatës me iniciativë të policisë , megjithatë për shkak të disa keqkuptimeve, rregullat e policisë krijojnë konfuzion të mëtejshëm

¹²² Neni 4 i Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut dhe Neni 137 i Kodit Penal të Republikës së Maqedonisë <http://www.healthrights.mk/>

¹²³ Neni 12 i Kushtetutës së Republikës së Maqedonisë

¹²⁴ Neni 177. Paragrafi 1 i Kodit të Procedurës Penale.

si shtim të kompetencave të kapjes me urdhër të gjykatës¹²⁵ dhe arrestimi pa urdhër të gjykatës.¹²⁶

Shënimet që i referohemi në këtë seksion (Neni 177 të Kodit për Procedurë Penale) thotë:

“1. Një urdhër për të sjellë të pandehurin në gjykatë mund të lëshohet nëse është lëshuar një vendim për paraburgim ose nëse një i pandehur i thirrur në mënyrë të rregullt nuk vjen dhe ai/ajo nuk e justifikon mungesën ose nëse nuk është e mundur ta kryej paraqitjen e rregullt të ftesës dhe nga rrethanat është e qartë se i pandehuri shmangë pranimin e ftesës.

2. Urdhrin për sjelljen me intervenim të policisë e jep Ministria për Punë të Brendshme.

3. Urdhri për sjelljen me intervenim të policisë lëshohet me shkrim (në mënyrë të shkruar).

Urdhri duhet të përmbajë:

- Emrin dhe Mbiemrin e pandehurit që duhet të sillet.
- Emrin e veprës Penale që është ngarkuar ky i fundit duke theksuar dispozitat e Kodit Penal.
- Arsytet për urdhërimin.
- Vulën zyrtare.
- Firma e gjyqtarit i cili e urdhëron dorëzimin”
- Personi i autorizuar për dhënien e urdhrit tek i akuzuari me urdhër e fton atë që të shkojë me personin e autorizuar. Nëse i pandehuri e refuzon këtë, ai do ta sjellë atë me përdorimin e forcës si dhe përdorimin e mekanizmave të tjera.

E Drejta për Lirinë dhe sigurinë e personit:

Neni 5 i Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut i referohet mbrojtjes së lirisë fizike dhe në veçanti në mënyrë arbitrare heqjen e lirisë (arrestimit) dhe paraburgimit.¹²⁷

Dokumenti i OKB-së “UNHCR Trupi i parimeve për mbrojtjen e të gjithë personave që janë nën çfarëdo forme të paraburgimit ose burgimit”

- Të gjithë Njerëzit të privuar nga Liria kanë të drejtën e Njeriut dhe respektin për dinjitetin e natyrshëm të njeriut (Parimi 1).
- Arrestimi, ndalimi ose paraburgimi duhet të kryhen në baza ligjore si dhe nga zyrtarë kompetent (Parimi 2).

¹²⁵Neni 19 dhe 21 i cili është përmisuar me Nenin 177 të Kodit të Procedurës Penale. Ligji i rregullores për kryerjen e detyrave të MPB-së

¹²⁶Neni 188 dhe 44 i Kodit të Procedurës Penale. Ligji i rregullores për kryerjen e detyrave të MPB-së

¹²⁷Neni 5 i Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut.

- Arrestimi, ndalimi ose paraburgimi do të kryhen në mënyrë të drejtë dhe ferr, dhe nuk do të jenë në ndonjë shkallë diskriminimi (Parimi 5).
- Asnjë person në çfarëdo lloj privimi nga liria nuk duhet që ti nënshtrohet torturës, dënimit mizor, çnjerëzor ose poshtërues (Parimi 6).
- Çdo person që do të arrestohet, në kohën kur do të bëhet arrestimi do të informohet menjëherë për shkakun e arrestimit dhe për akuzat kundër tij (Parimi 10).
- I paraburgosuri nuk do të mbahet në paraburgim pa u dhënë një mundësi efektive për tu dëgjuar nga një gjykatës ose autoritetet tjera. I burgosuri do të ketë të drejtë të mbrohet vetë ose me ndihmë nga njëkëshilltarë siç është përcaktuar me ligj (Parimi 11)
- Secili person në momentin e arrestimit si dhe të paraburgimit do ti jepet informacioni i menjëhershëm si dhe shpjegimi lidhur me të drejtat e tij nga autoritetet përgjegjëse për arrestimin ose paraburgimin e tij (Parimi 13).
- Pas çdo arrestimi dhe pas çdo transferimit nga një vend në tjetrin, i paraburgosuri ka të drejtë ti njoftojë autoritetet përkatëse si dhe anëtarët e familjes së tij për arrestimin, ndalimin dhe vendin ku mbahet (Parimi 16).¹²⁸

Torturimi dhe sjellja poshtëruese: Për shkak të faktit se arrestimi dhe paraburgimi janë fushat të cilat tentojnë ti keqpërdorin të Drejtat e Njeriut, keqtrajtimi i atyre që janë arrestuar ose ndaluar mund të kenë disa forma. Mund të jenë psikologjike, fizike ose të marra në formën e abuzimit verbal ose keqtrajtimit. Disa forma të rënda të maltretimit nga policia kundër të burgosurve dhe të paraburgosurve mund të konsiderohen si torturë.

Tortura është: "Çdo veprim me të cilin një personit i është shkaktuar me qëllim dhimbje ose vuajtje të rëndë, fizike ose mendore për qëllime të tilla si marrja nga ai ose nga personi i tretë informacione ose njohuri të një akti që ai ose një person i tretë ka kryerose është me dyshimin e kryerjes së tij. Kërcënimi ose detyrimi i tij apo ndonjë personi tjetër të tretë ose ndonjë arsye tjetër që bazohet në diskriminim të çfarëdo lloj, kur kjo dhimbje ose vuajtje është shkaktuar, nxitet ose bëhet me miratimin ose pranimin e një zyrtari publik ose ndonjë lloj tjetër, një person që vepron zyrtarisht"¹²⁹

¹²⁸Dokumenti I OKB-së "UNHCR Trupi I parimeve për mbrojtjen e të gjithë personave që janë nën çfardo forme të paraburgimit ose burgimit"

¹²⁹Kodi i sjelljes së OKB-së për zyrtarët e zbatimit të Ligjit.1979.

Disa veprime që një nëpunësi policorë nuk duhet t'i ndërmerr:

- Sjellja e keqe gjatë marrjes në pyetje ose dëgjim.
- Çfarëdo lloj sjellje jonjerëzore.
- Shfrytëzimin e mjeteve të forta teknike për rrahje dhe kërcënime ndaj të dyshuarit.
- Duke i detyruar të dyshuarit të qëndrojnë për orë të tëra në një pozitë stresuese.
- Duke i ekspozuar të dëmtuarit.
- Duke mos i lejuar të arrestuarit që të flejnë.
- Duke mos i lejuar shfrytëzimin e hapësirave sanitare.
- Duke mos ju dhënë ushqim dhe uji.
- Duke i marrë në pyetje në kohë të gjatë.
- Në dimër duke i lënë në dhoma të ftohura etj.

3.5 E DREJTA PËR GJYKIM TË DREJTË

Çdo shtet ka një organ për ti sjellë para drejtësisë të gjithë personat përgjegjës për krimet. Megjithatë do të shpjegojmë se pse drejtësia nuk është e kënaqur kur njerëzit i nënshtrohen një gjykimi jo të drejtë. E drejta për një gjykim të drejtë është gjithashtu një e drejtë e prezumimit të pafajësisë, dhe kjo ka implikime të rëndësishme për punën e policisë. Ky shpjegim shqyrton Standardet Ndërkombëtare dhe vendore lidhur me të drejtën për një gjykim të drejtë, të drejtat themelore të personit të akuzuar dhe cilat veprime (kundërveprime) nga policia përcaktojnë shkelje të kësaj të drejte.

E drejta për gjykim të drejtë bazohet në parimin që njerëzit e akuzuar për një krim janë të pafajshëm deri sa të dëshmohet pranimi i fajësisë dhe se rëndësia e provave do të përcaktojë nëse ai individ është fajtorë ose jo.

Konsiderohet si një nga të drejtat më të rëndësishme të Njeriut. E drejta për një gjykim të drejtë si në procedurën civile ashtu edhe në atë penale,¹³⁰ koncepti i një procesi gjyqësorë të drejtë, përmban shumë elemente, në thelb ka të bëjë “Me të drejtën për një seancë të drejtë fer dhe publike brenda një kohe të arsyeshme nga një gjykatë e pavarur dhe e paanshme e përcaktuar me ligj”.

¹³⁰Neni 6 i Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut. Neni 14 i marveshjes Ndërkombëtare për të Drejtat Civile dhe politike.

Abuzimi i nënshtrohet shqyrtimit nga Komisionet dhe gjykatat Ndërkombëtare të Komiteteve ligjore (Komisione dhe gjykata). Supozimi i pafajësisë shërben si një vazhdim i së drejtës siç është përmendur më parë, të gjithë Njerëzit nën hetim duhet të trajtohen si të pafajshëm, qoftë të privuar nga Liria ose të mbahen në burg ose të ishin në Liri gjatë hetimit. Supozimi i pafajësisë mund të gjendet edhe në Deklaratën Universale të të drejtave të Njeriut.¹³¹ *Parimet kryesore janë:*

- Fajësia dhe pafajësia mund të përcaktohen **vetëm nga këshilli i duhur**, i shoqëruar nga një gjykim i kryer në mënyrë të duhur në të cilën i pandehuri ka të gjithë garancitë dikush është fajtorë, para vendimit përfundimtarë të gjykatës. E nevojshme për mbrojtjen e tij. Policia **nuk mundet** të përcaktojë fajësinë ose pafajësinë.
- Detyrimi për të vërtetuar (Faktet) do të ballafaqohen nga Prokuroria.
- Fajësia duhet të provohet përtej dyshimit të arsyeshëm themelorë.
- Policia mund të bëjë njoftimin publik që i dyshuari është në kërkim në lidhje me disa aktivitete kriminale, ose disa Njerëz janë të burgosur me faj, por megjithatë supozimi i pafajësisë ndalon deklaratat formale se dikush është fajtorë para vendimit përfundimtarë të gjykatës.

Të drejtat themelore të të akuzuarit janë:

- Të jenë të informuar menjëherë, në gjuhën që ai/ajo e kupton, mbi natyrën dhe shkakun e akuzës.
- Të ketë kohë të përshtatshme për përgatitjen e mbrojtjes.
- Ta mbrojë vet veten e tij ose përmes ndihmës juridike.
- Të thirrë dëshmitar.
- Të ketë ndihmë nga përkthyes aty ku do të jetë e nevojshme.¹³²

I pandehuri ka të drejta shtesë për të siguruar një gjykim të drejtë dhe ndihmë kur administrata gjyqësore e drejtësisë vihet në dyshim:

- Kompensimi për një gjykim të gabuar.
- Liria nga legjislacioni penal retroaktiv.
- E Drejta e apelit për punët penale.

¹³¹ Neni 11 i Deklaratës Universale të të Drejtave të Njeriut. Neni 1 i Kodit Penal të Republikës së Maqedonisë

¹³² Neni 6. Paragrafi 3 i Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut. Neni 14 i marrëveshjes Ndërkombëtare për të Drejtat Civile dhe politike.

- Të Drejtën për tu gjykuar dhe dënuar dy herë për të njëjtën vepër penale.¹³³

Rreziku i shkeljes së të Drejtave të Njeriut fillon që nga momenti kur nëpunësi policor shpreh dyshime për një person përmes heqës së Lirisë, paraburgimit, gjatë gjykimit, gjatë gjithë dënimit, deri në shqiptimin e ndonjë dënimi tjetër.”Standardet Ndërkombëtare për të përcaktuar dhe mbrojtur të Drejtat e Njeriut në të gjitha fazat”¹³⁴

3.6 PARIMI I MOS DISKRIMINIMIT NË PUNËT POLICORE

Instrumentet Ndërkombëtare të të Drejtave të Njeriut, theksojnë se qëniet njerëzore lindin të lirë dhe për këtë arsye kanë mbrojtje të barabartë të Dinjitetit dhe të Drejtave. Sipas këtij parimi bazë të punës së policisë demokratike është për të treguar dhe forcuar bazat e mosdiskriminimit të cilat janë themelore për mbrojtjen dhe promovimin e të Drejtave dhe Lirive të Njeriut.¹³⁵

Konventa Evropiane si dhe Kushtetuta e Maqedonisëhpallin mbrojtjen kundër diskriminimit në bazë të *“Gjinisë, racës, ngjyrës së lëkurës, gjuhës, fesë, politikës, prejardhjes Kombëtare ose sociale, pakicës Kombëtare, pasurisë ose cilitdo status tjetër”*.¹³⁶

Ky parim është forcuar gjithashtu në Nenin 137 të Ligjit Penal të Maqedonisë se *“Një person i autorizuar i cili do të privojë ose do të kufizojë të Drejtën e Njeriut dhe të qytetarit ose në bazë të ndonjë prej dallimeve në mes të Njerëzve u jep qytetarëve përfitimi që janë në kundërshtim me Kushtetutën, Ligjin ose Traktatet Ndërkombëtare të ratifikuara do të ndiqet penalisht dhe do të dënohet me burgim”*¹³⁷

Tre parimet themelore të mosdiskriminimit:

1. Barazinë e të Drejtave.
2. Paanshmëria e të Drejtave.
3. Universaliteti i të Drejtave.

Diskriminimi dhe grupet që kanë nevojë për trajtim të veçantë mbrojtjeje:

¹³³ Neni 7i Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut.Neni 4.Protokolli nr.7 i Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut.

¹³⁴ Botimi online I manualit Ndërkombëtar të Amnesty Internacional 1998 për të Drejtën e gjykimit të drejtë.

¹³⁵ Neni 3.5.6 dhe 7 të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut.Instrumentet Ndërkombëtare të të Drejtave të Njeriut.

¹³⁶ Konventa Evropiane dhe Kushtetuta e Republikës së Maqedonisë

¹³⁷ Neni 137 i Ligjit Penal të Maqedonisë

Të miturit kanë nevojë për mbrojtje të veçantë të mbrojtjes ligjore, në mënyrë që të sigurohet se ato nuk janë përdorur nga viktimat. Pasi që të Drejtat e Njeriut janë Universale çdo i mitur ka të njëjtat të drejta për të gjitha të Drejtat e Njeriut. Të miturit mbrohen gjithashtu nga dokumentet që marrin parasysh statusin e tyre të veçantë dhe nevojat siç janë:

- Si mjet për të garantuar mbrojtjen e të miturve, Instrumentet ndërkombëtare për të Drejtat e të miturve¹³⁸ janë fokusuar në mënyra të shumta për të siguruar dhe mbrojtur sigurinë shoqërore të të miturve sa herë që lind konflikti me Ligjin. Këto masa kanë për qëllim zhvillimin e mjeteve të mbrojtjes me qëllim parandalimin e delikuencës së të miturve dhe izolimin e të miturve nga abuzimi, shtypja dhe shfrytëzimi gjatë qëndrimit të tyre në institucionet korrektuese ndëshkuese.

- Kështu që OKB-ja hartoj rregullat minimale për aplikimin e drejtësisë së të miturve¹³⁹ dhe parimet për mbrojtjen nga delikuenca e të miturve (Rregullat e Pekinit)¹⁴⁰. Të miturit përfitojnë nga të gjitha kufijtë e të Drejtave të Njeriut në dispozicion për të rritur.

Si shtesë do të zbatohen të Drejtat e mëposhtme:

- Të miturit duhet të trajtohen në një mënyrë që nxit ndjenjat e tyre të dinjitetit dhe vlerës që lehtëson reintegrimin e tyre dhe merr parasysh nevojat e një personi të asaj moshe.
- Të miturit nuk duhet të nënshtrohen torturës, trajtimit ose dënimit mizor, jonjerëzor ose degradues, dënimit fizik ose burg të përjetshëm pa mundësinë e lirimit.
- Ndalimi ose burgimi i të miturve do të jetë një masë ekstreme që do të përdoret dhe do të jetë sa më e shkurtër që të jetë e mundur.
- Të miturit duhet të ndahen nga të burgosurit e rritur.
- Të miturve të burgosur duhet t'u lejohen vizitat dhe të korrespondojnë me anëtarët e familjeve të tyre.
- Duhet të caktohet një sasi e fajësimit minimal e përgjegjësisë penale.
- Duhet të sigurohen procedurat gjyqësore dhe alternativat për kujdesin institucional.
- Privatësia e të miturve do të mbahet dhe do të ruhet e fshehtë.
- Përdorimi i kufizimeve fizike dhe forcës ndaj të miturve do të jetë e jashtëzakonshme

¹³⁸ Instrumentet Ndërkombëtare për të miturit.

¹³⁹ Rregullat minimale të OKB-së për aplikimin e drejtësisë së të miturve

¹⁴⁰ Rregullat e Pekinit. Parimet për mbrojtjen nga delikuenca e të miturve.

- dhe do të zbatohen vetëm kur masat e kontrollit nuk kanë arritur të japin sukses dhe që sa më shpejtë të jetë e mundur.
- Prindërit duhet të informohen për: Burgim, paraburgim, transferim, sëmundje, lëndime dhe vdekje.

Gratë kanë arritur në ballë të zbatimit të Ligjit dhe të Drejtave të Njeriut në një shkallë më të madhe, sigurimi i rolit të tyre efektiv dhe jodiskriminues si dhe roli i policisë është një nga mënyrat kryesore për të ofruar garanci kundër trajtimit diskriminues dhe të papërshtatshëm. Me këtë progres shumë nga shqetësimet rreth të Drejtave të Njeriut dhe trajtimit të grave që janë në konflikt me Ligjin, veçanërisht gjatë hetimit, ndalimit ose arrestimit mund të bie ndesh me rregullat dhe me Ligjet e RM-së dhe të Drejtave të Njeriut.¹⁴¹

Diskriminimi në punët policore, të ekspozuar ndaj shkeljeve të të Drejtave të Njeriut: Një shoqëri multikulturore ka nevojë për një forcë policore që mund të përshtatet me nevojat e një popullsie që është e ndryshme dhe që ndryshon. Qëllimi i mosdiskriminimit dhe jo paragjykimi në punën e policisë është që të ofrojë shërbime që janë të zbatueshme dhe të aksesueshme për të gjithë qytetarët. Policia duhet të veprojë dhe të shihet duke vepruar me drejtësi ndaj të gjitha grupeve, të mos jetë aspak tolerante ndaj racizmit, kërcënimeve të ndryshme ose çfarëdo veprimi tjetër që kërcënon dinjitetin e bashkësive ose grupeve të caktuara në Maqedoni. Policia duhet të veprojë me respekt për dallimet dhe sensibilitetin etnik dhe kulturorë. Përbërja e policisë duhet të përfaqësojë komunitetin që ata i shërbejnë.¹⁴² Gëzimi i të Drejtave dhe Lirive të përcaktuara në Konventë duhet të sigurohet pa ndonjë diskriminim të bazuar në gjini, racë, ngjyrë, gjuhë, religjion, mendim politik ose ndonjë opinion tjetër, origjinë kombëtare ose sociale që i përkasin pakicës Kombëtare, statusi material, origjina pas lindjes ose ndonjë status tjetër.¹⁴³ Personi i zyrtarë i autorizuar në bazë të gjinisë, racës, ngjyrës, origjinës Kombëtare dhe sociale, besimit politik dhe fetarë, pasurisë dhe shoqërive, pozitës, gjuhës, statusit dhe rrethanave të tjera personale do të privohet ose do të kufizohet në të Drejtat e personit dhe shtetasit, i përcaktuar me Kushtetutë dhe me Ligj ose me marrëveshje Ndërkombëtare të ratifikuara, ose që në bazë të këtyre dallimeve u japin qytetarëve privilegj në kundërshtim me

¹⁴¹Ligjet e RM-së dhe të Drejtat e Njeriut.

¹⁴²Neni 14 Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut. Për mbrojtjen nga diskriminimi.

¹⁴³Neni 137 i Kodit Penal të RM-së

Kushtetutën, Ligjin ose me marrëveshje Ndërkombëtare të ratifikuar, do të dënohen me burgim prej 6 muajve deri në 5 vite.¹⁴⁴

Policia si institucion përballet me një numër të madh të llojit të diskriminimit dhe paragjykimet në vetë organizimin dhe gjatë aktiviteteve të përditshme të policisë.

Çka është Diskriminimi:

Të diskriminosh do të thotë të veçosh ose të dallosh, në punën e policisë diskriminimi mund të shprehet në mënyrë të brendshme ose të jashtme. Kjo mund të ketë ndikim në sjelljen e policisë sa i përket opsioneve ose kulturës së përgjithshme të policisë.

Paragjykimi dhe diskriminimi janë çështje veçanërisht të rëndësishme për punën e policisë. Si zyrtarë të fuqishëm qeveritarë, policia mund të veprojë në emrin e tyre. Sjellja diskriminuese e disa punonjësve të policisë mund të rrezikoj reputacionin e të gjithë departamentit.

Çfarë lloje të diskriminimit mund të paraqiten në kohën e aktivitetit policorë:

- Stacionet policore të krijuara për të ndjekur disa komunitete.
- Ndalimi dhe kontrollimi i automjeteve për dyshim.
- Refuzimin e lëshimit të dokumenteve civile siç është letërnjoftimi dhe shtetësia për disa Njerëz nga disa komunitete etj.

3.7 EFIKASITETI I MBROJTJES SË TË DREJTAVE TË NJERIUT ME RASTIN E TEJKALIMIT TË AUTORIZIMEVE POLICORE

Hetimet e policisë duhet të bazohen në dyshimin e justifikimit ose veprave penale të mundshme. Për të filluar një hetim policorë duhet që të vlerësohet informacioni publik, dhe pastaj të vazhdohet më tej të veprohet pa paragjykime në mënyrë efektive.¹⁴⁵ Në punën e tyre hetuese nëpunësit policorë duhet ti përmbahen sundimit të prezumimit të pafajësisë deri sa i dyshuari të shpallet fajtorë nga gjykata si dhe ti përmbahen sundimit të duhur në procesin e hetimit.¹⁴⁶ Intervista (biseda me dëshmitarët, viktimat dhe të dyshuarit) nga ana e policisë duhet të kryhet në një gjuhë që kuptohet nga i intervistuari. Para bisedës nëpunësi policorë duhet të identifikohen dhe ti paraqesin personat e pranishëm gjatë intervistës, policia patjetër duhet që ta informojë të intervistuarin për arsyet e intervistës së tij, për të drejtat e tij dhe për

¹⁴⁴ OSCE Spillover Monitor Mission Skopj, Leksioni i 7 Jodiskriminimi i punëve policore, reforma për policinë, revizioni i fundit 19.09.2002

¹⁴⁵ Këshilli i Evropës, Deklarata e policies 1979

¹⁴⁶ Neni 11 Deklarata e përgjithsme e të Drejtave të Njeriut. Neni 14 I Konventës Ndërkombëtare për të Drejtat Civile dhe politike.

procedurat që do të zbatohen për hetimin. Të intervistuarit patjetër duhet që të informohen për të drejtën për të kontaktuar avokatin gjatë intervistës, kjo është e paraparë edhe me Ligj.¹⁴⁷ Nëpunësi policorë duhet ti informojë të intervistuarit rreth mundësive të marrjes së ndihmës, marrjen e këshillave praktike dhe ligjore, (nëse ka ose është e nevojshme) për kompensimin nga kryerësi i krimit ose kompensimin nga kryerësi i krimit ose kompensimin nga shteti, si dhe duhet të marrë informacion në lidhje me ndërmarrjen e vendimeve për rastin e tij/saj si dhe rezultatin e hetimit të policisë. Në raport policia duhet që të ketë sa më shumë informacione si dhe të jenë të qarta dhe më të plota në lidhje me të intervistuarin në hetim. Përveç kësaj të dyshuarit duhet të informohen për çdo akuzë kundër tyre.¹⁴⁸ Duhet të mbahet një evidencë për kohën prej kur fillon deri kur mbaron intervista, për secilin nga personat e pranishëm në intervistë. Për më tepër hetimet e policisë duhet të jenë **“Të kujdesshme dhe të përshtatura për personat me nevoja të veçanta”**. Fëmijët, gratë, të miturit, duke përfshirë pakicat etnike, sidomos gjinia femërore ka nevojë për mbështetje të paanshme dhe mbështetje urgjente në rastet e dhunës në familje, krimi, trafikimi i qenieve Njerëzore dhe abuzimi seksual. Mjetet e reja teknologjike lejojnë shkelje më të madhe të privatësisë të qytetarëve (si dhe përdorimi i mashtrimit) dhe mund të dëmtojë jo vetëm privatësinë dhe Lirinë e shprehjes, por edhe besimin e publikut tek autoritetet kompetente. Në mënyrë që të mbajnë një ekuilibër të drejtë në mes të ruajtjes së sigurisë publike përmes marrjes së masave të autorizuara dhe mbrojtjen e të Drejtave të personave.

Patjetër duhet të zhvillohet një kornizë ligjore për kryerjen e hetimeve sekrete, menaxhimi i kësaj praktike mbulon mekanizmin e kontrollit të brendshëm (mbikëqyrje, udhëzime, procedura për autorizime, buxheti, menaxhimi i punës, shqyrtimi i rezultateve etj). Poashtu mekanizmat e jashtme të mbikëqyrjes (kontrolli i gjykatës, parlamentet demokratike, kontroll nga oficerët e mbrojtjes së të dhënave). Gjithashtu është e nevojshme një kontroll e rreptë nga ana e oficerëve për rruajtjen e të dhënave që të sigurohen (mbledhja, ruajtja dhe përdorimi) i të dhënave personale nga policia dhe të kryhen në përputhje me parimet Ndërkombëtare për mbrojtjen e të dhënave, ndërsa veçanërisht do të jetë e kufizuar deri me atë masë për të arritur legjitimitetin, qëllimet legjitime dhe specifike.

Vëmendje të veçantë duhet ti kushtohet rregullave të shkëmbimit të informacioneve

¹⁴⁷Neni 1-4.Rekomandim I Këshillit Evropian Nr.(85)11 për statusin e viktimave sipas Ligjit Penal dhe procedures.

¹⁴⁸Neni 50.53.55.57 I Kodit Evropian të Etikës së policisë.

ndërmjet policisë dhe elementeve të tjera të sistemit të drejtësisë penale, si dhe për shkëmbimin në nivel Ndërkombëtarë.

Mbështetja për viktimat dhe dëshmitarët e krimeve:

Policia duhet që tu sigurojë atyre mbështetjen e nevojshme viktimave të krimit pa diskriminuar dhe me dhembshuri dhe respekt për dinjitetin e tyre. Ata kanë nevojë për gjithçka, të kujdesen për shëndetin dhe sigurinë e tyre në një mënyrë konstruktive dhe bindëse.¹⁴⁹ Oficerët e policisë duhet që ti informojnë viktimat rreth mundësive të marrjes së ndihmave, marrjen e këshillave praktike dhe Ligjore, për kompensim nga kryerësi i krimit ose kompensim nga shteti.

Viktima duhet të jetë në gjendje të mirë që të marrë informacion në lidhje me ndërmarrjen e vendimit për rastin e tij/sajë dhe rezultatet e hetimit të policisë.

Në çdo raport të dorëzuar në prokurori, policia duhet të ketë sa më shumë materiale të deklaruar, sa ma të qarta dhe më të plota rreth lëndimeve dhe humbje të viktimave.¹⁵⁰

Që të mbrohen dëshmitarët e krimeve nga kërcënimet ose hakmarrjet duhet që të vendosen masat e duhura ligjore dhe programet specifike për mbrojtjen e tyre. Qëllimi kryesor i këtyre programeve duhet të jetë mbrojtja e jetës dhe sigurisë personale, të prindërve të tij si dhe familjen më të afërt me të. Programet për mbrojtjen e dëshmitarëve duhet të ofrojnë metoda të ndryshme mbrojtjeje të cilat mund të përfshinë: Ndryshimin e identitetit të dëshmitarëve , të afërmve të tyre, si dhe njerëzit e tjerë pran tyre, ti ndihmojnë për rigjetjen e një pune të resi dhe siguri me truporje dhe lloje të tjera të mbrojtjes fizike.¹⁵¹ Për më tepër çdo veprim i frikësimit të dëshmitarëve duhet të jetë **“I DËNUESHËM”** si një vepër e veçantë Penale ose si pjesë e veprës Penale **“PËRDORIM I KËRCËNIMIT TË PALIGJSHËM”**.¹⁵²

Oficerët e policisë patjetër duhet që të kenë një trajnim adekuat për tu marrë me rastet në të cilët dëshmitarët mund të frikësoheshin.¹⁵³

¹⁴⁹ Neni A.4 dhe A.6 i Deklaratës mbi Parimet themelore të Drejtësisë për viktimat e krimit dhe abuzimit.

Neni 1-4.Rekomandim I Këshillit Evropian Nr.(85)11 për statusin e viktimave në kuadër të Ligjit.

Amnesty Internacional 10 standardet themelore për të Drejtat e Njeriut për zyrtarët.

Këshilli Evropian kodi Evropian I Etikës policore.Këshilli Evropian,ndima për viktimat e krimit

¹⁵⁰Neni 1-4.Rekomandim I Këshillit Evropian Nr.(85)11 për statusin e viktimave në kuadër të Ligjit Penal dhe Procedural.

¹⁵¹Neni 14.15.51.Rekomandimi nr.R (97)13.Lidhur me kërcënimet e dëshmitarëve dhe të drejtën e mbrojtjes.

Neni 1.2 dhe 8.28.Rekomandimi nr.REC (2005) 9,mbi mbrojtjen e dëshmitarëve dhe bashkëpunorëve në procesin gjyqsorë.

¹⁵² Neni 3.Rekomandimi nr.REC(2005)9mbi mbrojtjen e dëshmitarëve dhe bashkëpunorëve në procesin gjyqsor.

¹⁵³Neni 7 (1997).Rekomandimi nr.R (97)13.Lidhur me kërcënimet e dëshmitarëve dhe të drejtën e mbrojtjes.

Në rast se Ligji shkelet, policia është e detyruar ta ndihmojë gjyqësorin për ti sjellë autorët para drejtësisë. Duke vepruar kështu ata duhet të respektojnë të Drejtat Themelore Njerëzore dhe Civile dhe u mundësojnë atyre kujdesi adekuate të paraburgimit.¹⁵⁴ Privimi i Lirisë duhet të jetë aq i kufizuar dhe i zbatueshëm duke marrë parasysh dinjitetin, dobësinë dhe nevojat personale të çdo personi të ndaluar.¹⁵⁵

Në një far mase dhe në përputhje me ligjin vendas, policia duhet që ti informojë personat e privuar nga liria në kohën e duhur, në gjuhën që kuptojnë, për shkaqet e heqjes nga liria dhe çdo akuzë kundër tyre. Gjithashtu policia duhet të jetë në kohë para se të përfundojë marrja në pyetje, personat ti informojë për të drejtat e tyre dhe procedurat të cilat do të merren në rastin e tyre.¹⁵⁶

Personat e privuar nga liria nga ana e policisë kanë të drejtë për privimin nga liria e tyre, që të informojnë palën tretë me zgjedhjen e tyre, kanë të drejtë në zgjedhjen e ndihmës juridike si dhe ndihmën mjekësore nga ana e mjekut, kur ajo është e mundshme.¹⁵⁷ Prindërit ose kujdestarët patjetër duhet që të informohen për të burgosurit e mitur dhe rastin e tyre.¹⁵⁸ Duhet të ekzistojnë rregulla dhe udhëzime të qarta se si të kryhen bisedat policore (intervistat) ndër të tjera gjatë intervistës duhet të mbahet llogari dhe të merren parasysh çështjet e mëposhtme:

- Informimi i të burgosurve në lidhje me identitetin (emri, mbiemri dhe numri) i personave gjatë intervistimit.
- Për kohëzgjatjen e lejuar të bisedës.
- Periudha e pushimit në mes të marrjes në pyetje.
- Intervistimin e personave nën ndikimin e alkoolit dhe drogës.

Gjithashtu është e domosdoshme të mbahet një regjistër sistematik për shënimin e kohës kur fillon dhe kur mbaron intervista, për çdo gjë që kërkon personi gjatë intervistës dhe për njerëzit

¹⁵⁴ Neni 3.5.7 dhe 9 i Deklaratës Univerzale për të Drejtat e Njeriut.

Amnesty Internacional 10 standardet themelore për të Drejtat e Njeriut për zyrtarët nr 10 standardi 8
Brus Nil Policia që ne duam nr 10 faqe 40.

¹⁵⁵ Neni 23 Dokumeni i Moskës. Neni 50.54 i Këshillit Evropian kodi Evropian i etikës policore.

¹⁵⁶ Neni 23. Shënimi 61 I Dokumentit të Moskës. Neni 55. Shënimk 5 I Këshillit të Evropës kodi etikës policore. Neni 6.7. Shënimi 5 Amnesty Internacional 10 standardet themelore për të Drejtat e Njeriut për zyrtarët.

¹⁵⁷ Neni 10.57. Shënimi 5 i Këshillit Evropian kodi Evropian i etikës policore. Neni 12. Shënimi 32 i Komitetit Hungarez, rekomandimet nga Budapesti.

¹⁵⁸ Neni 23. Shënimi 74 Komiteti I Kryqit tkuq për të Drejtat e Njeriut dhe të Drejtat humanitare, koncepti I policis profesionale.

e pranishëm gjatë çdo bisede.¹⁵⁹ Personat e privuar nga Liria nuk janë të detyruar të mbrojnë veten, ti përgjigjen pyetjeve, ta inkriminojnë veten dhe të afërmit e tyre ose të pranojnë se janë fajtorë. Marrja e ndonjë deklarate tjetër ose marrja e deklaratës me forcë, torturë ose me kërcënim se do të përdoren të gjitha metodat ose me ndihmën e drogës patjetër duhet që të ndalohen dhe të dënohen me Ligj këto akte.¹⁶⁰

Sipas Komitetit Evropian për parandalimin e torturës dhe trajtimit çnjerëzor ose poshtërues. Trajtimi ose dënimi, praktika e mbylljes së syve të paraburgosurve veçanërisht para marrjes në pyetje **“As pa menduar duhet që të dënohet”**.¹⁶¹ Marrja në pyetje e personave të dyshuar është një detyrë profesionale që kërkon trajtim të veçantë dhe se mund të kryhet në mënyrë të qetë pa përdorur asnjë nga metodat e dhunshme dhe jo të lejuara nga ligjet vendëse dhe ato të jashtme.¹⁶²

Duke përfshirë dokumentimin e arsyeve, datën, kohën e hyrjes dhe duke i lëshuar hapësirat e paraburgimit, informacione të sakta për vendin e mbrojtjes, identitetin e zyrtarëve të involvuar, përshkrimi i lëndëve në pronësinë e tij.¹⁶³ Përshkrimi dhe të dhënat për mbrojtje duhet që ti dorëzohen të mbajturit ose të burgosurit ose avokatit të tyre.¹⁶⁴

Të mbajturit duhet të monitorohen me kujdes, veçanërisht nëse nuk janë nënshtruar procesit të pranimi dhe kontrollit mjekësorë. Policia duhet të kujdeset për mbrojtjen, shëndetin, higjienën dhe ushqimin gjatë ndalimit të tyre. Qelitë e policisë duhet të jenë me madhësi të mjaftueshme, të kenë ndriçim të përhershëm dhe ventilim të ajrit si dhe të ketë inventarë për të pushuar dhe kushte për elementet kryesore për jetesë.¹⁶⁵ Nëse është e mundur policia duhet ti ndajë personat e privuar nga liria, nën dyshimin se kanë kryer krim ndaj personave të tjerë të privuar nga liria në baza tjera.

Zakonisht meshkujt ndahen nga gratë, të rriturit nga të miturit përveç nëse janë nga e njëjta familje.¹⁶⁶ Personat zyrtarë nuk duhet të përdorin dhunën fizike ndaj personave të mbajtur dhe

¹⁵⁹ Neni 39.Shënimi 29 Këshilli Evropian.Komiteti Evropian për parandalimin e torturës dhe trajtimit çnjerëzor.

¹⁶⁰ Shënimi 75 i të Drejtave të Njeriut dhe zbatimi i ligjit.Shënimi 5,Standardi 8 Amnesty Internacional 10 standardet themelore për të Drejtat e Njeriut për zyrtarët.

¹⁶¹ Neni 38.Shënimi 29 i Këshillit Evropian për parandalimin e torturës.

¹⁶² Neni 34.Shënimi 29 Këshillit Evropian, standardet e Këshillit Evropian për parandalimin e torturës.

¹⁶³ Neni 12 (1988) Parimet e grupit për mbrojtjen e të gjith personave që l nënshtrohen çdo lloj të paraburgimit ose burgimit.

¹⁶⁴ Neni 12.Shënimi 13 Parimet e grupit për mbrojtjen e të gjith personave që l nënshtrohen çdo lloj të paraburgimit ose burgimit.

¹⁶⁵ Neni 6.Shënimi 5 Kombet e Bashkuara,kodi i sjelljes për zyrtarët përgjegjës për zbatimin e ligjit.

¹⁶⁶ Neni 8.a dhe 8.b (1995) Kombet e Bashkuara standardet minimale rregullat për trajtimin e të burgosurve.

të burgosurve, vetëm në rast kur ajo është e pashmangshme për mbrojtjen e rendit dhe sigurisë të institucioneve ose kur rrezikohet siguria personale.¹⁶⁷ Personat e ndaluar kanë të drejtën e paraqitjes para gjyqtarit në kohën e duhur ose para ndonjë personi tjetër zyrtarë i autorizuar për zbatimin e ligjit për të vendosur për mbajtjen e tyre nëse është e nevojshme.

3.8. KODI I ETIKËS POLICORE

Etika policore është mbledhje e principeve morale të cilat zyrtarët e policisë i pranojnë si pjesë përbërëse të profesionit të tyre dhe që ka të bëjë me sjelljen e tyre ndaj veprimeve zyrtare brenda organizatës, si dhe jashtë saj. Në pjesën hyrëse të Kodit të Etikës Policorejanë të shprehura raportet që rregullon ky kod, dhe thuhet: “Kodi i Etikës së Shërbimit Policor të Maqedonisë (në tekstin e mëtejshëm: Kodi i Etikës) është shprehje e vullnetit dhe përmbledhje e përgjithshme e parimeve bazë për të gjithë zyrtarët policor të Shërbimit Policor të Maqedonisë me të cilat rregullohen: Objektivat e policisë, baza e ligjore të policisë, roli i policisë në sistemin e drejtësisë penale si dhe raportet e policisë me organet e drejtësisë, strukturën organizative të policisë, marrëdhëniet e punës, trajnimi i personelit dhe hetimet.”¹⁶⁸

Në Udhërrëfyesin për Policin Demokratik nga Këshilltari i Lartë Policor i Sekretarit të Përgjithshëm të OSBE-së, në pjesën ku flitet për etikën policore dhe të drejtat e njeriut thuhet: Në mënyrë që t’i përgjigjet besimit të publikut, policia duhet ti përmbahet një kodi të etikës profesionale dhe të demonstrojë: Profesionalizëm dhe integritet.¹⁶⁹

Ky kod duhet të pasqyrojë vlerat më të larta etike, të shprehura në: Kufizime dhe detyrimet të punës së policisë.¹⁷⁰ Policia ka pushtet të veçantë për të:

Hequr përkohësisht lirinë e njerëzve, kufizuar gëzimin e plotë të të drejtave të tyre dhe në rrethana të skajshme, të përdorë madje edhe forcën vdekjeprurëse.¹⁷¹ Prandaj punonjësit e policisë duhet të përmbushin detyrat e tyre në përputhje me: Standardet Universale të të Drejtave të Njeriut dhe të Drejtat Civile dhe Politike.¹⁷²

¹⁶⁷Neni 15.Shënim 29 I Kombeve të Bashkuara parimet themelore për përdorimin e forces fizike dhe armëve të zjarrit nga ana e personave zyrtar.

¹⁶⁸ Kodi i etikës së policisë së Maqedonisë.Neni 128.Paragrafi 2 i Ligjit për policin (Gazeta Zyrtare e RM-së.Nr.114/2006)

¹⁶⁹Udhërrëfyes për policinë Demokratike nga Këshilli I lartë policer i Sekretarit të përgjithshëm të OSBE-së,Vijen.

¹⁷⁰Po aty

¹⁷¹Po aty

¹⁷²Po aty

Mbrojtja dhe ruajtja e jetës duhet të jenë përparësia e tyre më e lartë.¹⁷³ Shkelja e normave etike në numër të vogël të rasteve nuk tërheq përgjegjësi formale, por shkelësi do të vuajë dënimin, kurse në raste të caktuara do të ndalohet ushtrimi i profesionit të policit. Megjithatë, në numrin më të madh të rasteve shkeljet e normave etike janë edhe shkelje të normave ligjore, shkelësi përveç gjyqit moral do të përgjigjet edhe në aspekt disiplinor apo penal.

Vlera e normave etike shihet edhe në atë se ato, duke rregulluar raportet e policisë me qytetarët gjatë zbatimit të detyrave policore, në të njëjtën kohë sigurojnë një marrëdhënie të suksesshme midis policisë dhe qytetarëve. Sepse qytetarët nga zyrtarët e tyre kërkojnë sjellje të drejtë dhe shembullore. I pashmangshëm është fakti se zyrtari policorë që nga momenti kur fillon me detyrën zyrtare, sjellja e tij duhet të jetë në harmoni me këto detyra zyrtare dhe në shërbim të qytetarit. Qëndrimi dhe bindja e qytetarëve ndaj policisë do të varet nga qëndrimi dhe sjellja e policisë ndaj tyre, para se gjithash varet nga niveli i respektimit të dinjitetit njerëzor dhe lirive dhe të drejtave themelore të tyre nga ana e policisë.

Duke u nisur nga rëndësia që etika policore ka për marrëdhënien polici qytetar, shteti ka sjellë kodeksin policor, ku përfshihen parimet etike të sjelljes së policisë brenda organit dhe në raport me qytetarët. Ky kodeks është në harmoni të plotë me Kodeksin Evropian të etikës policore, gjegjësisht rekomandimet e komitetit të ministrave të Këshillit të Evropës të dhëna për shtetet anëtare 19 shtator të vitit 2001. Në këtë drejtim do të potencojmë disa nga parimet e këtyre rekomandimeve:

- “Procedimi i policisë duhet të jetë në harmoni me normat ligjore që rregullojnë procedurën penale dhe procedurave të tjera në bazë ku policia duke aplikuar ligjin, do të respektojë edhe autorizimet e veta në raport me persona të caktuar”¹⁷⁴. Esenca e këtij rekomandimi është shmangia e arbitraritetit të policisë gjatë procedimit të një rasti konkret, si dhe përmbushja e kriterëve ligjore në raport me këto procedime.

- “Policia duhet të respektojë prezumimin e pafajësisë, si dhe të drejtat e të dyshuarit, të akuzuarit ose të ndonjë personi tjetër, konkretisht të drejtën që menjëherë të njoftohet me akuzën kundër tij dhe të përgatisë mbrojtjen e vet, personalisht apo mbrojtësit (avokati) në bazë të zgjedhjes personale”.¹⁷⁵ Prezumimi i pafajësisë është pjesë përbërëse edhe e Konventës

¹⁷³Po aty

¹⁷⁴ Kodeksi Evropian i etikës policore, rekomandimet e Komitetit të Ministrave të Këshillit të Evropës të dhëna për shtetet anëtare .19.09.2001.

¹⁷⁵Po aty.

Evropiane mbi të Drejtat e Njeriut dhe paraqet një rën nga të Drejtat më të rëndësishme të Njeriut në procesin penal gjyqësorë. Pavarësisht nga fuqia e provave që qëndrojnë kundër të dyshuarit, policia domosdoshmërisht duhet të respektojë prezumimin e pafajësisë dhe në mënyrë objektive ta hetojë rastin.

- “Komiteti Evropian mendon se duhet të ekzistojnë rregulla të qarta për mënyrën me të cilën duhet të realizohet hetimi policor”.¹⁷⁶ Sipas këtij rekomandimi të gjitha veprimtaritë e policisë në drejtim të hetimit dhe në këtë drejtim edhe me marrjen në pyetje të dyshuarin duhet të jenë të rregulluara në mënyrë të qartë me norma juridike.

- “Duke respektuar rolin e avokatit, pjesëtarët e policisë nuk përzihen në punën e tyre. Dhe në rastet kur avokati ka nevojë ato duhet ti ofrojnë ndihmën e tyre, konkretisht në rastet kur kemi të bëjmë me person të privuar nga liria”.¹⁷⁷ Policia duhet të respektojë rolin dhe punën e avokatit në një proces penal duke mos ndikuar në punën e tyre duke i frikësuar apo shqetësuar ato. Nëse do të nisemi nga reputacioni negativ që policia ka pasur në të kaluarën e saj, e qartë është qasja kritike që sot ka opinioni publik. Publiku me padurim pret që policia të lirohet nga barra e të kaluarës dhe të shndërrohet në mbrojtëse të sigurisë së tyre. Që në këtë të ketë sukses domosdoshmërisht duhet të ndryshohen disa rregulla të pashkruara të filozofisë së veprimit të tyre. Në këtë drejtim roli i parimeve të etikës policore është shumë i madh. Policia të mjaftueshme e ka të kujtohet vetëm në esencën dhe vlerat e nocionit policishërbimi dhe siguria e qytetarëve.

Sipas Udhërrëfyesit për Policinë Demokratik nga Këshilltari i Lartë Policor i Sekretarit të Përgjithshëm të OSBE-së, si parime bazë të Policisë Demokratik janë:

- Objektivat e Policisë Demokratike.
- Ruajtja e Shtetit Ligjor.
- Etika Policore dhe të Drejtat e Njeriut.¹⁷⁸

3.9 SEKTORII KONTROLLIT TË BRENDSHËM DHE STANDARDET PROFESIONALE

Kontrolli mbi punën e policisë zhvillohet në nivel të jashtëm dhe të brendshëm. Kontrolli i brendshëm kryhet nga Sektori për Punë të Brendshme, kontrollet dhe standardet profesionale

¹⁷⁶ Udhërrëfyes për policinë Demokratike nga Këshilli i Lartë policer i Sekretarit të përgjithshëm të OSBE-së. Vjen Maj.2008, botimi i dytë.

¹⁷⁷ Po aty.

¹⁷⁸ Udhërrëfyes për policinë Demokratike nga Këshilli i Lartë policer i Sekretarit të përgjithshëm të OSBE-së. Vjen Maj.2008, botimi i dytë.

të Ministrisë së Brendshme. Ndërsa për të jashtmet kontrolli kryhen nga Avokati i Popullit, Prokurori Publik, Gjykata, Parlamenti i RM-së dhe Sektori Civil. Në pajtim me Ligjin për policinë, çdo person ka të drejtë të ankohet atëherë kur ai e konsideron veten se është viktimë e abuzimit policorë ose gjatë marrjes, kompetencat policore shkelin të drejtat e tij/saj.¹⁷⁹

Sektori për Kontroll të Brendshëm dhe Standardet Profesionale (SKBSP) veprimtarinë e tyre e rregullojnë me Rregulloren për kryerjen e punëve,¹⁸⁰ me të cilën përshkruan mënyrën e veprimit të sektorit në përcaktimin e formimit të trajtimit të paligjshëm nga ana e punonjësve të policisë. Duke filluar nga Rregullorja e SKBSP-së në MPB ky organ vepron në bazë të të dhënave, informacioneve dhe njohuritë të cilat vinë vet nga iniciatorët, sipas kërkesave që ato paraqesin ose drejtpërsëdrejti të paraqitura nga punëtorët e policisë në MPB bazuar në ankesat që i referohen punës së paligjshme dhe joprofesionale të punëtorëve dhe me urdhër të MPB-së

Raporti i Avokatit të Popullit (AP) i vitit 2008 tregon se hetimet e kryera nga sektori i kontrollit të brendshëm (SKB) dhe nga SKBSP-ja në rast të një ankese për shkelje të të Drejtave të Njeriut nga pala e punonjësve të policisë janë të bazuara në deklaratat e të përfshirëve të Personave të Autorizuar (PA) për kryerjen e një hetimi të plotë duke mbledhur prova, dëshmitë e dëshmitarëve dhe viktimat e trajtimit policorë. Duke vepruar kështu vetëm një pjesë e vogël nga ankesat e SKBSP-së e cila rritë nevojën profesionale të sektorit për të.¹⁸¹

Megjithatë në raportin e Departamentin e shtetit Amerikanë për vitin 2008 thuhet se progresi i vazhdueshëm i MPB-së në punën e rasteve të reja të abuzimeve nga ana e autoriteteve zyrtare vazhdon.¹⁸²

Në raportin e Komisionit Evropian (KE) për progresin e RM-së për vitin 2009 tregohet se kontrolli mbi policinë në përgjithësi dhe veçanërisht mbi njësitë speciale ishte më efektiv për shkak të përdorimit më të madh të revizionit të brendshëm që të përfitohet siguria dhe standardet profesionale. Por në të njëjtin paragraf thuhet se ende nuk ekziston një mekanizëm i jashtëmi pavarur për monitorimin e rasteve të keqpërdorimit të veprimtarisë të zyrtarëve të policisë thuhet në Raportin Progresiv për RM-në.¹⁸³

¹⁷⁹ Neni 8 i Ligjit për policinë (Gazeta Zyrtare e RM-së.Nr.114/2006.148/2008.6/2009)

¹⁸⁰ Rregullorja për Kryerjen e punëve të SKBSP-së.Miraturar në Maj.2007, dhe ka hyrë në fuqi më 11.11.2007 www.mvr.gov.mk/desktop.aspx?tabindex=o&tabid=130

¹⁸¹ Rapoti vjetor i Avokatit të Popullit për vitin 2008 www.ombudsman.mk/default.aspx?cld-104&Lan=mk

¹⁸² <http://state.gov/g/drl/rls/hrrpt/2008/eur/119091.htm>

¹⁸³ Raporti progresiv për RM-në për vitin 2009 nga data 15.10.2009.Dokument pune i botuar në www.sep.gov.mk

Ankesat e dorëzuara në SKB dhe Standardet Profesionale të SKBSP-së.

Brenda projektit të periudhës së vitit 2009 përmes projektit për mbështetjet të Drejtave të Njeriut (DNJ) janë paraqitur 36 ankesa, ndërsa për 6 raste nuk janë paraqitur ankesa nga të cilat 3 raste potenciale, viktimat nuk donin të ngrinin një procedurë për shkak të frikës dhe mosbesimit në shtet dhe institucionet, në 2 raste lëndët udhëhiqen nga Avokati i Popullit, ndërsa në 1 rast është kërkuar monitorimi në një çështje gjyqësore për vepër penale, përgjegjësia e një punëtore të policisë.


3.10. REZULTATET DHE DISKUTIMET

Rastet e regjistruara të kërkesave për mbrojtjen e të Drejtave dhe Lirive të Njeriut nga abuzimi i policisë në vitin 2010.

Në vitin 2010, 38 kërkesa për mbrojtjen nga abuzimi policorë ishin regjistruar.


Tabela 1. Raportime për:Strukturat Etnike, gjinore, moshë e viktimave të regjistruara

Struktura Etnike		Struktura Gjinore		Struktura e Moshës	
Maqedonas	22	Meshkuj	34	Të Rritur	38
Shqiptarë	02	Femra	04	Të Mitur	0
Rom	13	Total	38	Total	38
Turq	01				




22 ankesa janë dorëzuar në SKBSP nga të cilat janë paraqitur 2 ankesa të cilat janë në procedurë, 2 ankesa janë parashtruar, ndërsa 18 ankesa janë të pabazuara, ndaj të cilave për 2 ankesa është përgjigjur se nuk ka dëshmi të mjaftueshme.

Dorëzimi në SKBSP për vitin 2010.



Në vitin 2010, deri te A.V janë dorëzuar 16 ankesa të cilat kanë marrë 1 përgjigje nga 15, nga të cilat në 7 raste procedura është ndalur, 4 ankesa kanë një bazë dhe janë përgjigjur pozitivisht dhe 4 të tjera janë në procedurë.

Tabela 2. Ankesat e paraqitura pranë Avokatit të Popullit në vitin 2010



DISKUTIMET:

Ka më shumë raste të paraqitjes për një kërkesë për mbrojtje nga të Drejtat e shkelura të qytetarëve në procedurën policore, por pa iniciativë për fillimin e një procedure për arsye të ndryshme, të ashtuquajtura Raste Jooficiale.

Shumica e ankesave kanë të bëjnë me përdorimin e tepruar të forcës fizike nga oficerët e zbatimit të ligjit policorë, pa respektuar standardet Ndërkombëtare dhe ato vendore që i referohen përdorimit të forcës në procedurën policore.

Për shkak të madh të mospërgjegjeve nga ana e SKBSP-së, konstatohet mos respektimi i ankesave dhe si rrjedhojë qytetarët humbin besimin dhe kërkojnë mbrojtjen në procedurë për të Drejtat e dhe Lirive Themelore të Njeriut.

REKOMANDIMET:

Të rritet besimi i qytetarëve në mekanizmat e brendshme për mbrojtjen e të Drejtave dhe Lirive Themelore të Njeriut dhe ngritja e vetëdijes, sepse është e nevojshme të raportohen rastet e keqpërdorimit policorë. Përputhja e plotë e standardeve vendore dhe Ndërkombëtare në lidhje me përdorimin e mjeteve për shtrëngim në veprimet policore. Trajtimet edukative të punonjësve të policisë në përmbajtje nga aktet ligjore vendore dhe Ndërkombëtare si dhe dokumentet relevante përcjellin dekoratat, rregullat, rekomandimet me përdorimin e mjeteve të forcës dhe armëve të zjarrit, standardet për respektimin e të Drejtave dhe Lirive të Njeriut të privuar nga Liria, si dhe shembuj dhe praktika të Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut në fushën e shkeljes së të Drejtave në Procedurën policore. Forcimi i kapaciteteve të SKBPS-së në çdo aspekt të profesionalizmit, transparencës, paanësisë dhe pavarësisë në zero tolerancë ndaj torturës dhe trajtimit mizor dhe çnjerëzor.

Roli i Avokatit të Popullit në hetimin e pohimeve të ankesave nga qytetarët që ankohen nga keqpërdorimi i policisë duhet të jetë tërësisht i pavarur dhe përtej hetimeve të kryera ose të udhëhequra nga SKBSP-ja. Të shihet mundësia për paraqitjen e një raporti në kornizat e Prokurorisë Publike për keqpërdorimin dhe torturën e policisë kundër qytetarëve dhe të Drejtave dhe Lirive Themelore të tyre.¹⁸⁴

¹⁸⁴Mbrojtja e të Drejtave të Njeriut në procedurën policore.

Policia dhe të Drejtat e Njeriut, udhëzues për trajnimet policore, Komiteti Helsingut në RM-së Shkup 2003 http://www.mhc.org.mk/reports/86?locale=sq#.W6Qb_CQzbMw

Kodeksi i etikës policore (Gazeta Zyrtare e RM-së. Nr. 72/2007)

Ligji për policinë (Gazeta Zyrtare e RM-së. Nr. 114/2006. 148/2008. 6/2009)

Ligji për Avokatin e Popullit (Gazeta Zyrtare e RM-se. nr 60/2003. 114/2009)

Ligji për ratifikimin e protokollit fakultativ të Konventës së OKB-së kundër torturës 30.12.2008 (Gazeta Zyrtare e RM-së. Nr. 165/2008)

Protokolli I dytë fakultativ I Konventës Ndërkombëtare për të Drejtat Civile dhe Politike, miratuar nga Asambleja e përgjithshme e OSBE-së në Rezolutën 44/128 të datës 15. Dhjetor. 1989

Udhëzues për punët policore në mjediset multietnike, Shkup 2003.

3.10.1 INTERVISTA ME ZYRTARË POLICORË (09.Mars.2018.Tetovë)

Intervista e bërë më Zyrtarë të Policisë (Z.A) ku nga kjo intervistë do të marrim disa të dhëna në lidhje me punët policore, autorizimet policore dhe veprimet e tyre ashtu siç vijon:

A ka ndodhur ndonjëherë që mos të jepen të dhënat personale ose nuk ka mundësi që ti japë ato personi, dhe a ka ndonjë rast që MPB-ja ta bëjë publike fotografinë e personit për të zbardhur identitetin?

Po ka pasur raste kur personi nuk ka dashur që me vullnetin e tij ti jep të dhënat personale atëherë ne si zyrtarë policore i përdorim metodat tona ku veprojmë për zbardhjen e identitetit të tij si p.sh. marrja në pyetje për të zbuluar ndonjë të dhënë se prej nga vjen personi në fjalë, kontrollimi i sistemit elektronik, marrja e shenjave të gishtërinjve, fotografimi i personit, publikimi i fotografisë që të kërkohet ndihma e qytetarëve për njohjen e tij dhe mbajtja e tij deri sa të zbulojmë identitetin e tij. Nëse nuk e zbulojmë atëherë personin e dërgojmë tek organet kompetente për migrim ose nëse personi dëshiron që të hyjë në RMV-së atë nuk do ti lejohet hyrja ndërsa nëse rasti ndodhën brenda territorit të RMV-së duhet që të zbardhet identiteti i tij. Po ka raste kur MPB-ja publikon fotografitë e personave që kërkohet ndihma nga qytetarët si për personat e zhdukur, personat në kërkim, për humbjen e trashëgimive kulturore, humbjen e gjerave të tjera ku mundët që të shihen në çdo kohë në faqen e MPB-së www.mvr.gov.mk

A ka ndodhur që të thirret një person nëpërmjet mjeteve publike?

Me sa e di unë ka pasur por zakonisht në të shumtën e rasteve MPB-ja bën thirrje për tubimet, mbledhja e qytetarëve në masë me të madhe, takimeve sportive dhe rasteve të njëjta ku masa është më e madhe.

Sa ka arritur policia të ndalojë kryerjen e një vepre penale brenda 5 viteve të fundit?

Policia gjithnjë është në veprim për parandalimin e veprave penale dhe për të gjitha veprat kundër ligjit të RM-së, ka shumë raste që policia ka arritur ti parandalojë veprat penale por ka edhe raste që nuk ka mundur. Por me shifra të sakta se sa janë nuk kam informacione të sakta sepse kjo punë i përket një sektori tjetër.

Dihet se policia mund të veprojë edhe jashtë orarit të punës, a ju ka ndodhur juve personalisht të vepronit?

Po është e vërtetë se mund të reagojmë e kemi të lejuar edhe me ligj edhe mua personalisht më ka ndodhur që të reagoj, por kanë qenë raste të lehta. Si rast ka qenë rrahja e disa të rinjve

dhe kam ndërhyrë për ti qetësuar në mënyrë profesionale duke u prezantuar me dokumentin zyrtarë (i legjitimitetit).

Cilat janë veprat më recediviste dhe a ka ndryshuar numri i tyre është në ule apo në ngritje nga viti i kaluar?

Si vepra më recediviste do ti kisha klasifikuar pak më shumë vjedhjet, shitja e lëndëve narkotike, sipas punës së përditshme që kam sipas mendimit tim numri është rritur më shumë nga viti i kaluar.

Cila është vepra penale që ju ka tronditur juve më së shumti?

Personalisht më së shumti më ka tronditur kur kemi shkuar ti ofrojmë ndihmë një çifti të moshuar dhe me arritjen tonë atje pamja e tyre ishte tmerruese nga rasti që u kishte ndodhur sepse ishin dhunuar nga disa të rinjë në shtëpinë e tyre duke i lidhur rrahur maltretuar dhunuar dhe duke u marrë gjërat dhe sendet me vlerë. Si sot më kujtohet pamja e tyre ishte tronditëse.

Sa është dominante dhuna në familje dhe sa raste ka të paraqitura 2 vitet e fundit?

Të gjithë e dimë se dhuna në familje ka qenë dhe është dominante për fat të keq mirëpo pozitiviteti i asaj është sepse femrat janë vetëdijesuar tani më, sepse i kanë lanë pas dore zakonet e vjetra tani kanë filluar që më shumë të paraqiten rastet për dhunë në familje. Me numër të saktë nuk jam i informuar mirëpo sipas meje ka rritje të numrit nga vitet e kaluara.

Cilat të dhëna policore shlyhen dhe cilat ruhen?

Të gjitha të dhënat që janë të rëndësishme dhe që janë në procedurë deri te vërtetimi i tyre se a janë të sakta ose jo. Nëse të dhënat nuk janë të sakta ato shlyhen ndërsa të tjerat konsiderohen të rëndësishme për procedurën e mëtutjeshme.

A ka parashtresa të paraqitura kundër zyrtarëve policorë nga qytetarët dhe cilat janë masat e marra kundër tij?

Në rajonin policorë të cilin punojë unë është me numër të vogël të punonjësve policor por kemi një parashtresë e cila është në procedurë dhe masat ende nuk janë marrë ndaj personit zyrtarë.

Veprat të kryera prej kryerësit të panjohur, sa janë afërsisht të regjistruara?

Ka disa vepra të regjistruara si më të shpeshtat janë vjedhjet në prona të huaja po si më e renda ka qenë djegia e një personi të lyer me karburant dhe autori ene nuk është gjetur.

A ka pasur raste për armëmbajtje pa leje?

Po kemi pasur disa raste në këtë drejtim janë konfiskuar armët e gjetura dhe personi është shoqëruar për në stacionin policorë të Tetovës ku dhe kanë vazhduar procedurat për dënimin e personave.

A ju ka ndodhur që ju të hapni një automjet me dhunë?

Mua personalisht nuk më ka ndodhur, por edhe të më kishte ndodhur do ta bëja nëse e do puna kuptohet në kornizat e ligjit.

Ju si person zyrtarë, në prishjen e Rendit dhe Qetësisë Publike ndaj një qytetari, cilën metodë do ta kishit përdorur në rend të parë?

Ashtu siç e parasheh ligji ashtu do të veproja edhe unë do ta kisha përdorur metodën me qetësi me fjalë me sjellje njerëzore duke respektuar të drejtat e Njeriut mirëpo kuptohet nëse personi në fjalë ma kthen me të njëjtën por nëse e do puna dhe kërkohet të përdoret forca fizike edhe për atë jemi të gatshëm po me masë.

Si veprohet me personin e ndaluar i cili është shtetas i huaj dhe ai e ka tejkaluar afatin kohorë për qëndrim në RM-së ?

Personi shoqërohet në stacionin policor, merret në pyetje se pse nuk ka lëshuar territorin e RM-së mos ka të bëjë me tregti me njerëz, kidnapim mos është viktimë e veprave kriminale. Ndaj tij shqiptohen masat e dënimit (koha që mos të hyjë në territorin e RM-së më së paku 6 muaj) dhe i jepet afati kohor për ta lëshuar territorin e RM-së ku mundet edhe në mënyrë të menjëhershme pa asnjë arsye të dëbohet nga shteti i RM-së.

A shkelen të Drejtat e Njeriut gjatë arrestimit nga ana e policisë?

Të jem realist dhe të them të drejtë në shumicën e rasteve shkelen diku më shumë e diku më pak po në përgjithësi shkelen.

3.10.2 INTERVISTA ME AVOKATIN E POPULLITË REPUBLIKËS SË MAQEDONISË IXHET MEMETI

(Tetovë 7 Shtator 2018)

Në këtë pjesë do të zhvillohet intervista me Avokatin e Popullit z.Ixhet Memeti.

Si janë kompetencat tuaja në krahasim me Avokatët e Popullit të vendeve tjera, a ndjeheni se ato janë më të ulëta me qen se këtu tek ne Avokati i Popullit e ka rolin më shumë si këshillues?

Jo përkundrazi, mendoj se vendosja e institucionit të Avokatit të Popullit në sistemin juridik të RMV-së është në nivel mjaft të lartë jo vetëm në regjion por edhe shumë më larg. Sa i përket

promovimit, sa i përket mandatit që e ka ai dhe sa i përket mundësive të cilat i ka. Mirëpo shtrohet pyetja sa ky pozicion e arrin efektin në RM-së, përsëri lind pyetja pse nuk ka efekt, për hirrë të asaj se në RM-së siç kalojnë vitet institucionet me thellë partizohen bëhen më problematike dhe funksioni i institucioneve mbartet në qendra tjera të vendosjes, në vend që të jetë në qendrat institucionale në Ministri apo Qeveri ajo është bartur në shtabet partiake.

A është e vërtetë që ingerencat janë shkurtuar prej Qeverisë sepse në krye të këtij institucioni ka ardhur një shqiptar, në dallim me Avokatet e Popullit të më hershëm ?

Qëllimi apo realiteti pse nuk pranohen në tërësi rekomandimet e tij është diçka tjetër, janë interesat e ndryshme politike, është e vërtetë se në RM-së ka shumë ndasi ka shumë veçori qoftë në aspekt nacional, fetarë e kështu më radhë, dhe është e vërtetë se për në institucion nacional unë p.sh. Jam i përkatësisë Etnike Shqiptare dhe jam në nivel nacional.

Të flasim pak për të burgosurit dhe kushtet nëpër burgje, çfarë keni ndërmarrë për përmirësimin e gjendjes së tyre ?

Sa i përket sistemit të burgjeve në RM-së jo që nuk përmirësohet ai si i tillë por si kalojnë vitet ai edhe keqësohet qoftë në aspektin e hapësirave, qoftë në aspekt të ushtrimit të funksionit brenda për brenda në burg, sa u përket hapësirave apo kushteve të burgjeve në RM-së ne kemi kushte nën çdo nivel dhe nën çdo standard dhe ato kushte johumane trajtohen si cenim të të Drejtave të Burgosurve në RM-së. Ne kemi sistem shumë më të keqse rrethi si Greqia, Bullgaria, Kosova, Shqipëria dhe kështu me radhë. Kushtet janë më të vështira në RM-së Sektori i Sigurisë me probleme shumë të mëdha, me kuadro joprofesional, sistemi i edukimit pa edukatorë profesional, me ndikime të ndryshme partiake dhe nuk funksionon nuk ka arsimim brenda, sistemi i shëndetësisë dhënie e shërbimeve të burgosurve ka kaluar, është varros ka 3 vite e me radhë për derisa vetëm në vitin 2017 ne kemi pasur 7 Procedura për Vdekje të cilat kanë ndodhur nëpër burgje në rrethana në të cilat nuk ka mundur i burgosuri të kërkojë ndihmë mjekësore për hirrë të asaj se nuk ka pasur personel mjekësorë, pra rastet kanë ndodhur pas orës 16:00 kur nëpër burgjet e RM-së nuk ke të punësuar askënd tjetër përveç rojeve të burgut (gardianëve). Ky sistem është shumë keq i vendosur edhe në Ligjin për ekzekutimin e sanksioneve penale, për hirrë të asaj se këtë shërbim në bazë të Ligjit duhet ta japë Ministria e Shëndetësisë Publike dhe ajo nuk ndodh, edhe formalisht sistemi shëndetësorë në burgje nuk ekziston është i pareaalizueshëm, në anën tjetër të gjitha këta vdekje që përmenda që kanë ndodhur në rrethana të dyshimta duhet të hetohen në mënyrë të mirëfilltë me qëllim që të

kthehet besimi sepse ke familje që kur ndodhin raste janë të trishtuara, dhe të gjithë që kanë të burgosur nëpër burgje druhen për gjendjen e tyre si shëndeti, ushqimi, pastërtia etj.

Sa janë ato persona që kanë humbur jetën (të vdekur) në mënyrë të natyrshme dhe në mënyrë të dyshimtë?

Është problem se të gjitha rastet janë të dyshimta, në vitin 2016 muajt e fundit patë 2 raste të cilat nuk u zbardhën deri në fund, në vitin 2017 ishin 7 raste d.m.th. diku për gjysëm viti ka 9 raste me vdekje për të cilat Ministria e Drejtësisë nuk e pa të rrugës të dalë në mënyrë transparente të informojë opinionin se si ka ndodhur që atë dilemë ose atë dyshim ta sqarojnë.

Por ju keni prova nëpër burgje, dhe nëse keni pse i ruani ato ?

Avokati i Popullit kur i grumbullon provat nëse dyshon se ka elemente të veprës atë ja drejton Prokurorisë, ajo ka të bëjë me atë që do të thotë se sa Prokuroria i merr seriozisht dhe i heton seriozisht denoncimet të cilat i bënë Avokati i Popullitshumë pak ose fare. Pra RM-së ka një problem shumë më të madh se nuk kemi hetim efektiv për rastet kur cenohet neni 2 dhe 3 i Konventës, kur kemi mundim torturë, lëndime fizike, posaçërisht të personave që ndodhen të privuar nga liria dhe gjenden në burgje. Dhe këtë konstatim të Avokatit të Popullit e ka konstatuar në disa vendime edhe Gjykata për të Drejtat dhe Liritë e Njeriut në Strasburg e cila e konstaton se RM-së nuk ka hetim efektiv për mbrojtje të të Drejtave të Njeriut që kanë të bëjnë me Torturën.

Sa raste gjyqësore i keni inicuar dhe sa janë zgjedhur prej tyre ?

Ne kemi inicuar diku më tepër se 28 Procese gjyqësore për dhunë dhe maltretim, efekti është se vetëm 1 ka përfunduar me gjoja se (roja e burgut) ka kryer vepër penale lëndim të rëndë truporë, edhe atë si vepër e ka prekualifikuar Prokuroria duke menduar se me atë mënyrë i ndihmon shtetit përkundrazi nuk i ndihmon as qytetarit as shtetit por cenon të Drejtën e Qytetarit edhe atë fundamentale për jetë ndërsa në anën tjetër rrënon edhe sistemin e shtetit. Kurse shumë procese të tjera të cilat i kemi inicuar dhe që kanë të bëjnë me Torturën, Prokuroria pa asnjë bazë nuk i heton, ose e informon Avokatin e Popullit nga provat gojore ose verbale të cilat ju na i keni drejtuar por policia thotë se ne kemi vepruar në bazë të Ligjit ose prokuroria hesht.

Gjatë punës tuaj ka pasur edhe dhunë ndaj gazetarëve nga ana e policisë, sa prej atyre kanë kërkuar nga Avokati i Popullit që tu dalë në ndihmë dhe ti kërkojë të Drejtat e atyre?

Më vjen keq se nuk kemi pasur mundësi që në mënyrë efektive deri në fund të ndihmojmë gazetarët të ushtrojnë profesionin e tyre, mirëpo në anën tjetër sigurisht që atë keqardhje dhe atë që ka ndodhur qoftë me dhunë ndaj tyre ne për pos asaj që e kemi dënuar në mënyrë më të ashpër dhe kemi kërkuar nga institucionet përgjegjëse që të marrin masa, nuk kemi pasur mundësi që të bëjmë diçka më tepër, sa u përket gazetarëve kemi pasur shumë raste, por në një rast më kujtohet që edhe fletëparaqitja e jonë penale u hodh nga Prokuroria gjoja se është e pabazë. Përsëri kthehem te ai problemi se në RM-së nuk ka Procedurë Efektive sa i përket ndëshkimit të atyre të cilët përdorin dhunë, ku si rast ishte edhe futja e qytetarëve në Parlament ku aty u dhunuan edhe gazetarët në prezencë të policisë.

SHTOJCA

DISA MODELE TË AKTEVE KRYESORE TË POLICISË QË NDËRLIDHEN ME AUTORIZIMET DHE PUNËT POLICORE

MINISTRIA E PUNËVE TË BRENDSHME

(Emri i Njesisë Organizative)

Nr: _____

Data: ____ 20 ____ Viti

Në bazë të NENI 10 Paragrafi 3 i Rregullores për kryerjen e punëve të Ministrisë për Punë të Brendshme ("Gazeta Zyrtare e RM-së" Nr. ____)

PARALAJMËRIM

Personi _____ Babai _____

Dhe Nëna _____ I/E Lindur _____ 19 ____ Viti,

në _____

Komuna _____ Shteti _____ Kombësia _____

Profesioni _____ Vendbanimi _____ Rruga _____

Nr i Letërnjoftimit _____ E lëshuar prej _____

Në Ditën ____ 20 ____ viti, në ____ ora, në hapësirat e Stacionit Policorë _____, nga ana e Personit Zyrtarë të Autorizuar _____, ju paralajmërojmë si në vazhdim:

I PARALAMRUARI PERSONI ZYRTARË I AUTORIZUAR _____ V.M

(Emri i Njesisë Organizative)

Nr: _____

Data: ____20__ Vitin

THIRRJE

Në bazë të NENI 142 i Ligjit për Procedurë Penale ("Gazeta Zyrtare e RM-së, Nr. 15/79) dhe NENI 2 Paragrafi 2 i Ligjit për Kundërvajtje ("Gazeta Zyrtare e RM-së, nr15/97) si dhe Neni 12 Paragrafi 3 I Rregullores për kryerjen e punëve të Ministrisë për Punë të Brendshme ("Gazeta Zyrtare e RM-së, nr__)

Thirret _____, me profesion _____, me vendbanim _____,
Rruga _____, nr _____, që të vijë në Ditën _____, ora _____,
Në _____. Rruga _____, nr _____, Për shkak të dhënies së
njoftimit: _____

Personi i thirrur ka të drejtën e marrjes së Avokatit.

Derisa personi i thirrur nuk i përgjigjet kësaj thirrje, dhe as nuk e vërteton mosprezencën e tij, mundet që me forcë të sillet, me vendim të gjykatës të bazuar në Nenin 142. Paragrafi 3 i Ligjit për Procedurë Penale.

P.Z.A

DORËZIMI

Sot më ____20__ viti, Unë _____ E pranojë THIRJEN me
nr ____ prej ____20__ viti, në _____ me të cilën thirrrem që të
paraqitem në Ditën ____20__ viti, në ____ ora.

Jam i informuar për të Drejtën e marrjes së Avokatit.

Unë jam paralajmëruar për pasojat e Neni 142, Paragrafi 3 i Ligjit për Procedurë Penale, dhe në lidhje me Neni 2, Paragrafi 2 i Ligjit për Kundërvajtje

DORZOI

PRANOI

(Emri i Njesisë Organizative)

Nr: _____

Data: ____20__ Viti

PROCESVERBAL

Në bazë të Neni 20. Paragrafi 2 i Rregullores për kryerjen e punëve të Ministrisë për Punë të Brendshme ("Gazeta Zyrtare e RM-së" nr ____)

Në Ditën ____20__ viti, Në _____, Në hapësirat e _____

Personi Zyrtarë i Autorizuar _____ Me vendbanim _____ Në rrugën _____ Nr _____, Me nr e L. Njoftimit _____ E lëshuar prej _____

Personi i arrestuar në _____ ora, i është dorëzuar Personit Zyrtarë të Autorizuar _____.

DORZOI

PRANOI

(Emri i Njesisë Organizative)

Nr: _____

Data: ____20__ Viti

RAPORT PËR VEPRIM ME URDHËR PËR ARREST

Nr _____ Prej _____ 20 _____ viti,

Në Ditën _____ viti _____, në _____ ora, është kryer arrestimi i personit _____,

Lindur më _____, viti, në _____, Komuna _____, Me

vendbanim në _____, Rruga _____, Nr _____, Me nr e L,

Njoftimit _____, e lëshuar prej _____

Gjatë arrestimit (Ka pasur — Nuk ka pasur) probleme ose rrethana të tjera që e bënë të vështirë të njëjtën (arrestimin)

SHËNIM:

Personi i arrestuar në _____, Në Ditën _____ viti, Në _____ ora,

i është dorëzuar _____.

PERSONI ZYRTARË I AUTORIZUAR

MINISTRIA E PUNËVE TË BRENDSHME

(Emri i Njesisë Organizative)

Nr: _____

Data: ____20____ Viti

PROCESVERBAL PËR MBAJTJEN E PERSONIT

Në bazë të NENIT 25 të Rregullores për kryerjen e punëve të Ministrisë për Punë të Brendshme (“Gazeta Zyrtare e RM-së” nr ____)

Personi _____ Prej _____ Rruga _____ Nr _____

Me nr të L. Njoftimit _____ e lëshuar prej _____ Është mbajtur prej _____ ora, Në Ditën _____ Viti, Në _____ ora, në Ditën _____ Viti

ARSYJA:

_____.

PERSONI I MBAJTUR

P.Z.A

(Emri i Njesisë Organizative)

Nr: _____

Data: ____20____ Viti

SHËNIM ZYRTAR PËR KONTROLLIN E KRYER TË PERSONAVE QË UDHËTOJNË

Personi Zyrtarë i Autorizuar _____ Ne Ditën ____20____ Viti,
(Emri Mbiemri) Në _____ Duke u bazuar në Nenin 143 Paragrafi 1 i Ligjit për
Vepër Penale (VENDI)

(Gazeta Zyrtare e RM-së, nr 15/97) dhe Neni 16 Paragrafi 2 i Rregullores për kryerjen e
punëve të Ministrisë së Punëve të Brendshme (Gazeta Zyrtare e RM-së, nr ____) Kryen.

RREFERIM

Deri te Gjykatësi Hetues i Gjykatës Themelore _____ Rruga _____,
Nr _____, Personi _____ me (L. Njoftim, Pasaportë etj) nr _____,
(Emri Mbiemri) _____ e lëshuar
prej _____, i/e Lindur _____ 19 ____ Viti, Në _____,
(Vendi) Shteti _____,

Shtetas i _____, Me vendbanim në _____,
Rruga _____, Nr _____.

Referimi është kryer në ____ ora, Data ____20____, Viti, dhe personi duhet të paraqitet te
Gjykatësi Hetues në ____ ora, data ____20____ viti.

Gjykatësi Hetues _____ Është i informuar për Referimin

(Mënyra e informimit) Në ____ ora, Data ____20____ Viti.

Personi (është, Nuk është) paraqitur te Gjykatësi Hetues

(Nuk është e patjetërsueshme)

P.Z.A

MINISTRIA E PUNËVE TË BRENDËSHME

_____ Deri, te: (Emri i Njesisë
organizative) _____ Prokurori Publik Nr: _____ Data _____ 20 _____ Viti
Lidhja: Raporti ynë i veçantë me numër _____
Prej datës _____ Vitit
Numri i juaj i Aktit _____

Në bazë të Nenit 142. Paragrafi 6 i Ligjit për Procedurë Penale (Gazeta Zyrtare e RM-së, Nr 15/97) dhe Neni 167 dhe 173 I Rregullores për kryerjen e punëve të Ministrisë për Punë të Brendshme (Gazeta Zyrtare e RM-së, Nr _____) Është paraqitur:

RAPORT I VEÇANTË

Personi Zyrtarë i Autorizuar _____

MINISTRIA E PUNËVE TË BRENDESHME

(Emri i Njesisë organizative)

Deri, te:

Prokurori Publik

Nr: _____

Data _____ 20 _____ Viti

Lidhja: Raporti ynë i veçantë me numër _____

Prej datës _____ Vitit

Numri i juaj i Aktit _____

Në bazë të Nenit 141. Paragrafi 1 i Ligjit për Procedurë Penale (Gazeta Zyrtare e RM-së. Nr 15/97) dhe Neni 169. Paragrafi 2 i Rregullores për kryerjen e punëve të Ministrisë për Punë të Brendshme (Gazeta Zyrtare e RM-së. Nr _____) Është paraqitur:

KALLËZIMI PENAL

Kundër kryerësit të panjohur për kryerjen e Veprës Penale:

(Kualifikimi ligjorë i punës)

Prej të cilës është i dëmtuar personi _____, Me Vendbanim _____,

Vendqëndrim _____, Rruga _____, Nr _____,

Komuna _____, Shteti _____.

Koha, Vendi dhe mënyra e kryerjes së Veprës Penale.

Faktet që tregojnë se është kryer Vepra Penale.

Marrja e veprimeve dhe proceseve në pajtueshmëri me Nenin 142, 143 dhe 147 të Ligjit për Procedurë Penale (Inspektimi, kontrolli, marrja e sendeve, privimi nga liria etj)

KONTRIBUTET:

Personi Zyrtarë i Autorizuar _____

MINISTRIA E PUNËVE TË BRENDSHME

(Emri i Njesisë Organizative)

Nr: _____

Data: ____20____ Viti

Në bazë të Nenit 200 dhe 201 të Bazuar në Sigurinë në Komunikacionin Rrugorë (LBSKRR) (Lista zyrtare e RSFJ-së Nr50/88, 80/89, 29/90, 11/91) dhe (Gazeta Zyrtare e RM-së, Nr 12/93, 8/95) dhe Neni 195. Paragrafi 1 dhe 2 i Rregullores për kryerjen e punëve të Ministrisë për Punë të Brendshme (Gazeta Zyrtare e RM-së. NR_____) Jepet.

URDHËRESË

Vozitësi_____, Që ta ndërpres vozitjen e mëtejshme dhe ta shkyçë automjetin nga komunikacioni, me targat e regjistrimit_____, Marka e automjetit, _____ Në pronësi të_____, Për shkak të mangësive të mëposhtme:

Automjeti (i referohet-nuk i referohet) një inspektimi të kontrollit teknik

Vozitësit (I lejohet-Nuk i lejohet) ta marrë automjetin

Prej_____, Deri_____

Data____20____ Viti

_____(venndi)

Personi Zyrtarë i Autorizuar

.

(Emri i Njesisë Organizative)

Nr: _____

Data: ____20__ Viti

Në bazë të Nenit 218. Paragrafi 2 i Rregullores për kryerjen e punëve të Ministrisë për Punë të Brendshme (Gazeta Zyrtare e RM-së. Nr _____) Jepet:

SHËNIM ZYRTAR PËR PRANIMIN E NJOFTIMIT TË NJË AKSIDENTI NË TRAFIK

Me Datë _____ Viti. Në _____ Ora, Nga ana e personit _____, Me
Vendbanim _____, Rruga _____,
Nr _____ Në _____, Është pranuar njoftimi për aksident
trafiku. (emri i njesisë organizative)

Aksidenti i trafikut ka ndodhur në _____, Ora. Me datë _____, Viti. Në _____,
(vendi)

(ka) (nuk ka) persona të lënduar.

Personat e lënduar janë dërguar në:

Personi Zyrtarë i Autorizuar

MINISTRIA E PUNËVE TË BRENDSHME

(Emri i Njesisë Organizative)

Nr: _____

Data: ____ 20 ____ Viti

Në bazë të Nenit 3. Paragrafi 1 i Udhëzuesit mbi mënyrën e veprimit të personave zyrtarë të autorizuar në Ministrinë e Punëve të Brendshme (Gazeta Zyrtare e RM-së. Nr _____) Jepet:

VËRTETIM PËR MARRJEN E PËRKOHSHME TË SENDEVE

Me datë _____, Viti. Në _____ .NË _____ Ora, Prej personit _____,
(_____ vendi _____)(emri
mbiemri)Vendbanimi _____ .Rruga _____ .Nr _____ .Personi Zyrtarë i
Autorizuar _____ .

Përkohësisht u janë marrë sendet në vazhdim (dhënë sipas karakteristikave të tyre të përgjithshme ose individuale sipas numrit, llojt, markës ose kualitetit të caktuar)

Sendet _____ e _____ listuara _____ janë _____ sendet
të: _____

_____ (Baza mbi të cilën është kryer
sekuestrimi)

Sendet janë marrë prej _____ Personi Zyrtarë i Autorizuar _____

V.M _____

MINISTRIA E PUNËVE TË BRENDESHME

(Emri i Njesisë organizative)

Deri, te:

Prokurori Publik

Nr: _____

Data _____ 20 ____ Viti

Lidhja: Raporti ynë i veçantë me numër _____

Prej datës _____ Vitit

Numri i juaj i Aktit _____

Në bazë të Nenit 141. Paragrafi 2 i Ligjit për Procedurë Penale (Gazeta Zyrtare e RM-së. Nr 15/97) dhe Neni 167 i Rregullores për kryerjen e punëve të Ministrisë për Punë të Brendshme (Gazeta Zyrtare e RM-së. Nr _____) Është paraqitur:

KALLËZIMI PENAL

Kundër _____, Emri i Babait _____, Emri i Nënës _____, i/e
Lindur _____ Viti. Në _____, Vendbanimi _____, Rruga _____,
Nr _____. Me nr të L. Njoftimit _____ e lëshuar prej _____, Nr.
Amë _____, Me Profesion _____, Arsim të
kryer _____, Nacionaliteti _____, Shtetas i/e _____, I privuar-jo
i privua nga Liria. Me datë _____, Viti. Në _____ Ora.

Dorëzuar te Gjykatësi Hetues në _____ Gjykatën, Në _____,
Me datë _____, Viti, Në _____, Ora.

Për shkak të dyshimit të arsyeshëm se kishte kryer Vepër Penale _____. Me
Nenin _____. Të Ligjit për Procedurë Penale të Republikës së Maqedonisë.

Koha, Vendi dhe Mënyra e kryerjes së Veprës
Penale: _____

Faktet që tregojnë se është kryer Vepra Penale dhe që ai/ajo e ka kryer atë
: _____

Veprimet e ndërmarra në pajtim me Nenin 142, 143, dhe 147 të Ligjit për Procedurë Penale
(Inspektimi, Kontrolli, Marrja e sendeve, Privimi nga Liria, Marrja, Mbajta dhe të tjera)

PËRFUNDIMET DHE REKOMANDIMET

Në këtë punim të MA arrijmë deri te përfundimet e duhura si rrjedhojë e rezultateve, gjetjeve dhe diskutimeve lidhur me temën në fjalë. Përfundimet dhe rekomandimet ndërlidhen me analizën mbi autorizimet dhe punët policore në RMV në aspektin legjislativ dhe praktik, në kuptimin e gjendjes dhe perspektivës së tyre. Gjithashtu, jepen edhe konstatimet mbi raportin e ndërsjellë midis punëve dhe autorizimeve policore dhe të drejtave të njeriut në RMV përmes studimit empirik të raporteve policore, të organizatave për të drejtat e njeriut.

Sipas konsideratave tona, është e nevojshme për të siguruar edukimin e vazhdueshëm të personelit policor në standardet ndërkombëtare për të drejtat në procedurë policore, por edhe për të punuar në ngritjen e vetëdijes në mesin e qytetarëve për kompetencat e policisë dhe të drejtën për të apeluar në qoftë se një e drejtë është shkelur duke marrë të një ndërhyrjeje të veçantë të policisë. Mekanizmat e kontrollit, si dhe sektori civil, luajnë një rol veçanërisht të rëndësishëm në sferën e mbrojtjes. Sepse një herë procedura përbën një raport mes qytetarit dhe policit, organizatat e shoqërisë civile duhet të ketë një cilësi dhe qasje profesionale për përgatitjen e ankesës, si dhe në fushën e sigurimit të informatave dhe provave të shkeljes shtesë. Kontrolli i brendshëm shpesh nuk është efikas, prandaj standardet efektive ndërkombëtare është e nevojshme që të fuqizohen për të marrë hapa të sigurt për të siguruar një kontroll të plotë të pavarur dhe efektiv mbi policinë, por edhe për të forcuar pushtetin e mekanizmave të kontrollit të jashtëm, duke përfshirë këtu edhe Avokatin e Popullit. Besimi i qytetarëve është baza mbi të cilën duhet të veprojnë mekanizmat e kontrollit dhe punonjësit e policisë do të mbrohen nga raportimi i rremë duke krijuar monitorime të shtuara. Ka më shumë raste të aplikimit për kërkesën për mbrojtjen e qytetarëve për shkak të të drejtave të shkelura në procedurë policore, por pa iniciativën për iniciimin e procedurës adekuate për arsye të ndryshme, që në praktikë njihen si: raste jozyrtare.

Fakti se mbi 50% e shkeljeve të raportuara të të drejtave dhe lirive të njeriut i përkasin përdorimit të tepruar të forcës, flet me të madhe për ekzistencën e torturës, trajtimit mizor dhe degradues të punonjësve të policisë gjatë ushtrimit të detyrave zyrtare në punën e policisë. Prandaj është e nevojshme të deklarohet zero toleranca për torturën dhe sjelljen e keqe të policisë dhe autoriteteve më të larta shtetërore. Kjo vlen edhe për dhënien e deklaratave

publike të zyrtarëve të lartë në Ministrinë e Brendshme para mediave dhe (mos)respektimin e prezumimit të pafajësisë.

Duke u nisur nga konkluzionet e mësipërme, do të ishin veçuar rekomandimet në vijim:

- Ngritja e vetëdijes në mesin e punonjësve të policisë për respektimin dhe zbatimin e të drejtave në një procedurë policore, pavarësisht nëse ata punojnë me një person të dyshuar, dëshmitar ose viktimë.

- Një trajtim i ndjeshëm ndaj kategorive të cënueshme të personave, si dhe respektimi i plotë i dispozitave të Ligjit për të Drejtën e të Miturve dhe Standardeve Ndërkombëtare për të Miturit në kundërshtim me ligjin.

- Ndalimi absolut për të kryer tortura ose trajtime të tjera mizore ose degraduese dhe mospranimi në qoftë se ajo është gjetur të jetë e pasaktë, e cila do të japë një sinjal për aplikimin e tij në të ardhmen.

- Kryerjen e hetimeve të plota dhe efektive në rastet e vdekjes si dhe shkaktimin e lëndimeve të rënda trupore.

- Roli proaktiv dhe profesional i sektorit të OJQ-ve, si dhe zbatimi i kujdesshëm dhe i vendosur i kompetencave që ka kontrolli i brendshëm policor.

- Forcimi i kompetencave të mekanizmave të jashtëm dhe bashkëpunimi për të përcaktuar shkeljen e të drejtave në procedurën policore.

- Përputhja e plotë me standardet vendore dhe ndërkombëtare në lidhje me përdorimin e mjeteve të shtrëngimit në veprimet e policisë.

- Konsiderimi i mundësisë së futjes së një njësie të veçantë brenda Prokurorisë Publike lidhur me keqpërdorimet e autorizimeve policore si dhe torturën në përgjithësi të policisë.

BIBLIOGRAFIA

I. Tekstet Universitare, Publikime, Strategji, Plane dhe Raporte, Intervista

- Budimir B., "Ljudska prava i policija", "Prometej" Beograd 1999.
- Haris Halilović, Elmedin Muratbegović (E Drejta Policore) Sarajevë/Prishtinë 2007
- Halilović, Hariz, E Drejta Policore (ligjërat e autorizuar) Sarajevë/Prishtinë 2007
- Haziri Fatos. E Drejta e Policisë (ligjërat e autorizuar) Prishtinë 2010
- Maslesha Ramo Policia dhe Shoqëria. Sarajevë/Prishtinë 2008
- Dokumenti mbi reformën e policies. Agjencia Evropiane për rindërtimi, Projekti I reformës së policis. Shkup 2005.
- Arnaudovski L. Stojanovski T. Tavcievska D. Galevski R. Punët policore në mjediset multietnike. Doracak. Shkup 2003.
- Ligji për Policinë (Gaeta Zyrtare e RM-së. Nr. 114/2006. 148/2008. 6/2009)
- Ligji për Avokatin e Popullit (Gazeta Zyrtare e RM-së. Nr. 60/2003. 114/2009)
- Ligji mbi ratifikimin e protokollit fakultativ të Konventës të OKB-së kundër tortutës (Gazeta Zyrtare e RM-së. Nr. 165/2008. Me datë 30.12.2008)
- Kalajdziev G., Z. Jankulovski / V. Zafirovski / V. Gavrovski / U. Pirovska / Z. Ibrahim, Analiza e legjislacionit kombëtar, institucioneve dhe praktikës në rastet e tejkalimit të autorizimeve nga zyrtarët e autorizuar, Mbikëqyrja e jashtme e agjencive të zbatimit të ligjit, Analiza e standardeve ndërkombëtare, legjislacioni vendas, mekanizmat, institucionet dhe praktika, Shkup, Dhjetor 2003
- Треневска Десковска Р., 2009, Уставниот концепт на човековите права во Република Македонија, Зборник од научна расправа Европските стандарди за човековите права и нивна имплементација во правниот систем на Република Македонија. Книга 4: 129-145.
- Protokolli i Dytë Fakultativ i Konventës Ndërkombëtare mbi të Drejtat Civile dhe Politike Miratuar nga Asambleja e Përgjithshme e OKB-së me Rezolutën 44/128 të datës 15 dhjetor 1989.
- Prof. Dr Jeton Shasivari, E drejta policore-Dispensë, Fakulteti juridik-UEJL, Tetovë 2016.
- Konventa Evropiane për të Drejtat e Njeriut, e miratuar në Romë, hyri në fuqi më 3.9.1953. Republika e Maqedonisë ratifikoi atë më 27 shkurt 1997.
- Konventa Evropiane për Parandalimin e Torturës dhe Trajtimin ose Ndëshkimit Çnjerëzor ose Poshtërues të miratuar nga Këshilli i Evropës në vitin 1987 dhe hyri në fuqi më 1.2.1989.
- Jankulovski Z., G. Kalajdziev: Udhëheqja e të Drejtave të Njeriut, Komiteti i Helsinkit për të Drejtat e Njeriut të Republikës së Maqedonisë, Shkup 1999.
- Komiteti Helsingut për të Drejtat e Njeriut kundër torturës në Republikën e Maqedonisë. Dokumente themelore. Shkup 2004.
- Komiteti Helsingut për të Drejtat e Njeriut kundër torturës në Republikën e Maqedonisë. Për të Drejtat e juaja, policija dhe të Drejtat e Njeriut. Udhëzues. Shkup 2004
- Protokolli fakultativ I Konventës Për eliminimin e të gjitha formave të diskriminimit ndaj grave, miratuar nga Asambleja e përgjithshme e Kombeve të Bashkuara me rezolutën A/54/4 në 6. Tetorë. 1999. Dhe të hapur për nënshkrim, ratifikim ose për bashkangjitje që nga 10. Dhjetori. 1999. Dhe hyri në fuqi me 22. Dhjetor. 2000.
- Protokolli Fakultativ i Konventës Ndërkombëtare për të Drejtat Civile dhe Politike, Miratuar dhe hapur për nënshkrim, ratifikim ose aderim me Rezolutën 2200 A (XXI) të Asamblesë së

- Përgjithshme të OKB-së të datës 16 dhjetor 1966. Ai hyri në fuqi më 23 mars 1976, në përputhje me nenin 9 të Protokollit.
- Kushtetuta e Republikës së Maqedonisë, e miratuar më 17 nëntor 1991, botuar në Gazetën Zyrtare të Republikës së Maqedonisë nr. 52, datë 22.11.1991.
 - Kushtetutën e Republikës së Maqedonisë, këto të Drejta dhe Liri përfshihen në seksionin II Liritë dhe të Drejtat themelore të individit dhe të qytetarit
 - Dekreti për përdorimin e mjeteve të detyrimit dhe të armëve të zjarrit, 4.4.1998.
 - Deklarata Universale e të Drejtave të Njeriut, 10.12.1948 – Paris
 - Stojanovski Trpe. Etika dhe Deontologjia e Policisë, Shkup 2006.
 - Doracak për Hetimin dhe Dokumentimin Efektiv të Torturës dhe Trajtimit ose Ndëshkimit Mizor, Çnjerëzor dhe Poshtërues (Protokolli i Stambollit). Zyra e Komisionerit të Lartë të Kombeve të Bashkuara për të Drejtat e Njeriut Gjenevë, 1999.
 - Rregullorja për kryerjen e veprimtarive të SKBSP-së së Ministrisë së Punëve të Brendshme, e miratuar në maj 2007, dhe hyri në fuqi më 11.11.2007.
 - Rregullorja për kryerjen e punëve të Ministrisë së Brendshme (Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë, Nr.149 / 2007).
 - Analiza ligjore e Projektit për Mbështetjen e të Drejtave të Njeriut (2008-2009) www.hrsp.org.mk.
 - Organizata për Bashkëpunim të Sigurisë në Evropë (OSBE), Doracak për Policimin Demokratik nga Këshilltari i Lartë i Policisë i Sekretarit të Përgjithshëm të OSBE-së, Vjenë, Maj 2008.
 - Konventa Ndërkombëtare për të Drejtat Civile dhe Politike, miratuar në Asamblenë e Përgjithshme të OKB-së më 1966.
 - Konventa për Eliminimin e Diskriminimit Racor e hapur për nënshkrim dhe ratifikim ose për bashkangjitje me një rezolutë të Asamblesë së Përgjithshme të OKB-së 2106 A (XX) të 21 dhjetorit 1965.Hyri në fuqi më 4 janar 1969, në përputhje me nenin 19.
 - Kodi i Etikës Policore (Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë nr. 72/2007).
 - Vlado Kambovski, 2009, Thelbi Natyral dhe Ligjor i Lirive dhe të Drejtave Themelore të Njeriut, Procedura nga Diskutimi Shkencor Standardet Evropiane për të Drejtat e Njeriut dhe Zbatimi i tyre në Sistemin Ligjor të Republikës së Maqedonisë. Libri 4: 47-71.
 - Kodi Penal (Gazeta Zyrtare e RM nr. 37/1996, 80/1999, 04/2002, 43/2003, 19/2004, 81/2005, 60/2006, 73/2006, 07/2008, 139/2008 dhe 114/2009).
 - Полициска етика и деонтологија, Трпе Стојановски, 2006 Скопје.
 - Меѓународни правни стандарди со кои се уредува полициската употреба на средства за присила
 - Д.Шктриќ , 2007 објавено во Хрватски летопис за казненосправо и пракса –Загреб бр.14.
 - Човекови права и полиција – проф. Богољуб Милосављевиќ – Белград 2004.
 - Beckley, A., Human Rights: The Pocket Guide for Police Officers and Support Stuff Surrey, En g land, UK: The New Police Bookshop 2000 –
 - Osse, A., Instrumenti za vodjenje diskusije: prirucnik za instruktore - o policiji i ljudskim pravima: petnaest ideja kako da se ohrabre policajci da razmislljaju o pitanjima vezanim za ljudska prava - Beograd: Kancelarija Saveta Evrope u Beogradu, 2003
 - The prohibition of torture – Aisling Ready, Council of Europe,
 - The Criminal Law Handbook, Paul Bergman
 - Police in Transition Essays on the Police Forces in Transition Countries, Edited by András Kádár, Hungarian Helsinki Committee

- Report of the Human Rights defender (Ombudsman) on the activities of the NPM in Poland in 2010

- Udhëzues për punët efektive të policisë së Maqedonisë. Ministria e Punëve të Brendshme në bashkëpunim me OSBE-në. Shkurt 2005.
- Udhëzues për Zyrtarë Policor. Ministria e Punëve të Brendshme Biroja për Siguri Publike qendra për trajnim. Shkup, Shkurt 2013. E mbështetur nga OSBE-ja me Misionin në Shkup
- Intervista me Zyrtarë të Policisë
- Intervista me Avokatin e Popullit
- Formularët zyrtarë të policisë
- Kushtetuta e Republikës së Maqedonisë
- Kodi Penal i Republikës së Maqedonisë
- Kodi Evropian i Etikës Policore
- Ligji për policinë e Maqedonisë

II. Burime të tjera nga Interneti

www.vlada.mk
www.pravda.gov.mk
www.sobranie.mk
www.ia.gov.mk
www.macedfrr.gov.mk
www.europa.eu
www.osce.org/skopje
www.pccseesecretariat.si
www.jpacademy.gov.mk
<http://www.amnesty.org/>
www.nacionalnakomisija.gov.mk
<http://www.coe.int/>
<http://www.interpol.int/>
<http://www.un.org/>
<http://www.humanrightsinitiative.org/>
<http://www.rotterdamcharter.nl/>
<http://www.icrc.org/>
<http://www.ipacademy.org/>
<http://www.ojp.usdoj.gov/nij/>
<http://www.justiceinitiative.org/>
<http://www.coe.int/>
<http://www.interpol.int/>
<http://www.un.org/>
<http://www.humanrightsinitiative.org/>
<http://www.rotterdamcharter.nl/>
<http://www.icrc.org/>
<http://www.ipacademy.org/>
<http://www.ojp.usdoj.gov/nij/>
<http://www.justiceinitiative.org/>
www.polis.osce.org.mk
<http://www.mio.gov.mk/?q=sq/node/2678>